



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2020:051724

Datë: 13.09.2022

Numri i dokumentit: 03417871

**PS.nr.22/2020**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**Gjykata Themelore Prishtinë- Departamenti Special** - trupi gjykues i përbërë nga gjyqtarët: Lutfi Shala kryetar, Vesel Ismajli dhe Kujtim Krasniqi anëtarë, me pjesëmarrjen bashkëpunëtores profesionale Luljeta Gashi Metaj, duke vendosur në çështjen penale kundër të akuzuarve I.M, V.I, N.G, N.A, S.S B.S dhe A.I, për shkak të veprave penale Importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve nga neni 372 par.2 lidhur me par.1 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së, dhe Tregti e ndaluar e ndaluar nga neni 305 par.2 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së, të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës PPS.nr.16/2019 të datës 12.05.2020, dhe aktakuzën PPS.nr.16/2019 të datës 30.08.2021, të precizuar në fjalën përfundimtare nga PSRK-së, pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor publik të datës 27.05.2022, ku prezentë ishin, nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës prokurorja Fikrije Fejzullahu, i akuzuari I.M dhe mbrojtësi i tij av. Mahmut Halimi, i akuzuari V.I dhe mbrojtësi i tij av. Betim Shala, i akuzuari N.G dhe mbrojtësi i tij av. Haxhi Millaku, i akuzuari B.S dhe mbrojtësi i tij av. Imer Beka, i akuzuari S.S dhe mbrojtësi i tij av. Emrush Kastrati, i akuzuari N.A. dhe mbrojtësi i tij av. Shyqri Sylja, i akuzuari A.I dhe mbrojtësi i tij av. Arber Shala, gjykata me datë 08.06.2022 mori dhe publikisht shpalli këtë:

**A K T G J Y K I M**

**Të akuzuarit:**

**I.M**, nga i ati R. dhe nënës S. e vajzërisë B., i lindur me .. në V., me vendbanim në M. rruga ‘‘E. Q.’’ hyrja .., kati i .., nr., me numër personal ..6, i martuar, i ati i tre fëmijëve, ka te kryer shkollën e fillore, biznesmen, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar shtetas i Republikës së Kosovës dhe Gjermanisë.

**V.I**, nga i ati B. dhe nënës Z. e vajzërisë Xh., i lindur me .. në fshatin K. komuna M., me vendbanim në M. rruga ‘‘P. B.’’, nr., me numër personal .., i martuar, i ati i tre fëmijëve, ka te kryer shkollën e mesme, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar shtetas i Republikës së Kosovës.

**N.G**, nga i ati J. dhe nënës Sh.e vajzërisë M., i lindur me .. në fshatin K. Komuna e S. P., ku edhe jeton në rrugën ‘‘S. P.’’ kati i dytë, hyrja. nr., nr., me numër personal .., i martuar, i ati i tre fëmijëve, student, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar – shtetas i Republikës së Kosovës.

**N.A** nga i ati G. dhe nënës V. e vajzërisë H., i lindur me .. në M. ku edhe jeton në rrugën ‘‘A. Z.’’ nr., me numër personal .., i pa martuar, ka të kryer fakultetin ekonomik, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar – shtetas i Republikës së Kosovës.

**B. S.**, nga i ati R. dhe nënës S. e vajzërisë S., i lindur me .. në P. ku edhe jeton në rrugën ‘‘U. A.’’ Nr.. P., me numër personal .., i martuar, i ati i dy fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar – shtetas i Republikës së Kosovës.

**S.S**, nga i ati **R.** dhe nënës **S.** e vajzërisë **S.**, i lindur me .. në Prishtinë ku edhe jeton në rrugën ‘**V.F.**’ nr..., me numër personal .., i pa martuar, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar – shtetas i Republikës së Kosovës.

**A. I.**, i biri i **Q.** dhe **T.**, e gjinisë **D.**, i lindur me .., në **K.**, **R.** e **M.** së **V.**, me vendbanim ne **P.**, lagja e spitalit, rr. ‘‘**H.P.**’’, **L....**, hy..., nr. ., **P.**, i martuar, baba i dy fëmijëve, me shkollim te lartë, farmacist, i gjendjes se dobët ekonomike, me nr. personal .., shqiptar, shtetas i Republikës se Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut.

## JANË FAJTOR

### I.

**Të akuzuarit:** *V.I, N.G, I.M dhe N. A.*

**Sepse:** Me datë 21.03.2019, të pandehurit **V.I, N.G, I.M** dhe **N.A** në bashkëveprim në mes vete, kanë furnizuar, transportuar, me qëllim për ti shitur pa autorizim armë të llojit Glock Austria dhe Sig Suer, sipas marrëveshjes paraprake i pandehuri **V.I**, paraprakisht i ka siguruar 25 pako me armë dhe i ka vendosur në lokalit e tij në **F. K.** e pastaj sipas kërkesës se tij këto pako i pandehuri **F.H** ia jep vozitësit të kompanisë ‘‘**S.L**’’, **M.K**, me insistimin e **I.M** pronar i kompanisë **S.L** dhe në bashkëpunim me **N.A.**, **M.K** i kishte marrë nga depoja në **F. Kosovë** këto pako dhe i kishte dërguar në objektin e postës ‘‘**S.L**’’ në fshati **M.** Më pastaj të pandehurit **I.M, V.I, N.G** dhe **N.A** pasi koordinohen mes veti bëjnë ripaketimin e pakove duke i shpërndarë dhe futur nëpër pako të tjera armët në njërën nga zyrat e kompanisë ‘‘**S.L**’’ me qëllim të shpërndarjes së tyre, ku gjatë kontrollimit të depos ‘‘**S.L**’’ janë gjetur dhe sekuestruar gjithsej 99 armë të llojit Glock-Austria dhe Sig-Sauer si dhe 723 fishek të kalibrit të ndryshëm.

- Me këtë në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e pa autorizuar e armeve apo materieve plasëse nga neni 372 par.2 lidhur me par.1 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

### II.

**Të akuzuarit:** *B. S., S.S dhe A. I.*

**Sepse:** Nga periudha e panjohur e deri më datë, 21.03.2019 të pandehurit **B.S** dhe **S.S**, në bashkëveprim me të pandehurin **A.I**, pa autorizim dhe në kundërshtim me Ligjin për shëndetësi nr. 04/L-125, Ligjin për produkte dhe pajisje medicinale 04/L-190 dhe Udhëzimit Administrativ 11/2015, kanë blerë dhe shitur produkte medicinale dhe atë barna me veprim të ndryshëm terapeutik, pa banderola, me banderola të **R. Serbisë**, si dhe me afat të skaduar, të cilat mallra sipas ligjit janë të kufizuara. Të pandehurit **B.S** dhe **S.S** medikamentet i kanë siguruar nga i akuzuari **A.I** dhe nga një person i nacionalitetit serb në veri të Mitrovicës, ashtu që i pandehuri **B.S** me dt: 21.03.2019, i merr disa pako me medikamente në depon e postës **S.L** me veturën e tij të tipit **A. A3**, pastaj takohet me të pandehurin **S.S**, në lagjen **Ulpiana** në Prishtinë, një pako me medikamente ja jep dhe i fut në veturën e tij të tipit ‘‘**O. K.**’’ me targa .., ku edhe janë ndarë, me qellim të shitjes së tyre nëpër barnatore të ndryshme, në Prishtinë dhe vende tjera, mirëpo të njëjtit ishin duke u vëzhguar nga ana e policisë së Kosovës janë ndal dhe gjatë kontrollimit në veturat e tyre janë gjendur dhe sekuestruar pako me medikamente më pastaj gjatë kontrollimit në garazhin e banesës se të pandehurit **B.S** në Rrugën ‘‘**U. A.**’’ në lagjen **M. 1** i gjenden dhe i sekuestrohen edhe pako tjera me medikamente, vlera e përgjithshme e të cilave përfshinë sasinë mbi 17.000 euro.

- Me këtë në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale Tregti e ndaluar nga neni 305 par.2 të KPRK e lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të nenit 4, 7, 8, 9, 10, 17, 38, 39, 40, 42,43, 69, 79, të KPRK-së, si dhe nenit 360, 361 dhe nenit 365 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës të akuzuarve **V.I, N.G, I.M, dhe N.A** për veprën penale si në dispozitivin **I.** të këtij aktgjykimi i’u shqipton:

## DËNIM ME BURGIM

Ashtu që të akuzuarit **V.Yi** shqipton dënim me burgim në kohëzgjatje **4 (katër) vite**, të cilin dënim do ta vuaj 15 ditë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Koha e kaluar nën masën e arrestit shtëpiak prej datës **06.02.2020 e deri me dt: 06.05.2020** në kohëzgjatje prej 3 muaj i llogaritet në dënimin e shqiptuar me burgim.

Ashtu që të akuzuarit **N.G** i shqipton dënim me burgim në kohëzgjatje **4 (katër) vite**, të cilin dënim do ta vuaj 15 ditë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Koha e kaluar nën masën e arrestit shtëpiak prej datës **18.02.2020 e deri me dt:16.03.2020** në kohëzgjatje prej 26 ditë i llogaritet në dënimin e shqiptuar me burgim.

Ashtu që të akuzuarit **I. M.**i shqipton dënim me burgim në kohëzgjatje **2 (dy) vite**, të cilin dënim do ta vuaj 15 ditë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Koha e kaluar nën masën e paraburgimit prej datës **06.09.2019 e deri me dt:13.11.2019** në kohëzgjatje prej 67 ditë i llogaritet në dënimin e shqiptuar me burgim.

Ashtu që të akuzuarit **N.A** i shqipton dënim me burgim në kohëzgjatje **2 (dy) vite**, të cilin dënim do ta vuaj 15 ditë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Koha e kaluar nën masën e paraburgimit prej datës **06.09.2019 e deri me dt:13.11.2019**, në kohëzgjatje prej 2 muaj e 7 ditë i llogaritet në dënimin e shqiptuar me burgim.

**Si dhe:**

## DËNIMIN ME GJOBË

Ashtu që të akuzuarin **V.I** e gjykon me dënim me gjobë në lartësi prej **15.000 (pesëmbëdhjetë mijë) euro**, të cilën shumë i akuzuari është i obliguar që ta paguaj në gjiro llogarinë e kësaj gjykate në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Ashtu që të akuzuarin **N.G** e gjykon me dënim me gjobë në lartësi prej **15.000 (pesëmbëdhjetë mijë) euro**, të cilën shumë i akuzuari është i obliguar që ta paguaj në gjiro llogarinë e kësaj gjykate në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Ashtu që të akuzuarin **I.M.**, e gjykon me dënim me gjobë në lartësi prej **10.000 ( dhjetë mijë) euro**, të cilën shumë i akuzuari është i obliguar që ta paguaj në gjiro llogarinë e kësaj gjykate në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Ashtu që të akuzuarin **N.A** e gjykon me dënim me gjobë në lartësi prej **2.000 (dymijë) euro**, të cilën shumë i akuzuari është i obliguar që ta paguaj në gjiro llogarinë e kësaj gjykate në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Po që se dënimi me gjobë nuk mund të realizohet konform nenit 46 të KPRK-së, të akuzuarve gjykata do ta zëvendësoj me dënim me burgim, **duke llogaritur çdo 20 (njëzet) euro me 1 (një) ditë burg.**

Gjykata në bazë të nenit 4, 7, 8, 9, 10, 17, 38, 39, 40, 42, 69, 79, të KPRK-së, si dhe nenit 360, 361 dhe nenit 365 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës të akuzuarve **B.S, S.S dhe A.I**, për veprën penale si në dispozitivin **II**. të këtij aktgjykimi i'u shqipton:

## DËNIM ME BURGIM

Ashtu që të akuzuarit **B. S.**, i shqipton dënim me burgim në kohëzgjatje prej **2 (dy) vite e 8 muaj**, viti i cili dënim do të ekzekutohet 15 ditë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Koha e kaluar nën masën e paraburgimit prej datës **21.03.2019 e deri 13.11.2019** në kohëzgjatje prej 7 muaj e 24 ditë i llogaritet në dënimin e shqiptuar me burgim.

Ashtu që të akuzuarit **S. S.**, i shqipton dënim me burgim në kohëzgjatje prej **2 (dy) vite e 8 muaj**, i cili dënim do të ekzekutohet 15 ditë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Koha e kaluar nën masën e paraburgimit prej datës **21.03.2019 e deri me dt: 02.08.2019**, dhe koha e kaluar në masën e arrestit shtëpiak prej dt: **02.08.2019 e deri 29.11.2019** në kohëzgjatje prej 8 muaj e 8 ditë i llogaritet në dënimin e shqiptuar me burgim.

Ashtu që të akuzuarit **A.I** i shqipton dënim me burgim në kohëzgjatje prej **2 (dy) vite e 8 muaj**, i cili dënim do të ekzekutohet 15 ditë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Koha e kaluar në masën e paraburgimit prej datës **07.07.2021 e deri me dt:03.09.2021** dhe koha e kaluar në masën e arrestit shtëpiak prej dt:**03.09.2021 e deri me dt: 21.10.2021**, i llogaritet në dënimin e shqiptuar me burgim.

Konform nenit 305 par. 3 të KPRK-së medikamentet e listuara si në listën e Inspektoratit Farmaceutik konfiskohen, si dhe në bazë të nenit 372 par. 4 të KPRK-së 29 pistoleta Zoraki me mbishkrimin "Glock Austria" dhe 69 pistoleta Zoraki me mbishkrimin "Sig Sauer" gjithsej 99 pistoleta, si dhe 723 fishek, konfiskohen.

Në bazë të nenit 284 par.1 të KPRK, sendet e sekuestruara vetura Opel Corsa ngjyrë hiri me targa 01-806-LK, vetura Audi A3 ngjyrë e zezë me targa 01-337-IL në pronësi të akuzuarve B dhe S.S si dhe 12.300 euro, në pronësi të akuzuarit I. M. si dhe 5.000 euro në pronësi të B.Sju kthehen pasi që nuk ka bazë për konfiskim, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

**OBLIGOHEN** të akuzuarit që secili veç e veç, në emër të shpenzimeve të procedurës penale gjykatës të ia kompensoi shumë prej **200 euro**, si dhe në emër të paushallit gjyqësor shumë prej **100 euro**, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

**HIQET DORËZANIA** ashtu që të akuzuarit I.M me të dhënat personale si më lartë, i kthehen shumat e parave të lënë në dorëzani prej; 20.000 € (njëzetmijë) euro, paratë nga dorëzania i kthehet të akuzuarit pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit dhe pasi të ketë paguar dënimin me gjobë. Shuma e dorëzanisë me pëlqimin e të akuzuarit mund të bartet për të paguar dënimin me gjobë i shqiptuar kundër tij.

**HIQET DORËZANIA** ashtu që të akuzuarit N.A me të dhënat personale si më lartë, i kthehen shumat e parave të lënë në dorëzani prej; 10.000 € (dhjetëmijë) euro, paratë nga dorëzania i kthehet të akuzuarit pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit dhe pasi të ketë paguar dënimin me gjobë. Shuma e dorëzanisë me pëlqimin e të akuzuarit mund të bartet për të paguar dënimin me gjobë i shqiptuar kundër tij.

**HIQET DORËZANIA** ashtu që të akuzuarit B.S me të dhënat personale si më lartë, i kthehen shumat e parave të lënë në dorëzani prej; 15.000 € (pesëmbëdhjetëmijë) euro, paratë nga dorëzania i kthehet të akuzuarit pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës ka parashtruar Aktakuzën PPS.nr16/2019 të datës 12.05.2020, dhe aktakuzën PPS.nr.16/2019 të datës 30.08.2021, të precizuar në fjalën përfundimtare nga PSRK-së, kundër të akuzuarve I.M,V.I, N.G, N.A.S.S B.Sdhe A.I, për shkak të veprave penale Importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve

nga neni 372 par.2 lidhur me par.1 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së, dhe Tregti e ndaluar e ndaluar nga neni 305 par.2 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Gjykata me kërkes të Prokurorisë Speciale PPS.nr.16/19 të dt.30.08.2021 me aktvendim të datës 08.09.2021 ka bashkuar lëndën penale PS.nr.35/21 i akuzuari A. I. me lëndën penale PS.nr. 22/20 të akuzuarit I.M,V.I, B. S., S.S dhe N.A pasi bëhet fjalë për të njëjtat vepra penale të kryera në bashkëkryerje mirë po i akuzuari A.I ka qen i pa arritshëm në kohën kur ndaj të akuzuarve të parë është ngritur aktakuza.

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti Specila ka caktuar dhe vazhduar shqyrtimin gjyqësor për veprat penale pjesmarrja ose organizimi i grupit kriminal të organizuar nga neni 283 të KPRK, importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve nga neni 372 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së dhe veprën penale tregtia e ndaluar e ndaluar nga neni 305 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, mirëpo në fjalën përfundimtare prokurori i prokurorisë speciale ka bërë precizimin dhe ndryshimin e dispozitivit të aktakuzës dhe atë duke e hequr krimin e organizuar dhe të njëjtit i akuzon se kanë kryer veprat penale të lartëcekura në bashkëkryerje.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor si dhe pas precizimit dhe ndryshimit të dispozitivit të aktakuzës të akuzuarit në bazë të nenit 323 të KPPK-së, janë udhëzuar me të drejtat e tyre ligjore dhe pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, të njëjtit janë udhëzuar në bazë të nenit 326 par.1 të KPPK-së, mbi të drejtat për deklarimin e pranimit apo mos pranimit të fajësisë, në këtë drejtim të akuzuarit janë njoftuar nga gjykata për pasojat që rezultojnë nga pranimi i fajësisë dhe kushtet e përcaktuara me nenin 248 par.1 pika 1.1 deri 1.3 të KPPK-së, që pranimi nga ana e tyre të konsiderohet i vlefshëm.

**I akuzuari I.M** në shqyrtimin gjyqësor të dt.27.05.2022, pas precizimit dhe ndryshimit të dispozitivit të aktakuzës ka deklaruar se nuk e ndien vetën fajtor se në bashkëkryerje ka kryer veprat penale Importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve nga neni 372 par.2 lidhur me par.1e lidhur me nenin 31 të KPRK-së, dhe veprën penale Tregtia e ndaluar e ndaluar nga neni 305 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

**I akuzuari V.I,** në shqyrtimin gjyqësor të dt. 27.05.2022, pas precizimit dhe ndryshimit të dispozitivit të aktakuzës ka deklaruar se e ndien veten fajtor për veprat penale Importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve nga neni 372 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së dhe veprën penale Tregti e ndaluar e ndaluar nga neni 305 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së. Ndërsa **nuk e ndien vetën fajtor** se veprat penale i ka kryer në bashkëkryerje pasi që këto vepra penale i ka kryer vetë.

**I akuzuari N.G,** në shqyrtimin gjyqësor të dt.27.05.2022, pas precizimit dhe ndryshimit të dispozitivit të aktakuzës ka deklaruar se nuk e ndien veten fajtor se në bashkëkryerje ka kryer veprat penale Importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve nga neni 372 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së dhe veprën penale tregti e ndaluar e ndaluar nga neni 305 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

**I akuzuari N.A** në shqyrtimin gjyqësor të dt.27.05.2022, pas precizimit dhe ndryshimit të dispozitivit të aktakuzës ka deklaruar se nuk e ndien vetën fajtor se në bashkëkryerje ka kryer veprat penale Importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve nga neni 372 par.2 lidhur me par.1 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së dhe veprën penale Tregti e ndaluar e ndaluar nga neni 305 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

**I akuzuari B. S.,** në shqyrtimin gjyqësor të dt.27.05.2022,pas precizi mit dhe ndryshimit të dispozitivit të aktakuzës ka deklaruar se e ndien vetën fajtor për veprën për veprën penale Tregti e ndaluar nga neni 305 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, **ndërsa nuk e ndien vetën fajtor** për veprën penale Importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve nga neni 372 par.2 lidhur me par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

**I akuzuari S.S.**, në shqyrtimin gjyqësor të dt.27.05.2022, pas precizi mit dhe ndryshimit të dispozitivit të aktakuzës ka deklaruar se e ndien vetën fajtor për veprën penale Tregti e ndaluar nga neni 305 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, **ndërsa nuk e ndien veten fajtor për veprën penale** Importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve nga neni 372 par.2 lidhur me par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

**I akuzuari A.I.**, në shqyrtimin gjyqësor të dt.27.05.2022, pas precizi mit dhe ndryshimit të dispozitivit të aktakuzës ka deklaruar se nuk e ndien vetën fajtor se në bashkëkryerje ka kryer veprat penale Importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve nga neni 372 par.2 lidhur me par.1 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së dhe veprën penale Tregti e ndaluar nga neni 305 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Trupi gjykues pas deklarimeve lidhur për fajësinë nga të akuzuarit dhe mendimeve mbrojtësve të tyre dhe mendimin e Prokurorisë Specialë, me aktvendim refuzoj pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve **V.I** për veprën penale Importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve nga neni 372 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së dhe veprën penale Tregti e ndaluar e ndaluar nga neni 305 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, **B.S** për veprën penale Tregtia e ndaluar nga neni 305 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, dhe **S.S** për veprën penale Tregtia e ndaluar e nga neni 305 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, pasi ky pranim është i pjesshëm, dhe nuk është në harmoni me provat materiale dhe dispozitat ligjore, gjykata ka vazhduar me fajlen përfundimtare.

**Prokurori i Prokurorisë Speciale** gjatë shqyrtimit gjyqësor të datës 27.05.2022, si dhe në fjalën përfundimtare të parashtruar me shkrim e të elaboruar edhe në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se, prokuroria e konsideron se verpat penal të përshkruara në aktakuzë, nuk është vertetuar se të akuzuarit kanë vepruar si grup i organizuar andaj prokuroria ka berë precizimin dhe ndryshimin e dispozitivit të aktakuzës. Të akuzuarit I.M,V.I, N.G, N.A.S.S B.S dhe A.I, kanë kryer verpat penale Importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve nga neni 372 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së, dhe Tregti e ndaluar e ndaluar nga neni 305 par.2 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së. Prandaj nga e gjitha provat administruara, përtej dyshimit të bazuar mirë është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të artë gjendja faktike e përshkruar në aktakuzë. Po ashtu nga dëshmitë e dëshmitarëve e në veçanti nga dëshmitari M.K dhe I.M çartë ka rezultuar që të pandehurit kanë bashkëvepruar, pasi këto dëshmi janë në përputhje të plotë edhe me provat e shumta materiale. Prandaj nga video incizimet e datës 10.03.2019 shihen çartë veprimet e të pandehurve I.M,V.I, N.G dhe N.A. ndërsa sa I për ketë të akuzuarve B. S., S.S. dhe A.I është vertetuar se të njëjtit kanë shkuar bashkë disa herë në barnatoren e dëshmitarës e I. M. Dëshmitari e dëshmitarës deri në detaje ka sçaruar mënyren e marrjes se barërave dhe veprimet e tyre të shpejta, e njëjta ka arritur të identifikoj të akuzuarin B. S. e duke sçaruar se i akuzauri A.I kishte marr barëra nga e njëjta bashkë me të akuzaurin B.. Gjithashtu edhe aporti I kontrollit të vendit të ngjarjes rezulton se të pandehurit I kanë pergaditur armet për shitje në një destinacion të panjohur. Po ashtu deklaratat e të pandehurve në prokurori e disa prej tyre edhe në gjyktë janë kotradiktore dhe në shpërputhje të plotë me provat materiale dhe dëshmit e dëshmitarëve. Asndaj në veprimet e tyre përmbushen elementet e veprave penale të përshkruara në aktakuzë, ndërkaq përtej dyshimit është vertetuar se qëllimi i tyre ka qenë përfitimi i dobisë pasurore në mënyrë të kunderligjshme. Përkatesisht lidhemria e provave të drejtëperdrejta por edhe atyre rrethanore nuk lë asnjë dyshim se të akuzuarit i kanë vepruar me dashje dhe me vetëdije të plotë. I ka propozuar gjyktës qe të njëjtit ti shpall fajtor dhe ti dënoj sipas ligjit dhe në ketë rast të merr parasysh shkallën e lartë të rrezikshmërisë se verpat penale dhe pasojat e shkaktuara, si dhe sasinë e madhe të armëve e ben edhe me të theksueshmëm faktin që rrezikshmeria shoqërore është e madhe e kjo për shkak të një numër i madh i veprave penale që kryhen në vendin tonë pikërishtë mjete përdorimi i kanë armët. Po ashtu ka propozuar qe të bëhet konfiskimi I sendeve të propozuara në aktkauzë ndërsa verura e tipit “BMW ..” me targa të regjistrimit .. ti ktheht të pandehurit B. S.

**Mbrojtësi i të akuzuarit I.M, av. Mahmut Halimi**, gjatë shqyrtimit gjyqësor të datës 27.05.2022, si dhe në fjalën përfundimtare të parashtruar me shkrim e të elaboruar edhe në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se, prokuroria nuk ka arritur që përtej çdo dyshimi të arsyeshëm se këtu të gjithë të akuzuarit në bashkëveprim kanë kryer veprat penale që iu vihet në barrë, për arsye se mbi bazën e provave të

administruar, pretendimet e tilla nuk qëndrojnë askund, gjithashtu është një vlerësim i përgjithësuar i prokurorisë lidhur me lartësinë e vlerës së mallrave të kontrabanduara e cila në mënyrë abstrakte pa mbështetje, ekspertizë thekson se vlera është mbi 17 mijë euro, dhe nuk e dimë se kush, si dhe në çfarë mënyrë ndërmorën veprime dhe realizuan veprimet e veprës penale të cilësuar në par.2 që është lartësia e shumës, pra siç ka mbetur pa u vërtetuar bashkëkryerje si element qendror ka mbet pa u vërtetu edhe lartësi e mallrave të tregtuara në mënyrë të ndaluar. Ndërsa sa i për ketë veprës penale të armëve nga neni 372 ky cilësim nuk përfshin elementin e posedimit dhe mbi bazën e gjendjes së fakteve është vërtetuar përtej çdo dyshimi, të cilin e pranon edhe akuza se i akuzuari V nga personi i quajtur Doni ka marr pakot me armë dhe barna me qellim që ti transportoj në pjesën veriore të Mitrovicës për shumën prej 1000 euro. Prej të cilat i ka pranuar 500 nga dorëzuesi dhe 500 marrësi nëse ishin dërguar, në këtë drejtim secili nga të akuzuarit tjerë janë të përjashtuar nga çfarëdo implikimi për të mund të inkriminohen si bashkëpunëtor, krejt në fund ndaj përshtypjen se kjo veprë penale ka mbete në tentativë. Nuk është përfunduar kryeja e saj, është gjete në posedim të akuzuarit V. I njëjti ka shtuar se sipas provave të administruara rrjedh i pakontestueshëm fakti se I.M për një kohë prej afro 20 vitesh ushtron biznesin e tij të shërbimeve postare në RF të Gjermanisë. Ndërsa në Kosovë ka investuar dhe regjistruar ndërmarrjen ‘‘S.L’’, veprimtari e se cilës ka qenë ofrim i shërbimeve të postës se shpejtë. Pra subjekti i cekur ka kryer transportin e mallrave për nevojat e personave fizik dhe juridik, sipas porosisë, vozitësit e ndërmarrjes kanë shkuar ne destinacionin e kërkuar, kanë pranuar mallra të cilat përmes aplikacioneve online iu është vënë fleta identifikuese e quajtur ‘‘Konota’’, në të cilën dërguesi ka konstatuar te dhënat e tij dhe pranuesit të mallit, të cilat janë sistemuar ne depo dhe nga aty pas sistemimit janë transportuar në destinacionin e pranuesit. Pra me rastin e dorëzimit të mallit, vozitësit kanë pranuar pagesat në dorë nga personat fizik ndërsa për personat juridik pagesat janë bërë përmes faturimit ashtu qe pas llogaritjes së shërbimit të kryer, pjesa tjetër e mallit të shitur i është bartur dërguesit. Andaj vshtirësit kanë qenë evidente për shkak të mungesës të dhënave të adresave të sakta të pranuesit dh dorëzuesit si pasojë e së cilave shpesh herë kanë qenë te detyruar qe qarkullimin ta bejënë përmes numrave të telefonit të shënuara ‘‘Konota’’. Po ashtu sipas dipozitave në fuqi askush nga personeli i ndërmarrjes nuk ka patur të drejtë apo autorizim qe të kontrolloj përmbajtjen e brendshme te pakove, as qe e kanë bërë ndonjëherë sepse sipas rregullores të ndërmarrjes përgjegjësia ka qene e dorëzuesit të pakos. Për prokurorin nuk është kontestuese se i akuzuari V.I disa ditë me pare nga personi i pa njohur me nofkën ‘‘Doni’’ i ka pranuar 25 pako në të cilat kanë qenë të vendosura 99 pistoleta dhe një sasi barnash. Këto pako i ka vendosur në lokalin e tij në F. K.. Po ashtu nuk është kontestuese për prokurorin se pas 2- 3 ditësh V.I përmes telefoni e kishte thirr tani te ndjerin Fatmir Harunin i cili punonte në atë kohë në lokain e V.në F. K., duke udhëzuar qe këto pako të ia jepte postierit të postes S.L, dëshmitarit M.K. Rreth datës 10.03.2019 sipas urdhrin për transport ka shkuar i ka marrë pakot dhe i ka zbankuar në depon e ndërmarrësja S.L, në fshatin M., pronare i se cilës është I.M.i. I njëjti me tej shton se kontestuese janë faktet nëse të akuzuarit I., V, N. dhe N. me datë 10.03.2019 dhe datë 15.03.2019 kanë bërë ripaketimin e pakove të larte cekura duke futur në pako armë dhe barëra dh atë në ambientet e kompanisë S.L. Andaj këto pretendime organi i akuzës i mbështet në video incizimet e nxjerra nga kamerat e sigurisë të kompanisë S.L. Pra nga te cilat assesi nuk mund të vërtetohet një pretendim i tillë, pasi qe ne veturën P. shihen duke qëndruar të akuzuarit V dhe N., me besueshmërinë se ishin duke pritur të akuzuarin I, ndërsa nuk vërehet asnjë veprim i vetëm i prezencës se ndonjë arme në duart e tyre. Përkatësisht nga vido-incizimi shihet prezenca e të pandehurve I, V dhe N në brendi të depos të cilët bëjnë shikimin e pakove te vendosura. Prandaj pistoletat dhe barërat kanë qenë te vendosura qysh me herët dhe te paketuara në pako nga pësoni i quajtur ‘‘Doni’’, e të cilat rrethana ndriçohen nga deklarata e I i cili ka theksuar se më kërkesën e te akuzuarit V kanë shkuar në depo kanë shikuar përmbajtjen e pakove dhe atë nga arsyeja e shqetësimit të akuzuarit V për mungesë kontaktit me pranuesin e mallit. Po ashtu ky i akuzuar pranon edhe faktin se pas hapjes se pakove ka vërejte pistoletat se janë me gas, me pastaj i kanë mbyllur pakot të cilat në fakt me datë 21.03.2019, organet e ndjekjes pas intervenimit i kanë gjetur armët dhe i kanë sekuestruar të njëjtat. Përkatësisht në bazë të këtyre fakteve është e pakontestueshme se i akuzuari N.G nuk ka patur ndonjë implikim me armët dhe barërat e gjetura, ai vetëm ka qenë në shoqëri me te akuzuarin V, ndërsa i akuzuari N si menaxher i kompanisë, ka bartur pako për të cilat nuk ka pasur kurrfarë dijenie për përmbajtjen e brendshme të tyre (siç edhe shihet në video-incizimin e dt.15.03.2019) prandaj mungesa e dijenisë dhe dashjes dhe çfarë do elementi tjetër do të rezultoi me lirimin e të njëjtëve nga akuza. Po ashtu rasti i dt. 10.03.2019 ku sipas lutjes se të akuzuarit V si dërgues i mallit ka pranuar qe të bëjë shqimin e pakove në të cilat ka vërejtur pistoleta dhe barëra. E ketë veprim i mbrojturi i e ka bërë mbi bazën e përvojës se tij, në RF të Gjermanisë ka konsideruar se

veprimet e tilla nuk janë të palejuara, se me shqimin e tyre ka kolauduar se është fjala për pistoletë gazi, qarkullimi i të cilave nuk është i ndaluar. Pra në këtë drejtim ekziston lajthimi juridik të I lidhur me armët në pako. Me tutje i njëjti thekson se duke marr parasysh se I me kërkesë të V ka bërë shqimin e pistoletave dhe nuk e ka denoncuar tek organet e ndjekjes të cilat me datë 21.03.2019 janë zbuluar ekzistimi i tyre, andaj me këto veprime të tilla mund të përmbushen elementet e veprës penale Moslajmërimi i veprave penale apo kryerësve të tyre nga neni 387 par.2 e lidhur me par .1 pika 1.9 të KPRK. Po ashtu lidhur me elementet e veprës penale tregti e ndaluar nga neni 305 par.2 të KPRK, konsideron se në veprimet e të mbrojturit të tij, nuk qëndron asnjë element i vetëm kjo për faktin se veprimtaria e kompanisë në vazhdimësi pos mallrave tjera ka bërë edhe transportin e barërave të ndryshme nëpër subjekt të ndryshëm nga distribucione të ndryshme nëpër barnatore në vende të ndryshme, e të cilat janë porositur nga subjekt të ndryshëm dhe transporti i tyre nuk ka qenë i ndaluar me ligj. Përkatësisht në mungesë të provave I.M duhet liruar nga të gjitha pikat e akuzës. Po ashtu konsideron se duhet cilësuar veprën penale Moslajmërimi i veprave penale apo kryerësve të tyre nga neni 387 par.2 e lidhur me par .1 pika 1.9 të KPRK, e për të cilën vepër i propozon gjykatës që ti shqiptohet një dënim sa me i butë me mundësi shëndrrimi të dënimit me burg në dënim me gjobë me të cilin në tërësi do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i shqiptimit të seksioneve penale. I ka propozuar gjykatës që shumat e konfiskura të hollave me rasti në arrestimit në lartësi prej 12.300.00 euro, ti kthen të mbrojturit të tij, pasi që për prejardhjen e tyre që në fillim të procedurës janë dorëzuar prova, për faktin se të hollat janë pronë e klientëve të cilëve ju kanë kryer shërbime.

**I akuzuari I.M, në fjalën përfundimtare ka deklaurat, se e mbështet në tërësi deklarin e mbrojtësit të tij, duke shtuar se mosdija e tij e ka sjell këtu.**

**Mbrojtësi i të akuzuarit V.I, av. Betim Shala, gjatë shqyrtimit gjyqësor të datës 27.05.2022, si dhe në fjalën përfundimtare të parashtruar me shkrim e të elaboruar edhe në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se, pas ndryshimit të akuzës nga PSRK, i mbrojturi i tij, përsëri pranon kryerjen e veprave penale që i vihen në barrë me të vetmin ndryshim se nuk e pranon cilësimi që kjo veprë penale të është kryer në grup me të akuzuarit e tjerë. Me tej thekson se nga provat e administruara në shqyrtim gjyqësor, mbrojtja mendon se Prokuroria nuk ka arritur që të dëshmojë se këto vepra penale janë kryer në grup, e posaçërisht nuk ka arritur të dëshmon se të gjitha të akuzuarit ka ekzistuar dashja për kryerjen e këtyre veprave penale, pra në këtë çështje kemi të bëjmë me vepra të pa kryera, pra në tentativë, i mbrojturi i tij, këto vepra penale i ka kryer vetëm në formën e ndërmjetësuesit e ase si të shitjes së paautorizuar. Me tej ka shtuar se nga përmbajtja e aktakuzës por edhe nga provat e administruara në shqyrtim gjyqësor vërtetohet se i mbrojturi i tij veprat penale nga neni 327 par. 2 lidhur me par.1 të KPRK, dhe veprën penale nga neni 305 par. 2 i KPRK, i ka kryer si individ e jo në bashkëkryerje. Po ashtu gjatë shqyrtimit gjyqësor nga provat e administruara është vërtetuar se V.I ka pranuar armët përkatësisht pistoletat e adaptuar dhe barnat nga personi me nofken "DONI", për një kompensim të caktuar t'ia dërgoi gjerë në afërsi të pjesës Veriore të Mitrovicës të vendi i quajtur "Shkëmbi i Dudës". Po ashtu është vërtetuar se V ka planifikuar që transportin ta bëjë përmes postes S.L, pronë e të akuzuarit I M., V ka pasur njohuri se posta e cekur merret me transportin e mallrave nëpër vende të ndryshme dhe në këtë mënyrë ai do të arrin që të dorëzojë paketat në vendin e akorduar. Me tutje i njëjti thekson se nga provat e administruara dhe vetë deklaratat e Vit është vërtetuar se V ka pranuar mallin(pistoletat dhe barnat) me qëllim të kryerjes së shërbimit të transportit për kompensim i cili pjesërisht i është dhënë dh pjesa tjetër do ti jepet me rastin e dorëzimit të mallit në destinimin e caktuar. Pra i njëjti e ka pranuar se ai këtë shërbim e ka bërë për përfitim material e jo nga ky shërbim të përfitojnë edhe ndonjëri nga bashkë të akuzuar. Po ashtu nga provat e administruara se veprimet e të mbrojturit të tij nuk mund të ndërliken me veprimet e N. A. i cili në S. L.kryen të gjitha punët, ngarkimin e mallrave, bartjen e tyre nëpër destinacione të ndryshme si dhe punë tjera si dhe menaxhon financat përkatësisht bënë barazimin e financave shoferëve e klientëve. Pra veprimet e Vit do mund të kualifikohen si veprime të ndërmjetësimit e ase si bashkëkryerje nga e cila do të përfitonin në mënyrë të kundërligjshme të gjithë të akuzuarit. Po ashtu pretendimet e Prokurorisë në aktakuzë se "nga periudha e pa njohur kohore e gjerë...", është i pa saktë për faktin duke u bazuar në deklaratat e bashkë akuzuarve dëshmitarëve dhe provave materiale nuk ka pasur kurrfarë periudhe të panjohur pasi që është vërtetuar në këtë çështje penale kemi të bëjmë me një rast të vetëm ku është përfshirë V.I, kjo vërtetohet edhe nga raporti i përgjimeve, dhe nga përgjim nuk është vërtetuar ndonjë aktivitet kriminal tjetër. Ndërsa gjatë shqyrtimit gjyqësor është vërtetuar se B., S.S dhe A.I kanë të bëjnë me një rast tjetër dhe atë me**



pako të medikamenteve e ky rast nuk mund të ndërlidhet me veprimet e të mbrojturit të tij. Me tutje i njëjti shton se i mbrojturi i tij V.I q në fillim të hetimeve të kësaj çështje penale e po ashtu në seancë fillestare të dt.15.06.2020 ka pranuar fajësinë për veprën penale nga neni 372 par.2 lidhur me par 1 të KPRK dhe veprën penale nga neni 305 ar.2 të KPRK. I njëjti i ka propozuar gjykatës që ti merr për bazë të gjitha të thënave dhe me rastin e caktimit të dënimit të merr parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese e posaçërisht sinqeritetin e të mbrojturit të tij me rastin e pranimit të fajësisë, faktin se i njëjti që nga fillimi i këtij procesi ka kuptuar për veprimet e tij se janë të kundërligjshme dhe ka tentuar që menjëherë nga fillimi i këtij procesi penale të jetë bashkëpunues dhe ti pranon veprimet e tija inkriminuese, i njëjti gjerë me sot nuk ka ra ndesh me ligjin, po ashtu të merret parasysh faktin se i njëjti është familjar, mbajtëse i familjes dhe është i vetmi i punësuar në familje, duke konsideruar se në veprimet e të mbrojturit të tij, nuk ka elemente renduese, ashtu që gjykata që ti merr për bazë të gjitha këto dhe të mbrojturit të tij ti shqiptoj një dënim më të butë, do të arrihet qëllimi i dënimit.

**I akuzuari V.I, në fjalën përfundimtare ka deklaruar, se e mbështet në tërësi deklarinimin e mbrojtësit të tij.**

**Mbrojtësi i të akuzuarit N.G, av. Haxhi Millaku, gjatë shqyrtimit gjyqësor të datës 27.05.2022, si dhe në fjalën përfundimtare të parashtruar me shkrim e të elaboruar edhe në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se, i ka propozuar gjykatës se duke u bazuar në gjendjen faktike e të vërtetuar gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe në përputhje me ligjin e zbatueshëm në kuptim të nenit 364 par.1 nën par. 1.3 të KPRK, të mbrojturin e tij N.G ta shpall të pafajshëm duke e liruar nga aktakuza për veprat që i vihen në barrë nga Prokuroria Speciale. Andaj me ndryshimin mbi bazën e ricilsimit të bërë nga PSRK-ja, ashtu siç e hoqi veprën penale në fjalën dhe bëri ricilsimin në bashkryerje për dy vepra që mbesin sipas akuzës. Po ashtu aktakuza PPS.nr. 16/19 të datës 12.05.2020, konsideron se aktakuza është e përgjithësuar nuk ka mbështetje në provat e siguruara gjatë procedurës hetimore të zbatuara nga prokuroria si dhe provat e administruara në shqyrtim gjyqësor. Po ashtu në shqyrtime gjyqësore janë administruar të gjitha provat të cilat kanë qenë të propozuara nga prokuroria por jo edhe provat e propozuara nga mbrojtja. Tutje i njëjti thekson se aktakuza në pjesën e provave verbale dhe materiale, deklaratat e dëshmitareve nuk ofrojnë fakte të mjaftueshme që të vërtetonin implikimin e të mbrojturit të tij në këtë çështje në çfarëdo interpretimi në vetvete dhe në raport me provat tjera nuk vërtetojnë dyshimin e bazuar mirë por mbesin në stadin e indicjeve apo dyshimit të arsyeshëm, pra nuk plotësojnë standardin e domosdoshëm që kërkohet nga ligjvënësi përtej dyshimit të bazuar mirë apo probabilitetin e të provuarit mbi faktet vendimtare. Po ashtu i mbrojturi i tij nuk njeh asnjë person çoftë të akuzuarit apo dëshmitarët të cilët edhe vetë në dëshmitë e tyre kanë thënë një fakt të tillë, por se njeh vetëm V.I, por asnjëherë nuk ka pasur ndonjë marrëdhënie biznesi apo pune me të. Po ashtu provat materiale e plotësojnë dhe e vërtetojnë gjendjen faktike si dhe vetë deklarimi i të mbrojturit të tij, dhe në përputhshmëri me njëra tjetrën vërtetojnë në mënyrë të pa dyshimit faktet relevante të sakta dhe të qarta elaborimi në seancat e kaluara e të cilat prova e lirojnë nga përgjegjësia penale dhe nga akuzat të mbrojturin e tij. Përkatësisht në shqyrtim gjyqësor janë dëgjuar dëshmitar janë lexuar disa prova si dhe i mbrojturi i tij nuk ka paraqitur mbrojtën para trupit gjykues, ka shfrytëzuar të drejtën të mbrohet në heshtje dhe ka mbështetur deklarinimin e dhënë në prokurori, duke vërtetuar qart, rrjedhshëm dhe saktësinë e fakteve dhe rrethanat që argumentojnë pafajësinë e tij. Gjithashtu nga dëshmitë e dëshmitareve nuk vërtetohet akuzat në asnjë mënyrë apo varant që pretendon prokuroria, përshkrimin e ngjarjes nga dëshmitar nuk e plotëson mozaikun e ngjarjes, pasi që PSRK është thirr në prova rrethanore të të mbrojturit të tij, por jo në fakte reale, elaboroj dy dëshmi të dëshmitares I.M dhe i implikoj në mënyrë supozuese- paragjykoj emrin e të mbrojturit tim se kinse ato medikamente janë siguruar nga ish polici por nuk ka emërtim, identifikim apo emër të mbrojturit tim sipas procesverbaleve. Asnjë nga dëshmitarët nuk identifikohet i mbrojturi im, as që përmendin ndonjë rrethanë apo veprim, sipas dispozitivit që ligësisht nuk lejohet të jetë një dispozitiv dhe dy cilësime, i cili dispozitiv nuk është i njohuri dhe teori dhe praktik që një pikë e dispozitivit të përfshihen dy vepra, është dashtë me u nda në dy pika të akuzës, është në kundërshtim me nenin 241 të KPPRK-së dhe len për tu shqetësuar se përmendet vlera e medikamenteve është 17 mijë euro, pa ndonjë ekspertizë përkatëse, apo së bashku me ndonjë farmacist që të vlerësohet vlera, dhe kjo është dashtë mu përfshi në pikën 2 të cilësimit të veprës penale tregtia e ndaluar, edhe pse nuk ka asnjë provë me veprim dhe mosveprim përfshihet i mbrojturi im. Ndërsa të bashkryeja neni 31 i KPPRK-së, nuk kemi hasë me asnjë veprim thelbësor të të mbrojturit tim se si “apontuohet emri N.G” të gjitha këto veprime të përshkruar në dispozitiv a kanë**

mundur të kryhen pa personin N.G dhe cila kanë qenë ato veprime esencialishtë të bashkryerjes ashtu siç thotë ligjvënësi, por i vetmi arrestim është se N.G është gjend të kohë të caktuar, në vend të caktuar dhe ne selin e caktuar, dhe asnjë a implikim nuk e ka as para as mbrapa. Andaj në mungesë të elementit esencial subjektiv-dashjes në të gjitha variantet e saja apo çfarë- motivi ekzistues kjo argumentohet edhe mbi bazën e për shkrimin të gjendjes se fakteve apo provave, aktakuza nuk ka arritur që të kalojë limitet ligjore që përtej dyshimit të bazuar të argumentoj dhe të vërtetoj fajësinë e të mbrojturit të tij, në të gjitha fazat e procedurës si dhe në shqyrtim gjyqësor. I njëjti i ka propozuar gjykatës, konform dispozitës së nenit 364 pika 3 të KPPRK, duke vërtetuar se nuk ka veprime inkriminuese dhe nuk mund të cilësohen si të tilla në aspektin juridik, pra nuk është kryes i veprës penale, sepse nuk kemi të plotësuar elemente qenësorë të figurës së veprës penale, për veprën penale nga neni 372 të KPRK, dh neni 305 të KPRK, në raport me të mbrojturin e tij N.G, kështu që N. nuk është kryes i këtyre veprave penale që i vihen në barrë dhe në mungesë se provave të mjaftueshme të lirohet nga Aktakuza e për çka gjykata të nxjerr Aktgjykim lirues.

**I akuzuari N.G, në fjalën përfundimtare ka deklaruar,** se e mbështesë në tërësi deklarin e mbrojtësit të tij.

**Mbrojtësi i të akuzuarit B.S, av. Imer Beka,** gjatë shqyrtimit gjyqësor të datës 27.05.2022, si dhe në fjalën përfundimtare të parashtruar me shkrim e të elaboruar edhe në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se, me provat e administruar gjatë procesit gjyqësor është deshmuar bindshem se aktakuza në tërësi është e pa bazuar dhe e pa argumentuar lidhur me të mbrojturin e tij sa i përket kualifikimit ligjor të veprave penale dhe në kundërshtim të plotë me nenin 7 par.1 dhe 2 të KPPRK, sepse prokuroria me asnjë provë të vetme nuk ka arritur të argumentoj se B.S me veprimet e tij ka kryer veprat penale. Përkatsisht në veprimet e të mbrojturit të tij, bazuar në provat që janë administruar gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk vërtetohet se këto kryer veprat penale për të cilat është duke u akuzuar. Po ashtu nga provat që janë administruar në shqyrtim gjyqësor nuk vërtetohet se i mbrojturi i tij të ketë kryer veprat penale për të cilat është akuzuar, nga deshmia e dëshmitarve dhe provat materiale që janë administruar është vërtetuar se prokuroria ka bërë kualifikim të pabazur dhe në kundërshtim me gjendjen faktike si dhe me provat me të cilat disponon i mbrojturi i tij, ka kryer veprën penale nga neni 372 par.2 e lëshur me par.1 dhe veprën penale nga neni 305 par.2 të KPRK, përkatesisht i mbrojturi i tij ka mundur ta kryej eventualisht veprën penale tregti e ndaluar, kjo në versionin se i është gjetur një pako me barna mjeksore të cilat janë të lejura në qarkullim dhe kjo për faktin se ky moment do të ishte inkriminues sepse i mbrojturi i tij, as që e ka ditur se kjo mënyrë e qarkullimit të këtyre barnave është e ndaluar, kur të njëjtat medikamente mjekësore i gjejmë në të gjitha barnatoret në Kosovë. Po ashtu u mbrojturi i tij pakon e pranur ia ka dhënë vëllai i tij, S. për ta dërguar në shtëpi dhe se i njëjti nuk ka ditur se çfarë barnash bëhet fjalë. Prandaj këto barna nuk i ka shpërndarë askun me qëllim të shitjes së tyre. Nga kjo rezulton se gjatë shqyrtimit të provave nuk është vërtetuar dashja për të kryer një veprim inkriminues e nga kjo del se në veprimet e të njëjtit, bazuar në gjendjen faktike të vërtetuar nuk formohen në tërësi elementet e veprës penale tregti e ndaluar nga neni 305 par.2 të KPRK, e as të ndonjë veprë tjetër penale. Po ashtu se pretendimet në aktakuz se i mbrojturi i tij paska shkuar në barantorene deshmities I dhe aty paska blerë me shumicë barna mjekësore me qëllim që të shet apo të kryen tregti të pa lejuar, një pretendim i tillë nuk është vërtetuar me asnjë provë, sepse deshmitaraj I në dehimin e saj nuk ka konfirmuar se B.S të ketë qenë ndonjëherë në barnatoren e saj për të blerë barana mjekësore si dhe nëshqyrtim gjyqësor nuk e ka njohur B.. I njëjti thekson se gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk është arritur të vërtetohet elementet qenësore të veprës penale, dashja dhe qëllimi si elemente që parashihen në nenin 21 dhe 22 të KPRK, pra nëse analizohen dhe interpretohen drejt dispozitat ligjore, atëherë vërtetohet se në veprimet e të mbrojturit të tij nuk ka ekzistuar qëllimi për të kryer veprën penale siç pretendohet në aktakuz, por në veprimet e të mbrojturit të tij B eventualisht mund që të formohen elementet e veprës penale tregti e ndaluar nga neni 305 I KPRK, e jo edhe vepra penale lidhur me armet ngase me asnjë provë nuk vërtetohet se i njëjti ta ketë kryer edhe veprën penale nga neni 372 të KPRK. I njëjti i ka propozuar gjykatës në pajtim me nenin 364 par.1 nën par.1.3 të KPPRK, të merr aktgjykim lirues për të mbrojturin e tij B.S për veprat penale nga neni 372 par.2 lidhur me par.1 të KPRK, ndërsa për veprën penale nga neni 305 par.2 të KPRK, të shqiptoj një dënim da me të lehtë.

**I akuzuari B.S., në fjalën përfundimtare ka deklaruar,** se e mbështet në tërësi deklarin e mbrojtësit të tij. I njëjti ka kërkuar që veturat të lirohen sepse nuk janë të përfshira në veprën penale.

**Mbrojtësi i të akuzuarit S.S, av.Emrush Kastrati**, gjatë shqyrtimit gjyqësor të datës 27.05.2022, si dhe në fjalën përfundimtare të parashtruar me shkrim e të elaboruar edhe në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se, gjatë shqyrtimit gjyqësor në seancën e sotme pas rikualifikimit të akuzës dhe deklarimit fajtorë të mbrojturit të tij për veprën penale e Tregtia e ndaluar e ndaluar nga neni 305 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, konsideron se në veprimet e të mbrojturit të tij formohen vetëm elementet e veprës penale Tregtia e ndaluar nga neni 305 par.1 të KPRK, e jo par.2, pa asnjë provë nuk është vërtetuar lartësia e mallrave, të trajtuar pa leje. I njëjti ka theksuar se në veprimet e mbrojtësit të tij, bazuar në provat që janë administruar në shqyrtim gjyqësor, nuk vërtetohet ta ketë kryer veprën penale për të cilën është duke u akuzuar. Po ashtu gjatë shqyrtimit gjyqësor me asnjë provë nuk është vërtetuar se i mbrojturi i tij, ta ketë kryer veprën penale nga neni 372 par.2 lidhur me par.1 të KPRK, dhe veprën penale nga neni 305 par.2 të KPRK. Përkatesisht i njëjti në këtë çështje penale ka mundur që ta kryen vetëm veprën penale tregti e ndaluar, e jo versioni që është gjetur një pako me barna mjekësore, pavarësisht këtij fakti kjo nuk do të thotë se ky moment inkriminuese, sepse i njëjti as që ka ditur se çka ka në pako, kur ia ka dhënë vëllai i tij Besimi për ta dërguar në shtëpi, pra ato pako me barna nuk i ka shpërnda dikund tjetër me qëllim të shitjes së medikamenteve mjekësore. Nga kjo rezulton se as këtë vepër penale nuk e ka kryer, pasi në veprimet e tij, bazuar në gjendjen faktike nuk formohen elementet e veprës tregti e ndaluar nga neni 305 par.2 të KPRK, e as të ndonjë veprë tjetër penale. Po ashtu sipas pretendimeve në aktakuzë se i mbrojturi i tij, paska shkuar në barantore të dëshmitares I.M dhe aty paska blerë me shumicë barna mjekësore që qëllim që tani ti shet apo te kryen tregti të pa lejuar, por një pretendim i tillë nuk është vërtetuar me asnjë provë, sepse dëshmitarja I. në dëshminë e saj të dhënë në gjykatë nuk e ka konfirmuar se i akuzuari S. të ketë qenë ndonjëherë në barnatoren e saj, për të blerë barna mjekësore, e as në shqyrtim gjyqësor se ka njohur S.S. Prandaj as gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk është arritur që të vërtetohen elementet qenësor të veprës penale, dashja dhe qëllimi si elemente që parashihihen në nenin 21 dhe 22 të KPRK, pra nese analizohen dhe interpretohen drejt dispozitat ligjore, atëherë vrehet qartë se në veprimet e të mbrojturit të tij nuk ka ekzistuar qëllimi për të kryer veprën penale siç pretendohet në aktakuzë, por në veprimet e të mbrojturit të tij S. S. eventualisht mund që të formohen elementet e veprës penale tregti e ndaluar nga neni 305 i KPRK, e jo edhe vepra penale lidhur me armet ngase me asnjë provë nuk vërtetohet se i njëjtit ta ketë kryer edhe veprën penale nga neni 372 të KPRK. I ka propozua gjykatës që me rastin e shqiptimit të dënimit të ketë parasysh kontributin e të mbrojturit të tij, sa i përket pranimit të fajësisë, ashtu që ta merr si rrethanë lehtësuese dhe ti shqiptoj një dënim në pajtim me KPRK, me mundësinë nga neni 44 të KPRK-së, që dënimi i shqiptuar ti zëvendësohet me gjobë. Po ashtu gjykatës i ka propozuar që të mbrojturi të tij, ti kthehet vetura O.K.me targa ....

**I akuzuari S.S, në fjalën përfundimtare ka deklaruar, se e mbështesë në tërësi deklarinimin e mbrojtësit të tij.**

**Mbrojtësi i të akuzuarit N.A av.Shyqri Sylla**, gjatë shqyrtimit gjyqësor të datës 27.05.2022, si dhe në fjalën përfundimtare të parashtruar me shkrim e të elaboruar edhe në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se, provat e administruar a gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk vërtetuan themelësinë e aktakuzës me të cilin është akuzuar N.A me 6 të pandehur I.M, V.I, N., B.S, S.S dhe tani i ndjeri F.H., për veprat penale nga neni 372 par.2 lidhur me par.1 të KPRK, dhe tregti e ndaluar nga neni 305 par.2 të KPRK, andaj me mohimin kategorik të të mbrojturit të tij, me dëshmitë e dëshmitareve dhe provat e pranueshme materiale të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk u vërtetua asnjëra prej këtyre veprave penale. Po ashtu me rastin e emërtimit përkatësisht kualifikimit juridik të veprave penale, padrejtësisht PSRK, ka emërtuar veprën penale që i dedikohet armëve, në fakt ky emërtim i veprës penale nga neni 327 të KPRK, përmban disa shprehje, gjatë cilësimit juridik të veprës, është dashtë të shënohen vetëm ato shprehje që i përgjigjen veprës konkrete. Përkatesisht nëse gjatë hetimeve provat materiale kanë vërtetuar dyshimin e bazuar mirë se i mbrojturi i tij N.A ka këmbyer armë, atëherë nuk është dashur të theksohet emërtimi kumulativ ligjor, për vetëm, me çka ka kryer veprën penale Këmbimi i paautorizuar i armëve, pra ka qenë e tepërt, e pa nevojshme dhe jo logjike të shënohet titulli i plotë i veprës penale sepse provat e pranueshme të hetuesisë nuk kanë vërtetuar, se i mbrojturi i tij i ka realizuar të gjitha veprimet inkriminuese nga titulli. Rrjedhimisht as nuk është dashur të akuzohet për të gjitha këto veprime alternative nuk është provuar me asnjë provë se i mbrojturi i tij, të ketë kryer veprat penale sipas rikualifikimit të veprës penale dhe propozon që i njëjti të lirohet nga akuza. Prandaj provat e pranueshme të administruar a gjatë shqyrtimit gjyqësor

nuk vërtetuan as gjendjen faktike të përshkruar si në dispozitiv të aktakuzës, e as cilësimin e veprave penale. Tutje i njëjti shton se nga vetë te pandehurit, dëshmitaret e proceduar vido-incizimet, fotodokumenatacioni, vërtetim për marrjen e dëshmimeve- nuk vërtetuan se N.A me dashje ka bërë bartjen e pakove. Pra sipas provave materiale e personale, dashja e tij ka qenë vetëm ofrimi i ndihmës fizike shoferëve gjatë ngarkimit- shkarkimit të tyre për shkak të fluksit të madh të punës ditën kritike, prandaj nuk ka qenë dëshira për tu implikuar në kryerjen e veprave penale. Ashtu që i mbrojturi i tij, nuk ka ditë as për pasojën eventuale që ka mund të shkaktohet gjatë kësaj ndihme, as që do të pranonte shkaktimin e saj, me arsyetimin që duke mos qenë pranues i mallit as nuk ka qenë në dijeni se ç'përmbanin pakot, se çfarë ka pasur brenda tyre, për çka ka kuptuar kur policia ka kontrolluar pakot në depo dhe me atë rast i ka zbuluar armët. Po ashtu me asnjë provë të pranueshme materiale nuk është vërtetuar që i pandehuri të ketë kryer veprën penale Tregtia e palejuar nga neni 305 të KPRK. Mirëpo duke theksuar faktin se përveç I.M. që një, i cili ka qenë drejtor i kompanisë, S.L, N.Anuk njih asnjërin prej të akuzuarve tjerë. I njëjti i ka propozuar gjykatës që nëse N.A është përgjegjës penalisht për veprat penale për të cilat akuzohet atëherë me rastin e matjes se dënimit të gjykata të vlerësoj rrethanat me të cilat dënimi të jetë në përpjesëtim me shkallën e përgjegjësisë penale dhe intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale. Andaj për tu arritur qëllimi i dënimit nga neni 41 i KPRK, mund të merren një varg rrethana lehtësuese, se është i martuar dhe baba i tre fëmijëve, është i gjendjes së mendë ekonomike, është i moshës së re, ka treguar sjellje korrekte gjatë gjithë fazave të kësaj procedurë penale dhe me parë nuk ka qenë asnjëherë i dënuar me aktgjykim fajësues.

**I akuzuari N.Anë fjalën përfundimtare ka deklaruar se e mbështet në tërësi deklarin e mbrojtësit të tij.**

**Mbrojtësi i të akuzuarit A.I, av.Arber Shala,** gjatë shqyrtimit gjyqësor të datës 27.05.2022, si dhe në fjalën përfundimtare të parashtruar me shkrim e të elaboruar edhe në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se, pasi që i pandehuri A.I gjatë gjithë procedurës deri në shqyrtimin e sotme një ndër veprat që i ngarkohet ishte Tregtia e ndaluar e ndaluar nga neni 305 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, ndërsa sot me ndryshimin e akuzës i njëjti ngarkohet me veprën penale Tregtia e ndaluar e ndaluar nga neni 305 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, gjë të cilën e kundërshton duke konsideruar si pa meritore dhe të pa bazuar. I njëjti ka theksuar se nga përmbajtja e aktakuzës por edhe nga provat që janë administruar në këtë shqyrtim gjyqësor vërtetohet se A. I nuk është kryes i verave në penale. PSRK, ka dështuar të argumentoj se cilat veprim inkriminuese i ka ndërmarr i mbrojturi i tij, në drejtim të kryerjes së veprës penale nga neni 305 të KPRK. andaj për tu përmbushur figura e veprës penale Tregtia e ndaluar, kryerësi duhet ta manifeston atë në tri mënyra, me shitjen e emalit, sendit apo shërbimit pa autorizim, blerja e mallit, sendit apo shërbimit pa autorizim dhe shkëmbimi i mallit, sendit dhe shërbimit pa autorizim dhe duke qenë se, kryerësi i kësaj veprë konsiderohet dikush që të paktën e ka ndërmarr njërin nga këto tri veprime, në rastin konkret nuk është arritur të provohet asnjë veprim se i mbrojturi i tij, që e inkriminon atë në këtë veprë penale që i vihen në barrë, pasi që prokuroria me asnjë provë të vetme nuk ka arritur që të vërteton se A.I ka blerë barin Tamoil XX dhe i ka shitur dikujt tjetër pa autorizim. Po ashtu faktin se Tamoil nuk bënë pjesë në tregun e jashtëligjshëm dhe nuk ka nevojë dikush për autorizim ta blejë atë, meqenëse i njëjti mund të blihet në çdo lokal që ofron shërbime farmaceutike, e që i bie që cili do person që do e blinte këtë bar/medikament që përdoret kundër dhimbjes, nuk do kishte përgjegjësi penale, meqenëse bari në fjalë nuk është pjesë e tregut të kundërligjshëm. I njëjti shton se pretendimet e PSRK, A.I ka blerë barin në fjalë dhe ka shitur tek dikush tjetër, mbete vetëm supozim, meqenëse ky pretendim në asnjë fazë të shqyrtimit gjyqësor nuk ka arritur të mbështet në prova që e inkriminojnë të njëjtin për këto vepra penale që i vihen në barrë, por të kundërtën me provat e propozuara nga PSRK, gjemë vetëm elemente shfajësuese për veprën penale Tregtia e ndaluar. Po ashtu me asnjë provë të vetme nuk është vërtetuar se këto barëra i ka blerë A.I dhe me pas i'u ka shitur B. S.S. Të gjitha këto pretendime të prokurorisë janë vetëm supozime juridike, ku prokuroria ka dështuar të argumenton se cilat veprime inkriminuese i ka ndërmarrë A.I. Përkatësisht i beson deklaratës së dëshmitares I. M. se barërat Tamoil XX ia ka shitur A.I, por me asnjë provë të vetme nuk ka arritur që të vërtetohet ky dyshim, gjithashtu deklarata e I.M vetëm që është e pa bazuar po e njëjta është bërë me qëllim të hakmarrjes ndaj A.për faktin se ata nuk kanë raport me njëri tjetrin. Po ashtu A. I.as që i janë zënë barëra të llojit Tamoil dhe prokuroria nuk ka asnjë provë apo dëshmi konkrete me të cilën vërtetohet se këto barëra i ka blerë e pastaj i ka shitur. Përkundrazi bari tamoil xx është produkt medicinal me veti analgjetike dhe është bar

qe blihet në barnatore, kjo vërtetohet nga provat e administruar- shkresa zyrtare e Agjencisë së Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale Nr. 01 372/2 e datës 09.02.2022 pra i njëjti është bar kundër dhimbjes qe mund të blihet nga çdo person në barnatore. I njëjti i ka propozuar gjykatës qe ndaj të mbrojturit të tij gjykata te sjell aktgjykim lirues pasi qe in jëjti asnjëher nuk ka blerë apo shitur barëra te llojit Tamoil me qellim të përfitimit të kundërligjshëm.

**I akuzuari A.I, në fjalën përfundimtare ka deklaruar se,** e mbështet në tërësi deklarinimin e mbrojtësit të tij.

Gjykata gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor ka administruar si prova personale- dëgjimi i dëshmitarit M.P të dhënë në shqyrtimin gjyqësor të dt. 21.10.2021, dëgjimin e dëshmitarit A. A. të dhënë në shqyrtimin gjyqësor të dt. 21.10.2021, dëgjimin e dëshmitarit M.K të dhënë në shqyrtimin gjyqësor të dt. 01.11.2021 dëgjimi i dëshmitarit B. M. të dhënë në shqyrtimin gjyqësor të dt.01.11.2021, dëgjimin e dëshmitares I.M të dhënë në shqyrtimin gjyqësor të dt:17.01.2022,

Ndërsa si prova materiale gjykata ka administruar si: Vërtetimi mbi marrjen e sendeve, Video incizimet e nxjerra nga pajisjet e marra në firmën “S.L”, Raporti i ekzaminimit të armëve i dt.24.05.2019, Vërtetimi mbi marrjen e dëshmime të dt.21.03.2019, Vendimi i Inspektoratit farmaceutik i dt.01.10.2019, njoftimi i AKPM-së me nr. 372/2 i dt:09.02.2022, vërtetimi për sekuestrimin e përkohshëm të sendeve-të hollave i dt.06.09.2019, si dhe raporti i firmës S.-L mbi tërheqjen e të hollave nga njësia në P., Raportet policore mbi zbatimin e masave të fshehta, procesverbalet e inspektoratit farmaceutik. foto dokumentacioni si dhe shkresat e tjera të cilat janë pjesë e shkresave të lëndës.

**Provat personale-dëshmitari M.P** në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 21.10.2021 ka deklaruar, se i njëjti e ka kompaninë e kontabilitetit ku jep shërbime firmave të ndryshme, shërbime të kontabilitetit financave dhe të auditimit. Shërbime të kontabilitetit jep në kompani të ndryshme në regjionin e M. P.dhe V., si kompanisë S., I., K., S. M., etj. Pasi ka kompaninë kontabilitet e financa dhe menagjim të financave të gjitha këto shërbime i ka dhënë edhe në S.L si dhe këshillave tatimore. Shërbime për S.L ka jap në bazë të kontratës ku ishte i detyruar ta ketë një kontratë për shërbimet e lartë cekura, atë kontrata e ka lidh mes dy aksionareve në atë kohë që kanë qenë në S.L I. M. dhe R.B.. I njëjti thekson se selinë qendrore S.L fillimisht e ka pas në M., pastaj edhe në qytete të ndryshme, ndërsa mbas një periudhe 3 mujore është zhvendos në M.rruga magjistrale P.M.Vetë ai ka pas qasje në selinë qendrore kryesisht, ndërsa në zyrat qendrore ka pas qasje direk sepse dokumentacioni nuk ka mundur ti barti në zyrën e tija, prandaj ka qenë e nevojshme që qasja e tij të jetë në selinë kryesore në kompaninë në fjalë, më sakte në S.L, kryesisht në zyrat e saj administrative. Ndërsa vetë ai i ka njohur pronarët që e ka nënshkrua kontratën po ashtu ka njohur dhe menagjmentin për arsye se puna e tij ka qenë që të është në koordinim me të gjithë menagjmentin për shkak të libër mbajtjes për kontabilitet kurse nga menagjmenti ka njohur të gjithë ndërsa N.A ka qenë menagjer në selinë P.. Tutje ka shtuar se ka takuar persona të ndryshëm për të cilët ka pas interes për shërbime të kontabilitetit ku kompania ka pasur barazime të kartelave financiare, në zyrët ka pasur mundësi ta takoj V.I. por nuk është i sigurte, pasi ka kaluar kohë e gjatë nuk e mbanë mend kush ka qenë e kush jo, pasi qe deklaratën e dhëne në polici është datë e largët, i njëjti deklaroi se ka kryer shërbime edhe për kompani tjera dhe fluksin e njerëzve qe mund ti ketë takuar nuk i mbanë ne mend sepse nuk ka pas interes profesional për ti mbajt në mend. Po ashtu i kujtohet në deklaratën e dhëne, se ka qenë një person që nuk e ka njohur me emër mirëpo e përshkruan, ka qenë i gjatë me trup në fytyrë zeshkan, jo i plotë, ka pas flokët të zeza. I njëjti ka theksuar se atë ditë kur është bërë kontrolli vetë ai nuk ka qenë por e ka pa që administrata tatimore i ka lënë shkresë për disa libra, dhe me atë e ka kuptuar që ka qenë një kontroll nga administrata tatimore së bashku me policinë dhe doganën nga menagjenti i S.L ndërsa nga momenti kur e ka kuptuar që kishte kontroll pas këtij rasti nuk i kujtohet as që i ka pa as jo, kur e ka dhanë deklaratën ka qenë memoria më e freskët tani nuk i kujtohet, mirëpo pasi të akuzuarit janë ngritur ne këmbë dhe vetë dëshmitari mund ti shikojë të akuzuarit, i njëjti shton se I.M ka qenë pronarë, N.A ka qenë menagjer, me sa i kujtohet ka qenë edhe M. G., mirëpo për këtë deklarohet vetëm aq sa ka mbajt mend nuk është i sigurt, ndërsa tani nuk i kujtohet saktë. Tutje ka theksuar se zyra që ka pasur qasje ka qenë hapësirë ku ka pas hyrje dalje po ashtu edhe nga pjesa poshtme ku ka qenë depoja dhe pjesa sipërme ku ka qenë një holl i madh para zyrës të administratës, në zyrat e S.L gjithmonë, ka pasur pako të shumta ku kanë pas për qarkullim me u dërgua tek klienti, ka qenë natyrë e biznesit, ndërsa

gjatë kohës se frekuentimit dhe kalimit në pjesën e depos ka pas mundësi të hasi në persona se ka qenë fluks i ndryshëm i personave që kanë punuar aty dhe që kanë shkuar me i marr pakot e bizneseve ose që i kanë sjell aty, kam parë njerëz aty mirëpo s'ka qenë kompetenc e tija të pyes se çka kanë punë ata aty. Me tej thekson se pësonin nga Maqedonia nuk mund ta përshkruan pasi qe nuk ka pasur kontakt me atë person dhe nuk i ka kushtua vëmendje por nuk i kujtohet. Tutje shton se mallrat të cilat dërgohen-dorëzohen tek klientët në destinacion të caktuar bëhet, një produkt e ka pas vlerën 10 euro atëherë postieri i ka kthye prapa 10 euro dhe i ka shënuar në sistem ato të holla ose ta kthej pakon prapa, dhe ia kemi kthyer dërguesit në këtë rast pakon, ka pas raste tjera ku dorëzuesi dhe pranuesi janë dakorduar që mes bankës ti kryej pagesat ndërsa S.L ta dërgoj vetëm mallin, kanë qenë të aplikueshme të dyja, përkatësisht S.L ka pas dy forma të tarifimit-marrjes së shërbimit që e ka marr. Njëra formë ka qenë me faturë mujore nëse ka qenë mujorë, ndërsa forma tjetër që ka mund me qen biznes ose qytetarët i ka ndaluar në atë shumë që e ka marr prej klientit, ose në rastin që nuk ka pas vlerë i ka marrë ne fillim prej mallit varësisht nga marrëveshja me klient ose i kemi faturua në fund të muajit. I njëjti me tej ka theksuar se gjatë kohës sa ka kryer shërbimet e kontabilitetit personat- pronaret, menagjmenti nuk i kane treguar për natyrën e vizitës se ndonjë personi për biznes dhe vetë ai nuk ka pasur autorizim me ditë se për çka kanë qenë në vizitë dhe nuk i kanë treguar pronaret e biznesit se për çka po shkojnë personat me vizituar, shton se V.I. e njehë edhe si qytetar të M.pasi ka banuar dhe punuar në M., mirëpo V.I. në hapësirat e S.L e ka parë me shumë se një herë, ndërsa sa i përket veturës me tabela të Maqedonisë e di se një herë ka qenë një veturë e parkuar prapa makinës se tij, ka kërkuar që me e largu atë veturë kurse pyetjen qe i është bërë në polici se a ka pas persona nga M. në S.L, dhe direkt duke i nxjerr fotografi se a i njeh këta persona dhe në atë kohë memoria ka qenë më e freskët ka mundur ta shoh se a ka qenë ndonjë person a jo. Tutje ka theksuar se në firmën S.L ka punuar si kontabilist me kontratë, dhe ka pasur autorizime ta përfaqësoni kompaninë në ATK, dhe se e njëjta firmë ka qenë e pajisur nga ARKEP për punën qe ka bërë dha ka raportuar në ARKEP çdo 3 muaj, kurse në libri që ka mbajtur ka qenë libër i shtijës, i blerjes dhe i arkës. Libri i shitjes përmban kategorizimin e madhësisë se pakove sipas ARKEP-it, libri i blerjes përmban shpenzime sepse biznesi në fjalë ka dhënë shërbime të transportit të pakove nga biznesi tek klientët dhe libri i akrës mbanë të gjithë transaksionet e të hyrave nga bizneset dhe individët që kanë qenë për hyrjen e daljen e pakove nga biznesi tek personat. Po ashtu libri i arkës ka qenë sipas transaksioneve si ka lëviz regjistrohë në datën që ka lëviz, të gjitha barazimi i bankës me biznese që lëshojnë fatura, me qytetarë, libri i bankave, llogari të pagueshme, deri në pasqyrat financiare, kurse në libra nuk është emri i produktit për shkak se ka qenë shërbim, dhe se i njëjti ka mbështetje ligjor. Lidhur se si janë identifikuar pakot vetë ai nuk e dinë saktë se si i kanë karakterizu por pakot kanë qenë l.xl. xxl. Kategorizimin e ka bo me kunotë ( informacion letër) ku kanë qenë info të dërguesit dhe pranuesit ndërsa përmbajtja brenda nuk ka shënuar se çka është, përveç brenda Kosovës ka pasur mundësi me pranuar pako edhe jashtë Kosovës por jo një sasi e madhe ka qenë sasi e vogël nga Maqedonia ose Shqipëria, ka qenë vlerë e vogël që nuk kanë kalua përmes doganës dhe që kanë shkuar direkt tek qytetarët, ndërsa për pakot qe kanë hasur policia se a kanë qenë nga jashtë apo nga ku vetë nuk është në dijeni dhe para se te ndodh rasti ka qenë në vizitë në ATK, dhe kemi raportin e të njëjtin e kanë dërgua në zyrë të ankesave sepse nuk i ka marr parasysh disa pagesa të naftës në vitin 2017-2018, ndërsa për barazime hyrje e daljet dhe t shikohet produkti nuk janë në stok të kompanisë por në momentin qe janë dorëzuar ato pako janë faturu biznesit apo qytetarit dhe sa i përket gjendjes faktike vetë ai nuk ka qenë i thirrur për atë.

**Dëshmitari A.A** në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 21.10.2021 ka deklaruar se i kujtohet qe ka dhënë deklaratë në polici por data nuk i kujtohet, i njëjti shton se ka në posedim 50 farmaci me emërtim “G.F.”, dhe se këto farmaci i menagjon dhe është pronar i tyre, me këtë veprimtari merret nga viti 2013. Farmaci ka në disa qytete ku shet barëra me licencë me shumicë dhe pakicë pra produkte farmaceutike që funksionojnë në Kosovë në bazë të licencës dhe furnizohet prej krejt furnitorëve të Kosovës ndonjëherë importon edhe vetë. Tutje ka theksuar se nga personat fizik nuk i ka ndodhur te blejë barëra asnjëherë, kurse procedura e shitjes, është se vetë ai i dërgon të farmacitë e tij dhe aty shkon klienti i blenë, pasi i ka farmacistët profesional dha nga aty blejnë klientat, mundet me ardhur dikush me shumice me ble shkon te depoja ose thirre në tel, ose dërgon email dhe vetë ai ju përgatitë faturën dhe ju dërgon mallin, kurse nuk ka pasur rast qe në barnatoret e tyre qe t’ju shesin barëra. Tuje thekson se pas rikujtimit te deklaratës se dhënë në polici se “ po i njoh këta dy persona e di që janë vëllezër por nuk e di cili është Besimi e cili është S.” ka qëndruar prapa deklaratës se dhënë, ndërsa këta persona nuk kanë ofruar barëra për të blerë nga ta (B. ose S.) dhe nuk ka njohuri se me çfarë janë marrë vëllezërit S.. I njëjti ka shtuar se lagenistat i

dërgojnë dhe sot në barnatore distributor kush i ka me i shit i dërgon në barnatore lloj oferte e mallit, konkretisht nuk ka njohuri se B dhe S.S në barnatoret e tij te kenë lënë katalogje, po ashtu në polici ka deklaruar se kanë mund ti lënë tek unë ndoshta dhe i kanë lënë, se nuk merrna me ta, farmacitë e mija janë të dalluara që nuk ka asnjë invazion në to, se mundohem me i mbajt në rregull ato. Tutje shton se ka pranuar mall përmes kompanisë S.L, nga një kompani qe furnizohet është Aleancë Kosova, vetë ai ka bërë porosinë tek ajo kompani e cila gjendet në Mitrovicë, pas porosisë i ka shkuar malli me postë, i ka ndodh dhe me posta tjera përveç S.L, ndërsa pagesat i ka bërë përmes faturës kurse shpërblimin-taksën e transportit e ka paguar A. K.. I njëjti ka theksuar se edhe pse është me profesion farmacist emërtimi i barit “Tamol”, pasi ka shumë lloje barna qe si kujtohen.

**Dëshmitari M.K** në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 01.11.2021 ka deklaruar, se nuk i kujtohet qe ka dhënë deklaratë në polici pasi qe nuk e kanë thirr asnjëherë përveç se gjykata qe e ka thirre. Tutje thekson se punon qe 5 muaj në firmën A.si taksistit në F.K., me parë ka punuar në post private e cila quhet M. M., nuk i kujtohet saktë kur ja ka nisë por e ka përfunduar në muajin Prill 2021, në vitin 2019 ka punuar në posta të ndryshme të tjera, si posta “P. K”, ndërsa ka punuar në pozitën vozitës në S.L nga viti 2017/2018 ose 2019 nuk i kujtohet saktë. Kontratën për marrëdhënie pune e ka lidhur me pronarin e postës I.M, detyra e tij ka qenë të shpërndajë porosi të ndryshme tek klientat mallin e porositur. I njëjti ka theksuar se në Mars të vitit 2019 e ka thirr menagjeri i firmës S.L N.A për me shkuar me i marr do pako në një lokacion në Fushë Kosovë, më pastaj i ka thënë se është shumë i zanë nuk mundem me shku me i marr, ai kishte thënë se drejtori po thotë se duhet me shku patjetër me i marr, me pastaj ka shkuar qe ti marrë pakot të ndryshme te rruga Xh. M. në F.K. i ka marr ato pako nuk i kujtohen sa pako janë kanë por diku 10 ose 15 nuk e din saktë, ka qenë në një lokal me xhama të zi, ka qenë thatë lokali, një person i moshës madhore me flokë të bardha ia ka dhanë, ka qenë afro 60 vjeç, dhe se pakot i ka dërguar në depon e S.L në M., veç i kanë shprazë me koleget e tij dhe kanë vazhduar tutje se e kanë përfunduar orarin e punës, për ketë e ka njoftuar menagjerin N.A dhe për ato pako nuk kanë marrë fatura as pare, por vetëm me telefonatën e drejtorit për me shku me i marrë kurgjo tjetër. Pakot kanë qenë të zakonshme paketa sandarte dhe nuk ka pasuri njohuri se çfarë ka pasur, përkatësisht fjala konot është kur të dërgohet një pako prej dërguesit tek pranuesi, me të dhënat e dërguesit dhe pranuesit, dhe dërgesa nuk kishte konotë, dhe vetë ai nuk ka pasur njohuri se çka ka pasur ne ato pako përveç kur është njoftuar nga policia përmes telefonit të cilët e kanë ftuar që të takohem, për ti treguar vendin ku i ka marr pakot, ju ka treguar ku i ka marr e të njëjtin e kanë shoqëruar në polici, ku ka dhënë deklaratë dhe është kthyer në shpi. Me tej ka theksuar se nuk i kujtohet saktë kur e ka lëshuar punën nga kjo firmë por nëse nuk gabon në Nëntor të vitit 2019 pasi qe është mshel firma krejt. Tutje ka theksuar se kur kanë shkuar ti marrin pakot përveç pakove të ngarkuar kanë pasur edhe gjera ushqimore qe ka qenë rutinë e punës, ndërsa kur kanë shkuar me marr mallin nuk ka kërkuar asnjëherë qe të hapet pako me këqyr çka është pasi shihet me sy se pakot kanë qenë të tejdukshëm, shihet çokollata, përveç atyre pakove që nuk kanë qenë të tejdukshme. Ndërsa për pakot qe nuk kanë pasur konota i kujtohen se nuk ka pas sende tjera kanë qenë paketa blanko, edhe pse ka punuar si vozitës në posta të ndryshme nuk ka guxuar me marr pako pa konot sepse nuk ka ditë ku me dërgua atë pako po ashtu pakot e marra pa konot kësaj here ka shkuar mi marr se ka qenë urdhër i drejtorit, ose a deshtë me shku me i marr ato paketa apo me dalë prej punës, vetë ai i ka thënë menagjerit jo nuk mundem por më ka thënë drejtori po thotë. Vendin se ku janë pakot me i marr i ka thënë drejtori I.M në vendin e cekur me lartë, sa i kujtohet numrin e peronit që ka pas me i marr pakot, ia ka dërguar drejtori me sms dhe ka kontaktuar me personin ku je, i cili i ka thënë hajde, është shkuar dhe është takuar me atë person, i cili ka thënë qeto pako ke me i marr ia ka ngarkuar ndërsa pesha e tyre, edhe të lehta jo, ka i kanë ngarkuar dhe shkarkuar, kur pse nuk kanë pasur konot nuk ka qenë përgjegjësi e veta me ju përzi drejtorit se a i merr pa konot apo me konot. Tutje shton se B.S dhe S.S nuk i njeh, ndërsa menagjeri N.A ka udhëheq piken e transportit e ka thirre me shku tek klientët e rregullt me marr pako, por edhe e kanë pasur listën ku kanë pas me shku kurse lidhur për transportin nuk ka marr para.

**Dëshmitari B.M.** në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 01.11.2021 ka deklaruar, se i kujtohet deklarata e dhënë në polici e te cilën deklaratë e mbështet, tutje shton se me profesion është ekonomist i diplomuar, më herët ka punuar në një kompani që quhet M.sh.p.k, ndërsa tash e ka lokalin e tij, që mirret me shitjen e pajisjeve elektro-shtëpiake, i cili gjendet në magjistralen P.-F. K., rr. N. T., firma quhet B. T., dhe vetë është pronar qe nga viti 2019, në të cilin lokal ka punuar një punëtor i vetëm F.H., kurse fqinjët nuk i njeh se kush janë. I njëjti ka theksuar se e njeh V.I e ka edhe shok, edhe për kohen të cilën

po flasim kanë pas bashkëpunim në lidhje me pajisjet të cilat janë shitur në lokalit e tij, bashkëpunimi që kanë pasur ka qenë se V ka sjellë pajisjet prej jashtë, dhe vetë ai i ka blerë prej tij dhe i ka shitë në lokalit e tij, ndërsa vetë qenë përgjegjësi kryesor për mbarëvajtjen e lokalit, tuje thekson se N.G e ka njohur përmes V., ndërsa nuk ka njohuri-dijeni dhe nuk i kujtohet që në lokalit e tij, ka pas edhe gjera disa pako të vendosura që nuk i përkasin pajisjeve elektor shtëpiake. I njëjti ka shtuar se është njoftuar me telefon se lokali i tij ka është duke u kontrolluar prej hetuesve policor, që është bërë bastisja, me të marr telefonatën ka shkuar në lokal dhe e kam parë që lokali është bastisë, ka qenë në dijeni se në lokalit e tij nuk është gjetur asgjë e dyshimit, dhe ka qenë prezent gjatë bastisje që ka vazhduar, po ashtu nga ana e hetuesve policor e ka kuptuar arsyen se po kërkohen armë dhe barna. Tutje shton se punëtori i tij i ka raportuar për shitjet e bëra kurse nuk e ka informuar që nga lokali janë larguar pako po vetë ai me vonë ka ra në dijeni dhe sqaron se këtë situatë sepse bëhet fjalë për një objekt me hyrje të veçantë, ai ka qenë një lokal parimisht, masanej është ndarë në dysh, dhe pjesa e lokalit të tij, ku është bastisë nuk kanë gjetur asgjë, ndërsa sa i për këtë hyrjes tjetër ku ata pretendojnë nuk ka qenë në përgjegjësin e tij. Është ra në dijeni kur ka shkuar në polici dhe aty kuptova se prej atij vendit pretendohet se janë tërhequr disa pako prej hyrjes tjetër që vetë s'ka pasur qasje, ndarja e lokalit është bërë për arsye të shpenzimeve, një pjesë e lokalit ka mbete në menagjimin e tij kanë arrite marrëveshje që qerja ka qenë në total 500 euro, vetë ai ka paguar 300 euro ndërsa V ka paguar 200 euro, për pjesën e dhënë V. edhe pse F. H. ka qenë punëtor i tij nuk ka dijeni se tani i ndjeri F.H te këtë kryer shërbime edhe për dikon tjetër, përkatësisht lokali i ndarë ka pasur dy hyrje përjashta, para bastisjes lokalit e ka ndarë 4-5 muaj, po ashtu gjatë kohës sa ka funksionuar biznesi gjithë çka ka qenë në rregull, ka pas edhe dokumentacion, ka pas edhe kontabilist, për V. nuk e di se a e ka pas atë kontabilist, ndërsa me posten S.L nuk ka pas asnjëherë asnjë kontakte, para se të filloj me biznes e kam njoftë V., idea me vazhduar me biznes ka qenë e të dyve.

**Dëshmitarja I.M** në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 17.01.2022 ka deklaruar, se ka dhënë dëshmi dy here në polici dhe një herë në prokurori, herën e parë kur ka shkuar nuk kam muajt me thanë të vërtetën për arsye se fillimisht për vetë faktin që ka qenë në polic, ndërsa arsyeja e dytë personit që ja ka shitë barnat i ka thënë mos me tha të vërtetën. Pas dy ditëve që ka dhënë deklaratë për herën e dytë në polici ka ndje obligim moral shpirtëror për ta treguar të vërtetën, i kujtohet përmbajtja e dëshmisë se dhënë polici dhe deklaratën e dhënë në prokurori dhe qëndron pranë deklaratës se dhënë në prokurori tutje e shton se barnat ja ka shitë shoku të saj A.I ku vetë ajo ka pas barnatoren e saj që quhej "B. P.", pasi A e ka pas shok të familjes pasi njihen më shumë se 18 vite, dhe konsideron sikurse vëlla, dhe i cili i ka thënë se po me duhet me marr kësi barna, sado që merr unë ti blej, edhe ka filluar me porosit barna, A. ka shkuar i ka ble në barnatore e të cilat janë barna Tamol kurse, A. ka shkuar i ka marr në barnatore, dhe i kanë numëruar bashkë aty, e aty për aty ia ka paguar. Me tej thekson se A. ka ndodh me ardhë mi ble barnat me një person tjetër e që nuk ka qenë vetëm, e të cilët persona i përshkruan se njeri që ka shkuar ka pasur pak mejkër zeshkanë e tjetri ka qenë i dobët në peshe me moshë mesatare ndërsa A. e ka përmend një person serb G. apo C. që saktë nuk i kujtohet, vetë ajo kur i ka shitë barnat brenda në barnatore dhe për këtë fakte është dënuar nga Ministria e Shëndetësisë, sepse të njëjtat janë shitë me shumicë, dhe personat që i kanë marr prej saj barnat nuk kanë pas drejtë me i shitë. Tuje shton se personat që bëri përshkrimin me lartë nuk e din a njëfë sepse ka kaluar kohë e gjatë, e njëjta e kthen kokën nga publiku i ka shikuar të gjithë të pranishmit dhe ka identifikuar një person në qoshe së është B.S. edhe pse ka kaluar një kohë e gjatë dhe nuk është e sigurt por beson se ai person e ka shoqëruar A.In, është edhe një për personin tjetër që përngjanë që ka qenë me A po nuk është e sigurve. E njëjta ka theksuar se për ditë datë dhe muaj se kur dhe me kë e ka parë A nuk mund ta dinë se ka kaluar kohë e gjatë, dhe nuk është e sigurve që B.S ka qenë me A. E njëjta ka theksuar se barnat që i kanë shitur i ka lëshuar me kupon kurse A. nuk i ka marrë asnjëherë kuponin nuk e kanë shtypur se A. i ka thënë nuk ka nevojë me shtyp. Po ashtu në kohën kur ka shitë barna ka qenë në grupin e analgjezikëve, ndërsa inspektoriati e ka njoftuar që në rajon janë narkotik vetë e njëjtat thekson se me protokoll kanë qenë në Kosovë në grupin e analgjezikëve, i kanë shitur si mallë dhe kanë lëshuar si kupon. Me tej ka theksuar se vetë me profesion është ekonomiste por farmacinë e ka pas A. M. për barin e përmendur ka qenë i regjistrat e MSH dhe e ka parë se kanë qenë në grup të analgjezikëve kurse në barnatore punon që 13 vite, ndërsa barnat që i ka shitur A.nuk ka mbajtur evidencë sepse A e ka llogaritur si vëlla vetë ajo nuk ka dijeni se në cilin grup të barnave hynë pasi që nuk është furnizuar më këtë lloje të barnave, kanë pasur te drejtë vetëm me recetë të mjekut me e shitë.



**I akuzuari I.M në mbrojtjen e tij** të dhënë në shqyrtim gjyqësor të datës 23.02.2022 ka deklaruar se, vetë ai ka jetuar në Gjermani nga viti 1992 dhe ushtron këtë veprimtari afër 25 vite, është partner i DHL, i D. postes, dhe partner i DPD në Gjermani. Me këtë veprimtari, në Gjermani merret në qytete të ndryshme, dhe me eksperiencën që e ka, ka ardhë edhe në vendlindje me ushtru veprimtarin e njëjtë pasi që e ka pa se Kosova ka pas mungesë në këtë veprimtari dhe ka vendosë me hap kompaninë S.L. Kompania S.-L. ka filluar në gusht të vitit 2016 me parapërgatitje p.sh, sisitemin softuerik për çështje sigurie dhe për një funksionim profesional, që deri në atë moment as post-telkumunikacioni nuk i ka poseduar atë sitëm dhe akoma nuk e posedon për Çka ju ka nevojitur ky sistem kompanisë, dëshiron të futet pak në detaje për arsye që të zbardhet ose shpjegohet saktësisht se si funksionin një transport postar për kontrollimin e dërgesave. Transporti postar është mundësi e kufizuara, dmth është pika nr.1 konfidencialiteti i pakos, dmth me ligjin ndërkombëtar për të drejtat e njeriut duhet të mbrohet pa masë, na jep që të kuptojmë se një kompani postare nuk ka të drejtë ta hapa pakon, mirëpo sa i për ketë rregullatorit të Kosovës që është i autorizuar për pa tentimin apo licencimin e postave ose shërbimeve postare ekziston dëshmia e larg-përmendur për këtë arsye pasi që transporti postar është i kufizuar për dijen e brendësisë së pakos prej anës së ARKEP-it, për të rregulluar që ligjërisht transporti postar mbanë përgjegjësi të deklarimit të pranuesit dhe dërguesit me këtë përgjegjësia e transportit postar merr fund për arsye të lartpërmendura konfidencialitetit, në këtë sitëm softuerik të S.L kemi krijuar mundësi të shumta për çështje të sigurisë kur njëra prej tyre ka qenë krijimi i identitetit të pakos, prej anës së dërguesit për çfarë arsye e kemi bërë këtë, që mos me pas mundësi manipulimi që identiteti i pakos të krijohet prej palës së tretë dmth secili klient i kompanisë S.L, e ka pas qasjen në vete personale ku është krijuar prej një user name dhe password personal. Qëllimi i kësaj ka qenë që të jetë përgjegjësia te dërguesi për arsye që nuk i kemi pas të drejtë që ta kërkojmë prej dërguesit deklarimin e pakos e ka ndaluar ARKEP-i me rregullore për arsye konfidencialiteti, pra e vetmja mundësi për sigurinë e kompanisë ka qenë që identiteti i pakos të jetë në përgjegjësinë e dërguesit dhe kompania ka qenë në përputhje me ligjin, çka ka pas kompania përgjegjësi te pranuesi kjo ka qenë një eksperiencë e re për mua. I njëjti thekosn se që 25 vite në gjermani nuk e ka perjetu, mundësit e adresimeve të Kosovës (mos të tham çdo i dyti, dhe i treti person nuk e ka ditë adresën e vetë) për këtë arsye kemi kontaktuar shumë në telefon për me realizu dorëzimin dhe kjo ka qenë e pa mundur për me u identifiku në mënyrë të rregullt pranuesi. Nga përvoja e tij ne Gjermanisë thotë që kur të shkon në adresën e saktë, kur trokite në derën e duhur prej 100 %, 95 % del personi që është pranues dhe nuk e kemi obligative që personin pranues ta identifikojmë me letërnjoftim apo dokument për arsye që logjikisht del personi që i ka porosit. Në Kosovë 95 % të rasteve i kemi dorëzuar në rrugë, vetëm 5 % të rasteve nëpër shpija, për arsye se p.sh jam në kafe tu pi kafe te B.R., shtëpin e kam në breg të diellit ma sjellë pakon te B. R. thotë aty poshtë, na me mundësit për shkak se tregu është i ashpër dhe nuk ka kurrfarë rregullore, dhe nuk i përmbahet askush rregullores as PTK, atëherë jemi të obliguar për shkak të klientit me ju ofru këtë shërbim palës, kemi raste me mijëra, kemi pas raste kur gruaja ka shkuar në bankë ka hapur xhirologari fshehtas burrit, dhe e ka dhënë numrin e telefonit të burrit, është kërcënuar vozitësi, kompania gjoja se na po kqyrim me i shit produkt bankar, e raste të tilla kemi me mija, shpesh kemi hasë edhe në kërcënime serioze me këtë dmth se identifikimi i personit pranues, leje që nuk ka qenë i mundshëm, po ka pas raste që jemi friguar që kemi ikur prej atij vendi pa ndodhë ndonjë tragjedi, kushtet e punës, transportit postar në Kosovë nuk janë të mundshëm, nëse nisemi në bazë individuale, nuk janë të mundshme as nëpërmjet sistemit të doganës, shembull: për transportin postar internacional kam pas marrëveshje me DPD ku transporti postar është ardhë përmes transportit ajror pra pranimin e dërgesave e kemi pas obligative me bo në aeroportin e Prishtinës, pranimi i dërgesave prej anës së doganës së Kosovës është kërkuar që përgjegjësin e brendësisë së pakos ta mbajë kompania e S.L, kjo gjë është e pa mundshëm. Tutje i njëjti ka theksuar se gjatë 25 viteve të përvojës se tij nuk ka pasur probleme ligjore, por vetë ai e cek se asnjëherë nuk ka pas asnjë dënim në drejtim të kësaj, por ka pas disa përvoja që sipas statistikave botërorë 85 % transportit ilegal në botë bahen me transportin postar, pra ka pa disa përvoja si punëtori i tij që ka punuar për dërgesat e DHL është ndalë nga patrulla policore së bashku me doganën dhe gjitha dërgesat që kanë qenë brenda transportit janë kontrolluar, njëra prej pakove ka qenë një sasi e konsiderueshme e drogës dhe pas asaj kontrole është marr hetuesi përgjegjëse për atë rast, pas një kohe prej një jave jam ftuar prej hetuesisë së A. në Gjermani, dhe kërkesa e hetuesisë së A.ka qenë që të bashkëpunojmë me hetuesinë dhe ne kemi vepruar në atë mënyrë se si ka kërkuar hetuesia, ka qenë diskutabile a ti tregojmë vozitësit apo mos ti tregojmë, vendimi ka qenë që të mos i tregojmë, dhe ka qenë kërkesa që asaj pako nuk guxon me i ndodhë asnjë sen, ky proces ka zgjatë 6 muaj, në përfundim të procesit është kap një grup prej 80 veta, e tregon se është qëllimi

se në këtë sistem duhet të zhvillohet prej lindjes e deri tek përfundimi i dërgesës që të dihet saktësisht se kush është kush, raste të tilla kemi pas disa. Mënyra e pagesës së klientit dhe pagesa e shërbimit janë dy lloje që nuk kanë të bëjnë njëra me tjetrën, pagesa e klientit dmth një individ, një kompani që dërgon një dërgesë dhe për atë dërgesë kërkon një vlerë të hollash prej pranuesit psh, I.M e dërgon një dërgesë te M. H., dhe për këtë kërkesë M. duhet ti paguaj 25 euro, posta është e obliguar që ti merr 25 euro për me dorëzua dërgesën nëse nuk i merr ato, duhet me u dorëzu dërgesa, kurse pagesa e shërbimeve bëhet pasi që dërgesat të dorëzohet, pagesa e shërbimeve vlera e së cilës nuk kalon më shumë se 1.20 cent bëhet pasi që të bëhet barazimi me dërguesin në fakt është që dërguesi ka dërguar 10 dërgesa dhe pret shumë prej 250 euro, për dërgesa llogariten nga 1.20, që dmth 12 euro, barazim me dërguesin hekin 12 euro, të shërbimit, paguhen 280 euro pare të dërguesit, pagesa është një problem i shoqërisë Kosovare ku në Kosovë pagesat bëhen 100 % me kesh, në Evropë 100% me bankë. Tutje shton se paratë nga ana e hetuesve policor si para të dyshimta këto para kanë qenë të pikës së Prizrenit, kompania S.L ka pas 7 pika në territorin e KS, ato të holla kanë qenë të grumbulluara të datës 03. 04. të muajit Shtator të vitit 2019, ato të holla kanë qenë të kompanive të ndryshme që kanë bashkëpunuar me S.L. Kompania S.L ka pas shërbimin e shpërndarjes së mallrave të kompanive dhe për ato mallra kanë qenë vlere të ndryshme që në atë listën që e posedoni janë veç e veç me emër dhe mbiemër të kompanisë dërguese dhe pranuese, vlere dhe koha e dorëzimit, pagesat që i kemi marr për këto shërbime kanë qenë në kesh, dhe i kemi nda në dy konto me urdhër të ATK-së, për çfarë arsye që të mos ngarkohemi si kompani me paratë e dërguesve tjera, të mos llogaritet si hyrje e kompanisë ton, konto tjetër ka qenë konto e shërbimeve, pagesat e shërbimeve të kompanive i kemi bërë një herë në muaj, dhe pagesat e shërbimeve, kompanitë i kanë pranuar përmes xhirollogarive, ato pare që janë sekuestruar, kanë qenë pare e klienturës të dërguesit. Pra shumë qe e kanë marrë në Prizren, dhe nëse bëhet fjalë prej 12 mijë e 300 euro, dhe atë e zbërthejmë në cilëndo kompani, dhe i bjen se secila kompani ka pas me i marr vlerën prej 600 euro, dhe ta keni parasysh se secila kompani e mesme dhe e vogël një vlerë prej 600 euro. Po ashtu i njëjti shton se sa i për këtë dërgesave të përmendura në bastisjen e policisë, në brendësi të pakove janë gjetur armë dhe barna, jam informuar edhe pse personalisht nuk kam qenë në të njëjtën kohë në kompani, por më ka informuar menagjeri se ka bastisje, sa i përket aspektit të barnave dhe dokumentoj se kompania S.L ka pas marrëveshje me disa depo farmaceutike për shpërndarjen e dërgesave, duke u bazuar në rregullatorin transportit postar nuk ka pas ndalesë për transportimin e barnave, ndërsa për pakot të përmendura procesi ka qenë kështu, procesin se si është zhvilluar, vetë ai ka qenë drejtor i kompanisë dhe nuk kam pas mundësi që ta di se sa pako, apo çfarë pako brenda ditës kanë qarkulluar nëpër të gjitha pikat e S.L, këto pako kanë qenë të V.I, të njëjtin e njeh personalisht, mirëpo dmth sa me kriju një besueshmëri mes tij dhe Vit. Pakot janë kontaktuar nga V.I i ka kriju këto pako me konota, identitetin e pakos dhe ka kërkuar nga ai që të shkon postieri i S.L dhe ti merr këto pako, sa që ka qenë normale mbledhje e pakos. Secili klient i kompanisë ka pasur name dhe passwordin personal, konotat janë krijuar në paketat e V.. V nuk ka qenë punëtor i kompanisë mirëpo ka qenë klient, punëtori i kompanisë se tij, nuk ka të drejtë të krijoj konot, krijimin e konotes e bënë vetëm dërguesi, ka qenë kërkesë krekës e V. me shkuar me marr pako për arsye që postieri apo korrieri nuk është shkuar dhe e ka neglizhuar punën disa herë në pika të ndryshme, bëhet fjalë për M.K. që ka dëshmuar, pasi që postieri, shoferi ka neglizhuar punë, mundësia e vetme e klienti ka qenë me kontakt me nivelin më të lartë të kompanisë, për me bërë zgjidhje me të shpejt. Vetë ai dëshmon se personalisht ka pas vozitës postier që ka kontaktuar nëpërmjet telefonit deri në 50 herë në ditë, por ka pas shofer që s'ka kontaktuar 2 muaj radhë, këtë rast për të, ka përfunduar procesi kur i kemi marr ato paketa, faktikisht thirrja e V., thirrja e tij menaxherin N për me urdhëru M. K. me shku me i marr ato pako, qysh ka qenë marrëveshje me shku me ja marr klineitt deri në vendimin e tij, deri këtu ka qenë çdo gjë në rregull. Pas kësaj ka qenë një fazë kur është ardhur V i shqetësuar duke u bazuar në njoftuesin dhe afërsinë mes vetë atij dhe V., e ka çajhtë një hallë në gjuhen popullore, dhe i ka tregu se ka qenë një marrëveshje me një person që ato pako të transportohen prej depos në pjesën veriore të Mitrovicës, emrin e tij nuk ia ka përmend, edhe halli i Vit ka qenë që marrëveshja mes Vit dhe atij personi që ai person kur të informon Vin mes tel, me ja bo dërgesën në adresën e konote. Vetë ai ka pas një servisë që në ndër kohë që donë klineti, si fix termin për me ja dorëzuar dërgesën. V. e ka prit personin për me lajmëruar kur me ja bo dorëzimin e dërgesës. Vi ka pritë një kohë prej marrjes së pakos deri te qajo kohë e qajtjes së hallit, ka qenë afër 10 ditë, i cili ka treguar që është marr vesh me atë personin për me ja transportuar barnat edhe alltiat me gas ose armë zhurmuese, dhe atë ditë kur i ka treguar ka pas kërkesën që ti hapim pakot se mos ka diçka më shumë se marrëveshjen që e ka bë, kur i ka treguar V. sa i për këtë barnave nuk ka pas asnjë mendim të keq në atë drejtim, sepse çdo herë ka transportuar barna, edhe me ligj të rregullatorit ka qenë

në rregull, ndërsa për armë të gazit unë në Gjermani transportoja me qindra pistoleta me gaz, në ditë i sjellim nëpër lokale ku shiten, ligjërisht nuk kemi kurrfarë ndalese, prej atij parimi që edhe në Kosovë pistoleta me gaz nuk është e ndaluar. Kjo ka qenë shkak që vetë këtë punë nuk e ka bërë të madhe ka provuar me i hap pakot, kur i ka hap pakot është shumë i sigurt, se ato armë nuk janë paketuar në depo të S.L, ato pako janë hap me kërkesën e V.I për shqetësimin e tij pse nuk është lajmëruar dërguesi në afatin kohor, dhe Vi ka pas dyshim mos ka diçka tjetër. Pas hapjes së pakove kanë parë se ka barna edhe armë. Armët nuk është ekspert i kësaj lëmie që ti njeh, e kanë pa dhe kanë thënë se pamja e asaj arme ka qenë lodër, në realitet me armën reale, ka qenë në gjuajtje në poligon edhe aty peshja e armës, shkrimi i armës kanë qenë në rregull, ndryshe prej atyre që kanë qenë në pako, dhe për vetë atë ka qenë e vërtetuar se është armë gazi dhe ka qenë plastik. Tutje ka theksuar se formën e konotës faktikisht është një lloj shablloni që është i instaluar në softwerin e S.L, kurse të dhënat kush e dërgon e pranon, peshën, etj... dhe nëse donë edhe brendinë e pakos e bënë dërguesi. Ndërsa shqetësimi V. ka qenë aktori kryesor që e ka bërë dhe vetë atë për me u shqetsu duke pas bazë rregullatorin që obligimi në kërkesë të institucioneve shtetërorë të dëshmoj pikën A dërguesin, dhe pikën B pranuesin. Pakot ku kanë qenë te vendosura qe i kanë hapur ka qenë një shok i Vit vetë ai personalisht nuk e njeh mirë, e njeh vetëm se emrin e ka pas N. edhe në këtë drejtim me N. as nuk ka diskutuar për paketat, mendimi i tij është se N. ka qenë vetëm shoqëruar i V. Pra tek objekti vetëm një herë kur ka ardhë me V., ka qenë brenda objektit në depo, N.edhe në hyrje të depos ka qenë i distancuar, ka qenë si musafir, e jo si i lirë aty, nuk ka qenë iniciator me hy brenda, por pasi që e këna thirr na, kurr s'kom pas asnjë lloj veprimtarie me N.G, as raport as afërsie. Në ndërtesë ka pasur të instaluar kamera e të cilat kamera ka mundësi që ti shkyqi, nuk i ka shkyq me arsyen se duke u bazuar prej ligjit evropian ku lejohet arma e gazit nuk i kam shkyq kamerat dhe nuk e ka ni të nevojshme me shkyq ato kamera deri në këtë proces, sepse me plotë bindje ka qenë se arma me gaz nuk hynë në kategorinë e armëve të ndaluar. Po ashtu ka pasur mundësi qe ti fshin incizimet por nuk e kam bërë me arsyet si më lart, e të cilat pako kanë pasur mundësi dhe kohë të mjaftueshme me i hup, asgjësuar por e ka pas bindjen se ato armë kanë qenë të lejuara në Kosovë. Po ashtu edhe pas ndërhyrjes të policisë e deri me pesë shtatorë 2019 ka qenë vazhdimisht prezent për arsye që vetë shkak i bastisjes së policisë e ka ndi të nevojshme pas asaj ndodhie me qenë prezentë çdo herë kur ka nevojë hetuesi për ndonjë informatë, dhe ka qenë i bindur që nuk ka punuar asgjë të paligjshme, dhe ka shkuar me parimin si në Gjermani me bashkëpunuar me hetuesin e policisë, vetë ai në ndërkohe ka udhëtuar jashtë shtetit vazhdimisht në këtë fazë e ka ndalu udhëtimin jashtë shteti, dhe e kam ni një përgjegjësi të është prezent se mund të ndodh që hetuesia të tenton të ketë kontakt personal me vetë atë, për arsye të hetimeve, sepse i kemi pas në kompani 60 punëtor. Ndërsa video-incizimet i kujtohet shumë mirë qe në momentin e bastisjes së policisë është kontaktuar prej menaxherit kryesor G. K., dhe e ka informuar për bastisjen, dhe e ka pyetur se çka duhet të veprojnë, vetë ai i ka sugjeruara që të ma jep personin përgjegjës të bastisjes, atëherë e ka urdhëruar Gëzimin që hetuesisë ti ndihmojë në çdo aspekte që t'ia jep video-incizimet, DVR, faktikisht policia ka mujt me pas një DVR i cili i ka pas vetëm 3 kamera ai ka qenë brenda objektit, DVR tjetër për shkaqe të internetit e kemi pas DVR në objekt të kojshisë, vetë i ka thanë G. që edhe DVR në objekt të kojshis jepja hetuesve, pika tjetër që ka qenë se hetuesi nuk e kanë njohur programin sotverik të S.L nuk e kanë njohur fare e ka urdhëruar G. që t'ia shpjegoj hetuesve dhe t'ia qel user dhe passwordat që kanë qasje 7/24. I njëjti shton se secili punëtorë apo postier ka pas një kontratë me shkrim me kompanin S.L, në brendësi të kontratës është e cekur që çdo dërgesë apo e ashtuquajtur pako dua të ketë identitetin e vetë për arsye të sigurisë, dhe një dërgese pa identitet nuk ka as dërgues as pranues, për me kuptuar këtë proces se identiteti i pakos e tregon kujna ke me ja dërgua, dhe ku i ke marr, secili i punësuar e ka pas nenin e rregullatorit që çdo dërgesë apo çdo pako që gjendet në veturën e postierit, shoferit, pa konot përgjegjës in e çasaj pakos e trashëgon e mbanë, postieri apo shoferi, tash po nisemi prej logjiikes se asnjë shofer, postier nuk pranon me marr një pako pa konotë në përgjegjësi të vetën ai konsiderohet si pako e tina. Kjo parashihet me ligjin e ARKEP-it, statutin e kompanisë dhe kontratën e punës. Tutje i njëjti shton se ka pasur takime pasi që ka dal prej paraburgimit, ka qenë në zyre kur ka shkuar M.K dhe ka kërkuar takim me të, ka qenë kërkesa e tij që pagesa e trusit pensional, edhe kontributet tjera, vetë ai i ka thënë se prokuroria ia ka blloku të gjitha llogarit bankare nuk ka mundësi me bo asnjë pagesë, e ka lutë që të ketë mirëkuptim përderisa të përfundon procesi gjyqësor të lirohen gjiro llogaritet dhe të behën pagesat e kontributeve, M. ka qenë kategorik që jo, dhe më ka thanë se mi jep paret ja ki me ma pa sherrin, paret nuk ka mundësi me ti dha e ti e din çka banë, edhe beson që është hakmarrë në këtë seancë gjyqësore. Po ashtu qe pakot te cilat janë gjetur në depo secila prej tyre ka pas te vendosura konotat duke u nisur prej faktit se depoisti nëse postieri e anashkalon dhe i merr pakot pa konot, depoisti nuk ka mundësi me

i pranuar ato pako, për arsye se duhet të regjistrohen në sistem softëwrik, nëse postierit i ka ikur, depoisti e ka parë. Ndërsa sa i përket B. S.S. dhe A.I, nuk i njeh deri në këtë seancë. Tutje i njëjti shton se N.A punon në S.L prej dt.01.11.2016, fillimisht është pranuar si vozitës-postier, në kohën e ngjarjes i njëjti e ka pas pozitën mëngjieri i pikës së Prishtinës, kompetencat e tij kanë qenë barazimi financiar me shofera, organizimi për secilin shofer veç e veç, dhe e ka bërë ndarjen pakove për secilin shofer, ka kontrolluar automjetet nëse janë të dëmtuar, naftën e ka kontrolluar. N i ka nda pakot pasi që i kanë prurë vozitësat tjerë në depo, ai i ka nda secilën pako nga dërguesi tek pranuesi, ai nuk ka mundur me ditë çka ka pas në pako, po ashtu nuk ka qenë prezentë kur janë hapur pakot as nuk ka qenë në dijeni. Me tej i njëjti shton se nuk ka qenë si i dyshimit, se ka pas plotë besimi te V.se kur të më thotë diçka është ashtu, dyshim nuk ka ngjall tek vetë ai, por ngjalli një kureshtje me këqyr çka është, dhe është i sigurt se ajo armë nuk ka mundur të jetë origjinale, se arma origjinale është e rëndë, ndërsa këto arma kanë qenë si lodra, armë me gaz të cilat kanë qenë të mbështjellura me folje të aluminit, kur i kanë hap ato folje kanë qenë të ndryshkëta, kanë qenë plastika të shkrime, ajo ka qenë e përznie metal me plastik, 80 % ka qenë plastik, e tjetra hekur, e për të cilat e ka kuptuar se edhe armët me gas janë të ndalur në në seancë gjyqësore, është i interesuar edhe me shumë, se Maqedoni, Shqipëria, dhe vendet përreth Kosovës, janë të lejuara, me shton vetë ai po ta dinte se është jashtëligjshme e kisha lajmëruar, por është i bindur se ato nuk hynë kategorinë e dënimit, për me qel një kompani prej 600 mijë euro, edhe vetë ai e ka ditë edhe ka pas fat dhe e ka qelë një kompani, e kam ditë që për një vlerë prej 5.000 euro, nuk e hupi shumë prej 600 mijë euro, hetuesit e ktuhit i kanë lajmëruar ata të Gjermanisë, dhe ata të Gjermanisë më kanë pyete për çka bëhet fjalë, i kam tregu për barna edhe armë, ata e kanë mbyllë lëndën brenda dy jave dite dhe për ata nuk është shkeleje e ligjit. Ndërsa para se me ardhë V, çdo sen që është në kundërshtim me ligjin, jo V. por edhe djalin tim e kisha lajmëruar, por nuk mu ka doke asgjë e jashtëligjshëm, V më tha se janë revole të gazit, mirëpo mu ka zgju një kureshtje me marr në dorë dhe me këqyr çka është, dhe ajo ma ka përforcu bindjen se nuk është e jashtëligjshëm. Kurse vetë si drejtor ka punuar me shumë se çdo punëtor, vozitës, rojtar etj. Është thënë se M.K i ka prurë ato pako, policia ka marr informatë prej kompanisë se kush e ka territorin e F. K., ne i kemi dhënë informata se M. e ka territorin e F. K., policia e ka takuar M. në rrugë të F. K.e ka pyetur se ku i ke marr, do paketa, M.K ditë për ditë në F.Ki ka shpërnda 300 pako dhe i ka mbledhë 300 pako, vetë ai nuk e di sigurt kush i ka sjell ato pako, sepse nuk kam qenë në atë kohë, është shumë logjike që postieri i mbledh pakot. M. e ka urdhëruar 15-20 herë me shku me marr pako, por për këtë rast nuk i kujtohet që e ka thirrë, M.ka qenë neglizhent për me shku me i marr pakot për këta është dashur me thirr çdo herë. Me tej i njëjti shton se mundësin e refuzimit nuk e kanë pasur, kompania e tyre i ka pas do kosto afër 70 mijë, euro i kanë pas 50 punëtor, vetura, kamioni, dhe qëllimi i tyre ka qenë me arrite tregun e Kosovës, për qatë arsye e kanë pas strategji me i ofru secilit person edhe secilës kompani, i kanë ofruar oferta shumë më të volitshme se me kry ato atë punë. E si përfundim thekson se ishte hera e parë që kanë kësaj pako, dërguesi ka qenë i kompanisë se Vit, pranuesi ka qenë emër serb, i pjesës veriore.

**I akuzuari V.I në mbrojtjen e tij** të dhënë në shqyrtim gjyqësor të dt.17.05.2022 ka deklaruar se, i ka kuptuar te drejtat dhe detyrimet që ia ka lexuar gjykata, po ashtu i ka mbështet deklaratimet në procedura të mëhershme dhe ka theksuar se dëshiron të shfrytëzohet të drejtën e tij të mbrohet në heshtje.

**I akuzuari N.G në mbrojtjen e tij** të dhënë në shqyrtim gjyqësor të dt.17.05.2022 ka deklaruar se, i ka kuptuar te drejtat dhe detyrimet që ia ka lexuar gjykata, po ashtu i ka mbështet deklaratimet në procedura të mëhershme dhe ka theksuar se dëshiron të shfrytëzohet të drejtën e tij të mbrohet në heshtje.

**I akuzuari B.S në mbrojtjen e tij** të dhënë në shqyrtim gjyqësor të dt.17.05.2022 ka deklaruar se, nuk e njeh I.M dhe nuk ka njohuri se ku punon. Po ashtu në kohën kur e kanë ndaluar policia ka punuar me shampona Camagra edhe disa vitamina, gjatë punës se tij me shampona asnjëherë nuk ka punuar me barin tamoil 200 mg. Ndërsa asnjëherë nuk është marrë me armë. Tutje i njëjti thekson se këto shampona i ka sjellë përmes S.L nga V.i M., është hera e parë që ia kanë sjellë, dhe është hera e parë që ka punuar me S.L, ndërsa nuk e ka pyetur askush sepse vetë ai s'ka qenë dërgues i mallit, ka qenë pranues i mallit, dhe mallin e ka pranuar sipas porosisë. Tutje shton se nuk se nuk e njeh dhe s'ka dëgjuar emrin e N.G. Po ashtu shamponat janë stimulues seksual për meshkuj dhe është hera e parë që i ka marr, ndërsa nuk i është dhënë mundësia me i shit se e kanë zanë shpejtë, kurse planin me i shitë e ka pas me i vetë barnatoret nëse dojnë me i ble, nuk i ka ndodhur që përveç këtij rasti për të blerë barna në ndonjë vend tjetër, vetëm

ndonjë sasi të vogël në vlerë prej 20-30 euro, këto i ka blerë nga tregtaret ambulant që është taku në barnatore. Me tej thekson se nuk e njeh A. I., vetëm para 6 vjetëve ia ka shitë një veturë, përveç në barnatore, në Prishtinë nuk ka shitur në ndonjë destinacion tjetër, ndërsa asnjëherë nuk ka shkuar në Ferizaj. Me barna me të cilat është marrë janë Camagra gell prej kësaj porosie është marrë vetëm një herë, një sasisë që ka porositë ka qenë 3 mijë e diçka euro, këtë e kam pas për qëllim të tregtisë, vetë ai më sasi të vogla ka punu më herët, dhe hera e fundit që kam porosit ka qenë kjo, tregu për këtë produkt ka qenë në barnatore në Prishtinë, nuk ka blerë kerkush në sasi të madhe, në lidhje me produktin skam pas vërejte nga farmacitë, sepse ka qenë legal dhe është edhe sot në treg, i cili është në treg, dhe është në barnatore, nuk ka qenë ilegal, vetë ai ka pas firmë dhe i kam blerë në sasi të vogël.

**I akuzuari S.S në mbrojtjen e tij** të dhënë në shqyrtim gjyqësor të dt.17.05.2022 ka deklaruar se, i ka kuptuar te drejtat dhe detyrimet që ia ka lexuar gjykata, po ashtu i ka mbështet deklarimet në procedura të mëhershme dhe ka theksuar se dëshiron të shfrytëzoj të drejtën e tij të mbrohet në heshtje.

**I akuzuari N.A në mbrojtjen e tij** të dhënë në shqyrtim gjyqësor të dt.17.05.2022 ka deklaruar se, S.L ka filluar të punoj nga vitit 2017 në fillim kur është hap firma, ka punuar deri në fund kur është mbyllë firma në vitin 2019, puna e tij ka qenë në fillim menagjer organizativ në piken në M., pasi që e njëjta i ka pas zyrën në Mitrovicë, kryesisht vitin e parë ka punuar në Mitrovicë, e pastaj jam dalë në piken e P.që ka qenë menaxher-udhëheqës i shoferëve. S.L ka qenë post private është marr me dërgesa të klientëve të ndryshëm, kanë pas klient në krejt Kosovën, kjo post ka funksionuar kanë pas një sistem në sowlter ku kanë bërë kontrata me firma apo me qytetaret që kanë pas me dërguar mallra në firmën e tyre edhe klienti është futë në sistemin tonë, e ka bërë kërkesën, i ka futë të dhënat e pranuesit të pakos dhe dërguesit dhe sistemi ja ka gjëndëruar një barcod që quhet Konot që e përmban letra me bar kode neve na ka ardhë njoftimi në sistem online, dhe kanë caktuar shoferin me shkuar me marr atë pako të klienti, shoferi e ka sjell në depot e tyre kanë bërë seleksionimin e tyre dhe të nesërmit e kanë dorëzuar te pronari. Konota e ka pas emrin e pranuesi dhe derguesit, për emër aplikacionit që e kanë skanuar barcodin i kanë pas të dhënat e dërguesit dhe pranuesi, ndërsa në përmbajtje ashtu siç e ka shkruar pranuesi, p.sh ka pas sene të ndisheme dhe e ka shkruar që mund të thehët, pra përmbajtjen ka zgjedh vetë dërguesi, ne nuk kemi pas të drejtë me qelë pakon, por çoftë ka pas ndonjë send të dyshimit e kanë lajmëruar menaxherin por kjo nuk ka ndodhë ndonjëherë, s'kanë pas kesi probleme. Menaxher gjeneral ka qenë, G.K. ndërsa, I.M ku menaxhera tjerë të vozitësve i kanë pasur edhe dy koleg tjerë që kanë kryer punë të njëjta M.S. dhe Xh.F., këta kanë qenë koleg të tij, që janë marr me çështjen organizative, përveç tyre që janë marr me pranimin e mallit, kanë qenë edhe depoistet, selektimi i mallit është bërë në Prishtinë ka qenë pika më e madhe edhe aty janë takuar shoferet e krejt qyteteve, dhe seleksionimi është bërë në bazë të qyteteve ka qenë edhe depoisti i ndërrimit të natës. Me tej i njëjti shton se koha me e shpejtë e dërgimit të një dërgese ka qenë, 24 h, ndërsa koha e më gjatë ka qenë sipas kërkesës së klientit ka ndodhë që i kanë dërguar edhe pas disa ditëve, se kanë kërkuar me datë të caktuar me ju dërgu, ku çdo herë kanë pas problem me adresa sepse ka pas raste që e kanë shkruar vetëm numrin e telefonit, e nëse nuk kanë mundur me gjete edhe përmes telefonit e kanë quajt pako e refuzuar sepse nuk kanë mujt me u dorëzu. Po ashtu ka ndodhur që ndonjë pako mos me u dorëzu për shkaqe teknike, për të cilat pako pagesa nga disa klient me fatura mujore përmes bankës se që kanë qenë firma të mëdhaja, kurse qytetaret e kanë bërë pagesën kesh tek shoferi që ka dorëzuar dërgesën, ka pas raste kanë ardhë edhe tek posta e kanë bërë. Tutje i njëjti thekson se në kompaninë S.L ka qenë një rregullore që mallrat që nuk mund të barten me post, dhe ajo i prezantohet klientëve, produktet që janë të ndaluar me ligj. Vlerësimin për pagesë e kanë pasur në 4 kategori të pakove në madhësi të ndryshme dhe aty është bërë kategorizimi i pakove. I njëjtit shton se e njeh Milot Kuaj e kanë pasur shofer, koleg i cili ka punuar regjionin e D., K., një pjesë të F.K., ndonjëherë edhe në Prishtinë, urdhëratë për marrjen e pakove të shoferëve e kanë organizuar mbledhjen në mbrëmje ku në sistemin tyre janë shkuar kërkesë ku kanë mbledh pako, dhe i kanë nda shoferet përmes sistemit i kanë thirrë në telefon dhe janë koordinuar, ku vetë atij i ka ndodhur me thirr shpesh M. K. sepse për organizimin e dërgesave ka pas nevojë me thirrë me ja rikujtu me kry një punë, për shkak se ka ndodhë që ka qenë neglizhent dhe duhet me ja rikujtu më shpesh, për pakot që nuk ka pas konotë vozitësit nuk kanë guxuar me i marr, sepse ato pako pa konotë nuk kanë pas autorizim prej tyre dhe nuk kanë pas njoftim që duhet të merren ato pako. Po ashtu nuk ka ndodhur me hap pako, por nëse një pako nuk ka qenë e mbyllur mirë, e kanë thirrë klientin dhe i ka autorizuar me u rregullu ku natyra e punës se tij ka qenë e tillë që i ka ndihmuar shoferet me i ngarku pakot. Me tej shton se i njeh personat V.I, N.G, B dhe

S. S., përveç gjatë këtij procesi gjyqësor më herët asnjëherë nuk i ka njohur dhe nuk e mban mend që i ka pa në zyrat e S.L. I njëjti shton se nuk ka pasur njohuri për 99 armë vetë ai s'ka qenë ne dijeni derisa ka shkuar policia. Ndërsa nuk ka paketuar armë dhe barna se bashku me I, V.dhe N. nuk i ka ndodhur kurrë, dhe ajo çfarë është me rendësi data, ka hi me verifikuar atë datë dhe ajo ka qenë e Diele dhe vetë ai nuk ka qenë në punë, nuk ka parë armë asnjëherë deri në momentin kur kanë shkuar policia në kontroll ndërsa S. S. kur në jetë se ka takuar, kurse B.S nuk din se a ka mar pako apo jo. Llogari për punën te cilën e ka bërë, kanë pasur hirearki, vetë ai e ka pas menaxherin kryesor, kontratën në fillim e ka nënshkruar me drejtorinë e kompanisë I M.

**I akuzuari A.I në mbrojtjen e tij** të dhënë në shqyrtim gjyqësor të dt.17.05.2022 ka deklaruar se, me profesion është farmacist, ndërsa me I.M. fillimisht ka pasur raporte shoqërore kurse tani ka kohe qe janë prishur e cila ka barnatore private po me profesion është ekonomiste, me të cilën nuk ka punuar asnjëherë bashkë e kanë hapur një firmë por s'kanë punuar bashkë, ndërsa vetë ai shumë me herët ka pas barnatore në Kosovë në vitin 2007, për periudhën qe bëhet fjalë tani ka barnatore vetëm në Maqedoni. Me tej shton se nuk e ka blerë apo shitë bari tamoil. Pësonin B.S e njuh pasi ka ble një në vitin 2012-13 dhe nga ajo kohë kurrë s'ka pas kontakt, e as njërin nga e akuzuarit tjerë nuk i njuh dhe nuk i ka pa me përpara.

Në shqyrtimin gjyqësor publik gjykata konform nenit 7 të KPPK-së, saktësisht dhe në mënyrë të plot vërtetoi faktet që janë të rëndësishme për marrje të vendimit të ligjshëm, me vëmendje dhe përkushtim maksimale profesional dhe përkujdesje të njëjtë vërtetoi faktet kundër të akuzuarve, si dhe ato në favor të tyre, duke i mundësuar të akuzuarve shfrytëzimin e të gjitha fakteve dhe provave që janë në favor të mbrojtjes dhe me ndërgjegje vlerësoi çdo provë një nga një dhe në lidhje me provat tjera dhe në bazë të vlerësimit të tillë, ka nxjerrë përfundimin lidhur me faktet konkrete të vërtetuara.

Pas procedimit të provave personale dhe materiale në shqyrtimin gjyqësor dhe vlerësimit të tyre një nga një dhe duke i ndërlidhur reciprokisht me njëra-tjetrën, në kuptim të nenit 361 par.1 dhe 2 të KPPK-së, kjo gjykatë ka vërtetuar se ka prova se të akuzuarit *V.I, N.G, I.M dhe N.A* në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e pa autorizuar e armeve apo materieve plasëse nga neni 372 par.2 lidhur me par.1 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së, ndërsa të akuzuarit *B.S.i, S.S dhe A.I* në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale Tregti e ndaluar nga neni 305 par.2 të KPRK e lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Të akuzuarit *I.M, V.I, N.G, N.A,S.S ,B.S dhe A.I*, janë të akuzuar për kryerjen e veprës penale Importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve nga neni 372 par.2 lidhur me par.1 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së, dhe Tregti e ndaluar e ndaluar nga neni 305 par.2 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Prokurori pohon se nga periudha e panjohur kohore e në vazhdimësi e deri me datë 21.03.2019, në bashkëkryerje, më qëllim të përfitimit të dobisë pasurore në mënyrë të kundërligjshme, ku i pandehuri *V.I* i ka siguruar 25 pako me armë të tipit Glock Austria dhe Sig Suer, nga një person i panjohur me nofkën Doni, të cilat i ka vendosur në një zyrë të lokalit të tij në F.K dhe disa pako me medikamente të llojeve të ndryshme me përmbajtje te substancave narkotike, si tamoil, të cilat sipas marrëveshjes i kanë siguruar të pandehurit *N.G, B.S dhe A.I*, ndërkaq i pandehuri *I.M* pas marrëveshjes me te pandehurin *V.I* e dërgon postierin e postës *S.L, M.K*, në zyrën e të pandehurit *V* në Fushë Kosovë, ku 25 pakot i vendos në objektin e *S.L* në fshatin *M.*, e pastaj të pandehurit *I. M., V.I dhe N.G* i ndajnë armët dhe medikamentet në pako me qëllim të dërgimit në vendet të ndryshme, ndërkaq i pandehuri *B.S* shkon në depon e postës *S.L* me veturën e tije dhe nga i pandehuri *N.A* menaxher i kompanis i merr disa pako ku më pastaj takohet me vëllain e tije *S. S* në lagjen *Ulpiana* dhe i ndajnë pakot me medikamente, dhe ky pohim i prokurorisë mbështetet në provat e propozuara në aktakuzë dhe të administruara në shqyrtimin gjyqësor e që sipas gjykatës të gjitha këto prova nuk kanë fuqi provuese për vërtetimin e pretendimeve të aktakuzës. Prokuroria nga të gjitha provat e propozuara në aktakuzë dhe të administruara në shqyrtimin gjyqësor në asnjë provë qoftë personale apo materiale nuk ka mundur ta vërtetoi faktin se të akuzuarit ti kenë kryer veprat penale në bashkëkryerje.

Pohimi i Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës se të akuzuarit në bashkëkryerje kanë kryer veprat penale si në aktakuzë ishte vetëm një dyshim i cili nuk ka mbështetje në asnjë provë të besueshme –relevante, pasi që bashkëkryerja ekziston **“kur dy apo më shumë persona duke marr pjesë në veprimin e kryerjes apo në ndonjë mënyrë tjetër së bashku kryejnë veprën penale,”**. Për të ekzistuar kjo formë e bashkëpunimit duhet të plotësohen elementi objektiv, **pra si bashkëkryerës është personi I cili së bashku me të tjerët ndërmerr veprimin e kryerjes së veprës penale të caktuar** si dhe elementi subjektiv **pra si bashkëkryerës është personi I cili së bashku me tjetrin në bazë të marrëveshjes mbi ndarjen e punës realizon pjesën e vet në procesin e kryerjes së veprës penale e ka dëshiruar pasojën dhe veprën penale e konsideron sit ë veten.**

I.Në rastin konkret trupi Gjykues duke e analizuar dispozitivin e aktakuzës dhe arsyetimin e saj dhe duke i ndërlidhur me provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor gjen se nuk ekziston bashkëkryerja në veprimet e të akuzuarve për ti kryer veprat penale si në aktakuzë, pasi që nuk është vërtetuar me asnjë provë lidhje e caktuar objektive dhe subjektive, këtë fakt gjykata e vërtetoi me provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor, dhe atë me dëgjimi i dëshmitarit **M.P** të dhënë në shqyrtimin gjyqësor të dt. 21.10.2021, i cili ka deklaruar, se **“i njëjti ka punuar në S. L si kontabilist, i nje personat I.M, dhe N Abrashin pasi që të parin e ka pas shef ndërsa të dytin e nje se ka qen menagjer i kompanis me seli në Prishtinë, po ashtu në zyrat e S.L ka takuar edhe V.I dhe M. G. ndërsa të akuzuarit të djerë deklararon se nuk i nje dhe nuk i ka takuar ose parë në kompanin S.L. Dëshmitari A.Anë seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 21.10.2021 ka deklaruar se ‘ po i njoh dy personat B.S dhe S.S e di që janë vëllezër”** Dëshmitari **M.K** në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 01.11.2021 ka deklaruar, se **“ka punuar në pozitën vozitës në S.L nga viti 2017/2018 ose 2019, kontratën për marrëdhënie pune e ka lidhur me pronarin e postës I.M, ndërsa përveq N.A. personat të tjerë nuk i nje”** Dëshmitari **B. M.** në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 01.11.2021 ka deklaruar, se **“e nje V.In e ka edhe shok, ndërsa N.G e ka njohur përmes V”** Dëshmitarja **I.M** në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 17.01.2022 ka deklaruar, se **“e nje A.I pasi që e ka pasur shok po ashtu personi i cili e ka shoqëruar A.I është B.S”**, të gjithë këto dëshmi të këtyre dëshmitarëve vërteton faktin se nuk ekziston lidhja objektive në mes të pandehurve, për të ndërmarrur ndonjë veprim i cili kishte për ti kontribuar kryerjes së veprës penale, ashtu siq pretendon prokurori në aktakuzë, pasi që siç vërtetohet nga këta dëshmitar pasojat e veprave penale të cekura në aktakuzë nuk janë rezultat i përbashkët i veprimeve të të gjithë të akuzuarve, ashtu siç deklarorin edhe dëshmitarët vërtetohet fakti se të akuzuarit I. M., V.I, N.G dhe N.A nuk kanë ndërmarr asnjë veprim me të cilin do ti kontribuonte kryerjes së veprës penale tregti e ndaluar nga neni 305 i KPRK-së, dhe gjithashtu vërtetonin faktin se të akuzuarit B.S,S.S dhe A.I nuk kanë ndërmarr asnjë veprim me të cilin do ti kontribuonte kryerjes së veprës penale importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e pa autorizuar e armeve apo materieve plasëse nga neni 372. Po ashtu të gjithë këto dëshmi të këtyre dëshmitarëve vërtetonin faktin se nuk ekziston lidhja subjektive në mes të pandehurve, për faktin se të njëjtit nuk kan pasur dijeni për njeri tjetrin, as që janë njohur personalisht me njeri tjetrin, **dhe po ashtu nuk vërtetohet fakti se të njëjtit janë marr vesh mbi ndarjen e punës për realizimin e pjesës së vet në procesin e kryerjes së veprës penale dhe se veprën penale nuk e kanë konsideruar si të vete** ashtu siq pretendon prokurori në aktakuzë.

Faktin se të akuzuarit në bashkëkryerje nuk kanë kryer veprat penale ashtu siq pretendon prokurori në aktakuzë vërtetohet edhe nga provat materiale të cilat janë administruar në shqyrtimin gjyqësor e të cilat janë pjesë e lëndës. siç janë **Vërtetimi mbi marrjen e sendeve, nga kjo provë vërtetohet fakti se në depon e S.L, janë konfiskuar sasia e barnave dhe e armëve e cekur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, në banesën e B.S janë gjetur një sasi tjetër e barnave të ndryshme ilegale, ndërsa në lokacionet e tjera nuk është gjetur asgjë e dyshimtë.** Faktin se në depon e S.L janë gjetur barna të ndryshëm nuk e vërteton veprimin e pronarit të depon I. M., se i njëjti ta ketë kryer veprën penale tregti e ndaluar pasi që me asnjë provë nuk lidhet me veprimin e tij, i njëjti ka ushtruar veprimtari të postës, vetëm ka bërë transportin e barnave, me porosinë e B.S dhe nuk vërtetohet se ka qen në dijeni se po kryhet vepra penale tregti e ndaluar, kjo për faktin se edhe nëse ka qen në dijeni se po transporton barna nuk ka mundur ta dijë se B.S personi i cili i ka kërkuar këtë shërbim është duke bërë tregti të ndaluar, pasi që nuk ka qen as detyrë as nuk ka qen kompetent të kërkoj informacion se a ka autorizim për shtijën e barnave, nga **video incizimet e nxjerra nga pajisjet e marra në firmën “S.L”**, shihet se kontakti i vetëm ka qen në mes të I.M, V.It N.Gt dhe N A., ndërsa nga këto video incizime në asnjë rast nuk shihet të jenë takuar të gjithë të akuzuarit ashtu siq

pretendon prokuroria në aktakuzë. **nga raportet policore mbi zbatimin e masave të fshahta të përgjimit**, vërtetohet fakti se të akuzuarit I.M, V.I, N.G dhe N.A., kanë komunikuar vazhdimisht në mes vete lidhur me dërgesën e cila ka rezultuar dhe provuar se bëhet fjalë për armët, **nga raportet mbi masat e fshehta të vëzhgimit dhe hetimit**, vërtetohet se kontaktet fizike kanë qenë në mes të I.M, V.I. N.Gt dhe N.A dhe disa personave të tjerë, ndërsa nga të gjitha këto raporte nuk vërtetonin se B.S., S.S dhe A.I të kenë kontaktuar qoftë nëpërmjet komunikimeve elektronike qoftë asaj fizike, me të akuzuarit V.It. N.Gt dhe N.A nga këto prova vërtetohet fakti se nuk ekziston lidhja objektive në mes të pandehurve, për të ndërmarrur ndonjë veprim i cili kishte për të kontribuar kryerjes së veprës penale, ashtu siç pretendon prokurori në aktakuzë, pasi që siç vërtetohet nga këto prova pasojat e veprave penale të cekura në aktakuzë nuk janë rezultat i përbashkët i veprimeve të të gjithë të akuzuarve, dhe se nuk ekziston as lidhja subjektive në mes të pandehurve, për faktin se të njëjtit nuk kanë pasur dijeni për njeri tjetrin, as që janë njohur personalisht me njeri tjetrin, **dhe po ashtu nuk vërtetohet fakti se të njëjtit janë marr vesh mbi ndarjen e punës për realizimin e pjesës së vet në procesin e kryerjes së veprës penale dhe se veprën penale nuk e kanë konsideruar si të vete** ashtu siç pretendon prokurori në aktakuzë,

Gjykata ka vlerësuar pretendimet e prokurorisë në raport me përshkrimin faktik të ngjarjes, provave që janë administruar në shqyrtimin gjyqësor të gjitha këto nga gjykata janë vlerësuar në raport me nenin 360 të KPPK-ës. Gjykata nuk detyrohet me propozimet e prokurorit të shtetit lidhur me kualifikimin ligjor të veprës penale, kjo sipas nenit 360 par.2 të KPPK-së. Gjykata në këtë rast ka ndryshuar përshkrimin e gjendjes faktike për të pandehurit në raport me veprën penale sipas aktakuzës. Gjendja faktike është ndryshuar pas administrimit të të gjitha provave në këtë çështje penale dhe për arsye se nuk është provuar se ekziston ai përshkrimi në aktakuzë që prokuroria e ka bërë dhe me kualifikim juridike të veprës penale në aktakuzë. Gjykata në përshkrimin faktik të aktgjykimit nuk ka ndryshuar përmbajtjen esenciale të akuzës në raport me kohën, vendin, përveç se ka ndryshuar gjendjen faktike në aspektin faktik *ka ndryshuar veprimet e të akuzuarve në raport me veprën penale konkrete*, gjendjen faktike është ndryshuar ashtu siç është vërtetuar me provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor, dhe se kjo gjendje faktike e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në mënyrë të plotë përputhet me provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe mbi bazën e provave trupi gjykues në këtë aktgjykim ka dhënë arsye të mjaftueshme për secilin fakt të vërtetuar. Sipas vlerësimit të gjykatës kjo situatë është e rregulluar me nenin 360 par.2 dhe 361 të KPPK-së gjykata duke u mbështetur në faktet dhe provat e proceduara në shqyrtimin gjyqësor të cilat i ka vlerësuar me ndërjegje një nga një dhe në lidhshmëri të të gjitha provave ka vlerësuar veprimet e të akuzuarve dhe mbi bazën e këtyre provave gjykata nuk ka mundur të vërtetoj faktin se të njëjtit ta kanë kryer veprat penale ashtu siç pretendon prokurori në aktakuzë, pasi që nuk është vërtetuar se ka ekzistuar lidhja objektive në mes të pandehurve, për të ndërmarrur ndonjë veprim i cili kishte për të kontribuar kryerjes së veprës penale, ashtu siç pretendon prokurori në aktakuzë, pasi që siç vërtetohet nga provat personale dhe materiale të administruara në shqyrtimin gjyqësor pasojat e veprave penale të cekura në aktakuzë nuk janë rezultat i përbashkët i veprimeve të të gjithë të akuzuarve, të akuzuarit I. M., V.I, N.G dhe N.A nuk kanë ndërmarr asnjë veprim me të cilin do të kontribonte kryerjes së veprës penale Tregëti e Ndaluar nga neni 305 i KPRK-së, dhe gjithashtu vërtetonin faktin se të akuzuarit B.S,S.S dhe A.I nuk kanë ndërmarr asnjë veprim me të cilin do të kontribuonte kryerjes së veprës penale importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e pa autorizuar e armeve apo materieve plasëse nga neni 372 i KPRK-së. Po ashtu të gjitha provat personale dhe materiale vërtetonin faktin se nuk ekziston lidhja subjektive në mes të pandehurve, për faktin se të njëjtit nuk kanë pasur dijeni për njeri tjetrin, as që janë njohur personalisht me njeri tjetrin, **dhe po ashtu nuk vërtetohet fakti se të njëjtit janë marr vesh mbi ndarjen e punës për realizimin e pjesës së vet në procesin e kryerjes së veprës penale dhe se veprën penale nuk e kanë konsideruar si të vete** ashtu siç pretendon prokurori në aktakuzë.

I. Gjykata në vështrim të nenit 361 parag. 1 dhe 2 të KPP-së aktgjykimin për të akuzuarit **I. M., V.I, N.G dhe N.A** e bazoj në faktet dhe në provat e administruara në shqyrtim gjyqësor të cilat prova i vlerësoi me ndërjegje një nga një dhe në lidhje me provat e tjera dhe në bazë të vlerësimit të tillë erdhi në përfundim se të njëjtit në bashkëkryerje kanë kryer vapën penale Importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve nga neni 372 par.2 lidhur me par.1 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së.



Gjykata me rastin e vendosjes si në dispozitiv të këtij aktgjykimi u bazua në dëshminë e dëshmitarit **Dëshmitari M.K të dhënë** në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 01.11.2021 si dhe deklarata e tij e dhënë në stacionin policor i cili ka deklaruar, se *“në mars të vitit 2019 e ka thirr menagjeri i firmës S.LN. Apër të shkuar me i marr do pako në një lokacion në Fushë Kosovë, më pastaj i ka thënë se është shumë i zanë nuk mundem me shku me i marr, ai kishte thënë se drejtori po thotë ( I. M.) se duhet me shku patjetër me i marr, me pastaj ka shkuar që ti marrë pakot të ndryshme te rruga Xh. M. në F.K.( në lokalit e V.I) kur ka shkuar në firmën B T. F. akuzuar në këtë raste ka kërkuar nga M. që ta kontaktoi drejtorin I. M, në prezencën e tij në lidhje me pakot ku i njëjti I.M ka thënë që N. i ka porositur me i marr pakot meqenëse F. e njihte N., më pastaj e ka thirr në telefon N. dhe N.i kërkon nga F.H me ja dhënë pakot, i ka marr ato pako, ka qenë në një lokal me xhama të zi, ka qenë thatë lokalit, një person i moshës madhore me flokë të bardha ia ka dhanë, ka qenë afro 60 vjeç, dhe se pakot i ka dërguar në depon e S.L në M., veç i kanë shprazë me koleget e tij dhe kanë vazhduar tutje se e kanë përfunduar orarin e punës, për këtë e ka njoftuar menagjerin N.A dhe për ato pako nuk kanë marrë fatura as pare, por vetëm me telefonatën e drejtorit kanë shkuar me i marrë kurgjo tjetër. Pakot kanë qenë të zakonshme paketa sandarte dhe nuk ka pasuri njohuri se çfarë ka pasur brenda, dërgesa nuk kishte konotë, dhe vetë ai nuk ka pasur njohuri se çka ka pasur në ato pako përveç kur është njoftuar nga policia përmes telefonit të cilët e kanë ftuar që të takohen për ti treguar vendin ku i ka marr pakot, Vendin se ku janë pakot me i marr i ka thënë drejtori I.M në vendin e cekur me lartë, sa i kujtohet numrin e peronit që ka pas me i marr pakot, ia ka dërguar drejtori me sms dhe ka kontaktuar me personin ku je, i cili i ka thënë hajde, është shkuar dhe është takuar me atë person, i cili ka thënë qeto pako ke me i marr ia ka ngarkuar ndërsa pësha e tyre, edhe të lehta jo, ka i kanë ngarkuar dhe shkarkuar, kur pse nuk kanë pasur konot nuk ka qenë përgjegjësi e veta me ju përzi drejtorit se a i merr pa konot apo me konot.”* Nga deponimi i dëshmisë së këtij dëshmitari gjykata vërtetoi faktin se sipas marrëveshjes paraprake i pandehuri V.I, paraprakisht i ka siguruar 25 pako me armë dhe i ka vendosur në lokalit e tij në Fushë Kosovë, veprim të cilin nuk e mohon as i akuzuari V.I i cili pranon se pakot me armë i ka vendosur në lokalit e tij në F. K., dhe më pas me kërkesë të N.A. menagjeri i firmës S.L, dhe me insistimin e I.M pronar i kompanisë S. L., dëshmitari M.K i kishte marrë pakot nga depoja në F. K.dhe i kishte dërguar në objektin e postës “S.L” në fshati M., fakt të cilin nuk e mohonin as të akuzuarit N.A dhe I. M, **Dëshmitari B. M.** në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 01.11.2021 ka deklaruar, se *” I njëjti ka theksuar se e njuh V.I e ka edhe shok, edhe për kohën të cilën po flasim kanë pas bashkëpunim në lidhje me pajisjet të cilat janë shitur në lokalit e tij, bashkëpunimi që kanë pasur ka qenë se V. ka sjellë pajisjet prej ashtë, dhe vetë ai i ka blerë prej tij dhe i ka shitë në lokalit e tij, ndërsa vetë qenë përgjegjësi kryesor për mbarëvajtjen e lokalit, tuje thekson se N.G e ka njohur përmes V, ndërsa nuk ka njohuri-dijeni dhe nuk i kujtohet që në lokalit e tij, ka pas edhe gjera disa pako të vendosura që nuk i përkasin pajisjeve elektor shtëpiake”* **M.P të dhënë** në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 21.10.2021 i cili ka deklaruar, se *“ ka punuar në S.L si kontabilist, i njuh personat I.M, dhe N. A.pasi që të parin e ka pas shef ndërsa të dytin e njuh se ka qen menagjer i kompanisë me seli në Prishtinë, po ashtu në zyrat e S.L ka takuar edhe V.I dhe M. G. ndërsa të akuzuarit të tjerë deklaror se nuk i njuh dhe nuk i ka takuar ose parë në kompaninë S.L.* Nga deponimi i dëshmisë së këtyre dëshmitarëve gjykata vërtetoi faktin se ekziston lidhja objektive në mes tyre, për të ndërmarrur veprim i cili i ka kontribuar kryerjes së veprës penale, pasi që siq vërtetohet nga këta dëshmitar pasojat e veprës penale janë rezultat i përbashkët i veprimeve të të gjithë të akuzuarve, ashtu siq deklarorin edhe dëshmitarët vërtetohet fakti se të akuzuarit I.M., V.I, N.G dhe N.A kanë ndërmarr veprim dhe i kanë kontribuar kryerjes së veprës penale Importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve nga neni 372 par.2 lidhur me par.1 e lidhur me nenin 31të KPRK-së. Po ashtu të gjithë këto dëshmi të këtyre dëshmitarëve vërtetoi faktin se ekziston lidhja subjektive në mes të pandehurve, për faktin se të njëjtit kanë pasur dijeni për njeri tjetrin, dhe janë njohur personalisht me njeri tjetrin, **dhe po ashtu vërtetohet fakti se të njëjtit janë marr vesh mbi ndarjen e punës për realizimin e pjesës së vet në procesin e kryerjes së veprës penale dhe se veprën penale e kanë konsideruar si të veten.**

Faktin se të akuzuarit I. M., V.I, N.G dhe N.A në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale Importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve nga neni 372 par.2 lidhur me par.1 e lidhur me nenin 31të KPRK-së vërtetohet edhe nga provat materiale të cilat janë administruar në shqyrtimin gjyqësor e të cilat janë pjesë e lëndës. siq janë **Vërtetimi mbi marrjen e sendeve**, nga kjo provë vërtetohet fakti se në depon e S.L, gjatë kontrollimit të depos “S.L”

janë gjetur dhe sekuestruar gjithsej 99 armë të llojit Glock-Austria dhe Sig-Sauer si dhe 723 fishek të kalibrit të ndryshëm të cekur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, **nga raportet policore mbi zbatimin e masave të fshehta të përgjimit**, gjykata vërteton faktin se V.e thirr në telefon F. H. punëtor në firmën B.T. dhe i thotë që të qëndroi në punë më gjatë deri rreth orës 20:00, për arsye se dikush do ti sjell me vetur P. të bardhë 25 pako dhe të cilat duhet me i vendos në depon e lokalit, dhe po ashtu V. njofton F. se Vetura Pikap ka ardhur dhe i njëjti pakot i vendos në depo dhe e njofton V se pakot kanë mbrri, I.M përmes telefonit i thotë M.K shofer në kompaninë S.L që të shkoi në firmën B. T. rr, Xh. M.në F. K., me pronar V.I ti merr disa pako dhe ti sjell në depon e kompanisë S.L, në fshatin M. Komuna e O., po ashtu ja jep edhe numrin e telefonit të punëtorit të kësaj kompanie F.H(i akuzuar në këtë rastë), F.H e ka thirr në tel N.G dhe i njëjti kërkon nga F.H që të ia jap pakot ku M. shkon dhe i merr gjithsej 25 pako dhe i dërgon në sim Logjistik, dhe po ashtu gjatë zbatimit të këtyre masave të akuzuarit I.M, V.I, N.G dhe N A kanë komunikuar vazhdimisht në mes vete lidhur me dërgesën e cila ka rezultuar dhe provuar se bëhet fjalë për armët. Nga **videoincizimet e nxjerra nga pajisjet e marra në firmën “S.L”**, gjykata vërteton faktin se me dt:10.03.2019, rreth orës 17:50:40 I.M vjen në parkingun e Kompanisë S.L me automjetin e tipit BMW nga vetura merr një çantë dhe shkon poshtë tek hyrjet e depos në katin përdhës, e len çantën pastaj kthehet në parking tek automjeti pa çantë dhe largohet me automjet, kurse rreth orës 18:33:40, N.G dhe V.I vinë me veturën Pasat me tabela të regjistrimit ..., në parkingun e kompanis S.L, qëndronin në veturë derisa të vije I.M pastaj të tretë hyn në depo lart pastaj dalin dhe shkoi në depon e vogël kati përdhese, me gjësende në duar si alofolie, dorëza etj, I.M e hap derën e depos dhe del i merr disa armë pastaj e mbyll derën i vendosin dorëzat I. M., V.I dhe N.G, dhe filloi me paketimin e armëve në pakot me barëra TamioL XX të cilat barëra i përdorin për fshehjen dhe kamuflimin e armëve të cilat i mbështjellin me foli dhe i mbyllin sërish pakot, derisa i përfundonin të gjitha, më pastaj vazhdonin rrugë lartë objektit dhe futen në zyrat e kompanisë S.L qëndronin disa minuta, më pas dalin jashtë dhe largohen nga kompania S.L, N.G largohet me veturën Pasat, V.I largohet me veturën BMW, ndërsa I.M largohet me veturën Reno që të gjithë largohen rreth orës 19:14:10. Më pastaj më dt:15.03.2019 I. M., N.G dhe V.I vin përsëri në kompaninë S.L, dhe së bashku me N. A. i bartin pakot me armë nga depoja dhe i vendosin në zyrat lartë, dhe të njëjtit largohen nga kompania S.L. Nga kjo gjykata vërteton faktin se kontakti i vetëm fizik ka qen në mes të I.M, V.I, N.G dhe N A.t. **Nga raportet mbi masat e fshehta të vëzhgimit dhe hetimit**, vërtetohet se kontaktet fizike kanë qen në mes të I.M, V.I. N.Gt dhe N A dhe disa personave të tjerë, nga këto prova vërtetohet fakti se ekziston lidhja objektive në mes të pandehurve, I.M, V.I., N.G dhe N. A për të ndërmarre veprim i cili ka kontribuar kryerjes së veprës penale, Importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve nga neni 372 par.2 lidhur me par.1 e lidhur me nenin 31të KPRK-së, pasi që siç vërtetohet nga këto prova pasojat e veprave penale të cekura si në dispozitiv të këtij aktgjykimi janë rezultat i përbashkët i veprimeve të të gjithë të akuzuarve, dhe se ekziston lidhja subjektive në mes të pandehurve, për faktin se të njëjtit kanë pasur dijeni për njeri tjetrin, janë njohur personalisht me njeri tjetrin, **dhe po ashtu vërtetohet fakti se të njëjtit janë marr vesh mbi ndarjen e punës për realizimin e pjesës së vet në procesin e kryerjes së veprës penale dhe se veprën penale e kanë konsideruar si të veten.** Nga raporti mbi ekzaminimin e armëve gjykata vërteton faktin se armët e sekuestruara në kompaninë S.L kanë qen të dizajnuara për fishek të kalibrit 9mm Gaz, mirëpo armëve i është prerë tyta e fabrikuar afër folesë dhe i është adaptuar një tytë me gjashtë palë vjaska të prodhuar në mënyrë artizanale dhe përmes filetave që i janë bërë tytës së adaptuar është vendosur në vendin që është prerë tyta e fabrikuar në mënyrë që armët të shkrepin fishek të kalibrit 7.65x17 mm, me mbushje të barotit dhe në këtë mënyrë armët janë bërë armë zjarri.

Si është potencuar dhe vendosur në dispozitiv të këtij aktgjykimi, gjykata në këtë çështje penale mori aktgjykim dënues për të akuzuarit I.M, V.I, N.G dhe N. A. dhe të njëjtit i ka shpallur fajtor për veprën penale Importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve nga neni 372 par.2 lidhur me par.1 e lidhur me nenin 31të KPRK-së, ku kjo dispozitë ligjore ka përcaktuar se “1. **Kushdo që në shkelje të ligjit të zbatueshëm në lidhje me armët apo materiet plasëse, importon, eksporton, blen, furnizon, transporton, prodhon, këmben, ndërmjetëson ose shet armë apo materie plasëse, dënohet me gjobë deri në shtatë mijepesëqind (7.500) Euro dhe me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet. 2. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni përfshin më shumë se katër armë, më shumë se katër (4) materie plasëse apo më shumë se katër qind (400) fishekë, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në dhjetë (10) vjet” Ky formulim, është formulim ligjor të cilin e ka përdorur ligji tek vepra penale e Importi, eksporti, furnizimi,**

transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve nga neni 372 par.2 lidhur me par.1 e lidhur me nenin 31të KPRK-së, e për tu konsideruar përgjegjës për këtë veprë penale, në çdo rast kryerësi i veprës penale duhet në veprimet e veta ti konsumoj elementet e kësaj veprë penale. Po ashtu për të ekzistuar forma e bashkëpunimit duhet të plotësohen elementi objektiv, ***pra si bashkëkryerës është personi I cili së bashku me të tjerët ndërmerr veprimin e kryerjes së veprës penale të caktuar*** si dhe elementi subjektiv ***pra si bashkëkryerës është personi I cili së bashku me tjetrin në bazë të marrëveshjes mbi ndarjen e punës realizon pjesën e vet në procesin e kryerjes së veprës penale e ka dëshiruar pasojën dhe veprën penale e konsideron sit ë veten.*** Siç është theksuar edhe më lartë për tu konsideruar e kryer kjo veprë penale, veprimi i kryerësit është përcaktuar në mënyrë alternative kryerësi i saj duhet që në mënyrë alternative ti ndërmerr veprimin ashtu që veprën penale e kryen ai që ***furnizon, transporton, prodhon, këmben ose shet armë pa autorizim*** d.m.th. kryerësi duhet të ndërmerr ndonjërin nga këto veprime pa pasur autorizim për një veprim të tillë. Gjykata konsideron se të akuzuarit ***I.M, V.I, N.G dhe N.A*** në raport me elementet e veprës penale, kanë konsumuar në tërësi me veprimet e veta elementet inkriminuese të veprës penale, pasi që fillimisht i akuzuari ***V.I në bashkëpunim me të akuzuarit I.M., N.G dhe N.A*** kanë siguruar 25 pako me armë të tipit Glock Austria dhe Sig Suer, të cilat i ka vendosur në një zyrë të lokalit të tij në F. K., të cilat armë i kanë siguruar në kundërshtim me Ligjin për Armët pasi që nuk kanë pasur autorizim siç kërkon ky ligj, nga këto veprime konsumohet elementi i veprës penale ***furnizimit*** me armë me qëllim të shitjes, më pastaj të njëjtit armët e siguruar i kanë transportuar nga lokali i të akuzuarit V.I në F.K në lokalet e postës S.L në M., e pastaj të njëjtit i ndajnë armët në pako me qëllim të dërgimit dhe shitjes në vendet të ndryshme, nga këto veprime konsumohet elemnti i veprës penale ***transportimi*** me armë me qëllim të shitjes. Gjykata vërtetoi faktin se në mes të akuzuarve ekziston ***lidhja objektive*** për të ndërmarrë veprim i cili i ka kontribuar kryerjes së veprës penale, pasi që siç vërtetohet pasojat e veprës penale janë rezultat i përbashkët i veprimeve të të gjithë të akuzuarve Po ashtu vërtetohet fakti se ekziston edhe ***lidhja subjektive*** në mes të pandehurve, për faktin se të njëjtit kanë pasur dijeni për njeri tjetrin, dhe janë njohur personalisht me njeri tjetrin, ***dhe po ashtu vërtetohet fakti se të njëjtit janë marr vesh mbi ndarjen e punës për realizimin e pjesës së vet në procesin e kryerjes së veprës penale dhe se veprën penale e kanë konsideruar si të veten.***

Gjykata duke analizuar dhe vlerësuar pretendimin e mbrojtësit të të akuzuarit ***I.M*** av. Mahmut Halimi dhe mbrojtjen e të akuzuarit I.M të dhëna në shqyrtimin gjyqësor ka konstatuar se mbrojtja e dhënë është në drejtim të shmangies nga përgjegjësia penale, kjo pasi që është në kundërshtim të plotë me provat personale dhe materiale të cilat gjykata i ka administruar në shqyrtimin gjyqësor e të cilat gjykata i dha besim te plotë, ndërsa pretendimet e mbrojtësit të të akuzuarit I.M av. Mahmut Halimi dhe mbrojtjen e të akuzuarit I.M se kinse “ *nuk ka prova që vërteton se i mbrojturi i tij I ka bërë ripaketimin e pakove të larte cekura duke futur në pako armë dhe barëra dhe atë në ambientet e kompanisë S.L. pra assesi nuk mund të vërtetohet një pretendim i tillë. Nga vido-incizimi shihet prezenca e të pandehurve I, V dhe Nnë brendi të depos të cilët bëjnë shikimin e pakove te vendosura. Prandaj pistoletat dhe barërat kanë qenë te vendosura qysh me herët dhe te paketuara në pako nga pësoni i quajtur “Doni”, e të cilat rrethana ndriçohen nga deklarata e Iit i cili ka theksuar se më kërkesën e te akuzuarit V kanë shkuar në depo kanë shikuar përmbajtjen e pakove dhe atë nga arsyeja e shqetësimit të akuzuarit V për mungesë kontaktit me pranuesin e mallit. Po ashtu ky i akuzuar pranon edhe faktin se pas hapjes se pakove ka vërejtë pistoletat se janë me gas, me pastaj i kanë mbyllur pakot të cilat në fakt me datë 21.03.2019, organet e ndjekjes pas intervenimit i kanë gjetur armët dhe i kanë sekuestruar të njëjtat. Po ashtu rasti i dt. 10.03.2019 ku sipas lutjes se të akuzuarit V si dërgues i mallit ka pranuar qe të bëjë shiqimin e pakove në të cilat ka vërejtur pistoletat dhe barëra. E ketë veprim i mbrojturi i e ka bërë mbi bazën e përvojës se tij, në RF të Gjermanisë ka konsideruar se veprimet e tilla nuk janë te palejuara, se me shiqimin e tyre ka konkluduar se është fjala për pistoletat gasi, qarkullimi i të cilave nuk është i ndaluar. Pra në ketë drejtim ekziston lajthimi juridik të Ii lidhur me armët në pako. Me tutje i njëjti thekson se duke marr parasysh se I me kërkesë të V. ka bërë shiqimin e pistoletave dhe nuk e ka denoncuar tek organet e ndjekjes të cilat me datë 21.03.2019 janë zbuluar ekzistimi i tyre, andaj me këto veprime të tilla mund te përmbushen elemetet e veprës penale Moslajmërimi i veprave penale apo kryerësve të tyre nga nnei 387 par.2 e lidhur me par .1 pika 1.9 të KPRK. “ i hodhi poshtë si të pa besueshme, për faktin se të gjitha provat personale dhe materiale të administruara në shqyrtimin gjyqësor dhe të elaburoara si më lart vërtetoiin faktin se i akuzuari I.M, ka insistuar që M.K ti merrte pakot me armë nga depoja në F.K dhe i kishte dërguar në objektin e postës “S.L”, më pastaj të njëjtat i paketoi në bashku edhe me të akuzuarit V.I, N.G dhe N.A me qëllim*

të shitjes nga mënyra e paketimin, ndarjes nëpër pako del se qëllimi i fundit i te akuzuarve ka qene qe te njëjtat ti shesin, dhe kane qene te vetëdijshëm se është fjala për armë dhe se veprimet i kane ndërmarr ne mënyrë te paautorizuar, për çka gjykata të akuzuarin e shpalli penalisht përgjegjës dhe i shqiptoj dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

Gjykata duke analizuar dhe vlerësuar pretendimin e mbrojtësit të të akuzuarit **V.I** av. Betim Shala si dhe nga vet deklarimi i të akuzuarit i cili pas rikualifikimit të veprës penale të bërë në fjalën përfundimtare nga Prokurori Special e ka pranuar fajësinë, gjykata ka konstatuar se mbrojtja e dhënë përputhet plotësisht edhe me gjetjet dhe konstatimet e trupit gjykues, ky deklarim i të akuzuarit në raport me gjetjet e trupit gjykues është në harmoni të plotë me provat personale dhe materiale të cilat gjykata i ka administruar në shqyrtimin gjyqësor e të cilat gjykata i dha besim te plotë. Gjykata rikujton se i akuzuari V.I, pas rikualifikimit të veprës penale të bërë në fjalën përfundimtare nga Prokurori Special e ka pranuar fajësinë, për veprat penale për shkak të veprave penale Importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve nga neni 372 par.2 lidhur me par.1 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së, dhe Tregti e ndaluar e ndaluar nga neni 305 par.2 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së, mirëpo një pranim të till trupit gjykues nuk e ka pranuar pasi që deklarimi i till nuk kishte mbështetje në provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor lidhur me veprën penale Tregti e ndaluar nga neni 305 par.2 të KPRK-së, pasi që nga deklarimi i dëshmitarëve të procedurë në shqyrtimin gjyqësor si dhe nga provat materiale të administruara në shqyrtimin gjyqësor gjykata nuk vërtetoi faktin se i akuzuari V.I të ketë kryer në bashkëkryerje edhe veprën penale nga neni 305 par.2 të KPRK-së, ashtu siç i ngarkon akuza e precizuar, pasi që në mes të akuzuarve nuk vërtetohet se ekziston **lidhja objektive** për të ndërmarrur veprim i cili i ka kontribuar kryerjes së veprës penale, pasi që siç vërtetohet pasojat e veprës penale nuk kanë qenë rezultat i përbashkët i veprimeve të të gjithë të akuzuarve, po ashtu nuk vërtetohet fakti se ekziston edhe **lidhja subjektive** në mes të pandehurve, për faktin se të njëjtit nuk kanë pasur dijeni për njeri tjetrin, dhe nuk janë njohur personalisht me njeri tjetrin, **dhe po ashtu nuk vërtetohet fakti se të njëjtit janë marr vesh mbi ndarjen e punës për realizimin e pjesës së vet në procesin e kryerjes së veprës penale dhe se veprën penale nuk e kanë konsideruar si të veten**, mirëpo gjykata gjeti se ka prova se të akuzuarit V.I, N.G, I.M dhe N.A në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e pa autorizuar e armeve apo materieve plasëse nga neni 372 par.2 lidhur me par.1 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Gjykata duke analizuar dhe vlerësuar pretendimin e mbrojtësit të të akuzuarit **N.G** av. Haxhi Millaku ka konstatuar se mbrojtja e dhënë është në drejtim të shmangies nga përgjegjësia penale, kjo pasi që është në kundërshtim të plotë me provat personale dhe materiale të cilat gjykata i ka administruar në shqyrtimin gjyqësor e të cilat gjykata i dha besim të plotë, ndërsa pretendimet e mbrojtësit të të akuzuarit N.G av. Haxhi Millaku se kinëse *“se aktakuza në pjesën e provave verbale dhe materiale, deklaratat e dëshmitareve nuk ofrojnë fakte të mjaftueshme qe të vërtetonin implikimin e të mbrojturit të tij në këtë çështje në çfarëdo interpretimi në vetvete dhe në raport me provat tjera nuk vërtetojnë dyshimin e bazuar mirë por mbesin në stadin e indiceve apo dyshimit të arsyeshëm, pra nuk plotësojnë standardin e domosdoshëm qe kërkohet nga ligjvënësi përtej dyshimit të bazuar mirë apo probabilitetin e të provuarit mbi faktet vendimtare. Po ashtu i mbrojturi i tij nuk njih asnjë person çoftë të akuzuarit apo dëshmitaret të cilët edhe vetë në dëshmitë e tyre kanë thënë një fakt të tillë, por se njih vetëm V.I, por asnjëherë nuk ka pasur ndonjë marrëdhënie biznesi apo pune me të. Po ashtu provat materiale e plotësojnë dhe e vërtetojnë gjendjen faktike si dhe vetë deklarimi i të mbrojturit t ë tij, dhe në përputhshmëri me njëra tjetrën vërtetojnë në mënyrë të pa dyshimit faktet relevante të sakta dhe te qarta elaborimi në seancat e kaluara e të cilat prova e lirojnë nga përgjegjësia penale dhe nga akuza të mbrojturin e tij. Përkatësisht në shqyrtim gjyqësor janë dëgjuar dëshmitar janë lexuar disa prova si dhe i mbrojturi i tij nuk ka paraqitur mbrojtjen para trupit gjykues, ka shfrytëzuar te drejtën të mbrohet në heshtje dhe ka mbështetur deklarin e dhënë në prokurori, duke vërtetuar çart, rrjedhshëm dhe saktësinë e fakteve dhe rrethanat qe argumentojnë pafajësinë e tij. Të gjitha këto veprime të përshkruar në dispozitiv a kanë mundur të kryhen pa personin N.G dhe cila kanë qenë ato veprime esencial ishte të bash kryerjes ashtu siç thotë ligjvënësi, por i vetmi arrestim është se N.G është gjend të kohë të caktuar, në vend të caktuar dhe ne selin e caktuar, dhe asnjë a implikim nuk e ka as para as mbrapa. Andaj në mungesë të elementit esencial subjektiv-dashjes në të gjitha variantet e saja apo çfarë- motivi ekzistues kjo argumentohet edhe mbi bazën e për shkrimit të gjendjes se fakteve apo provave, aktakuza nuk ka arritur qe të kaloj limitet ligjore*

*qe përtej dyshimit të bazuar të argumentoj dhe të vërtetoj fajësinë e të mbrojturit të tij, në të gjitha fazat e procedurës si dhe në shqyrtim gjyqësor.* Trupi gjykues deklarimet e tilla i hodhi poshtë si të pa besueshme, për faktin se të gjitha provat personale dhe materiale të administruara në shqyrtimin gjyqësor dhe të elaburoara si më lart vërtetoi faktin se i akuzuari N.G, në bashkëkryerje edhe me të akuzuarit V.I, I.M dhe N.A kanë kryer veprën penale si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata duke analizuar dhe vlerësuar pretendimin e mbrojtësit të të akuzuarit N.A av. Shyqeri Sylja dhe mbrojtjen e të akuzuarit N.A të dhëna në shqyrtimin gjyqësor ka konstatuar se mbrojtja e dhënë është në drejtim të shmangies nga përgjegjësia penale, kjo pasi që është në kundërshtim të plotë me provat personale dhe materiale të cilat gjykata i ka administruar në shqyrtimin gjyqësor e të cilat gjykata i dha besim të plotë, ndërsa pretendimet e mbrojtësit të të akuzuarit N.A av. Shyqeri Sylja dhe mbrojtjen e të akuzuarit N.A se kinse *“provat e administruar a gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk vërtetuan themelësinë e aktakuzës me të cilin është akuzuar N.A andaj me mohimin kategorik të të mbrojturit të tij, me dëshmitë e dëshmitareve dhe provat e pranueshme materiale të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk u vërtetua asnjëra prej këtyre veprave penale. Tutje i njëjti shton se nga vetë te pandehurit, dëshmitaret e proceduar video-incizimet, fotodokumenatacioni, vërtetim për marrjen e dëshmime- nuk vërtetuan se N.A me dashje ka bërë bartjen e pakove. Pra sipas provave materiale e personale, dashja e tij ka qenë vetëm ofrimi i ndihmës fizike shoferëve gjatë ngarkimit- shkarkimit të tyre për shkak te fluksit të madh të punës ditën kritike, prandaj nuk ka qenë dëshira për tu implikuar në kryerjen e veprave penale. Ashtu qe i mbrojturi i tij, nuk ka ditë as për pasojën eventuale qe ka mund të shkaktohet gjatë kësaj ndihme, as qe do te pranonte shkaktimin e saj, me arsytimin qe duke mos qenë pranues i mallit as nuk ka qenë në dijeni se ç ‘përmbanin pakot, se çfarë ka pasur brenda tyre, për çka ka kuptuar kur policia ka kontrolluar pakot ne depo dhe me atë rast i ka zbuluar armët. Po ashtu me asnjë provë të pranueshme materiale nuk është vërtetuar qe i pandehuri të ketë kryer veprën penale Tregti e palejuar nga neni 305 të KPRK. Mirëpo duke theksuar faktin se përveç I.M. qe njeft, i cili ka qenë drejtor i kompanisë, S.L.N.A nuk njeh asnjërin prej te akuzuarve tjer”.* Trupi gjykues deklarimet e tilla i hodhi poshtë si të pa besueshme, për faktin se të gjitha provat personale dhe materiale të administruara në shqyrtimin gjyqësor dhe të elaburoara si më lart vërtetoi faktin se i akuzuari N.A në bashkëkryerje edhe me të akuzuarit V.I, I.M dhe N.G kanë kryer veprën penale si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata vlerësoi me shumë kujdes të gjitha provat e administruara në shqyrtim gjyqësor, sa i përket të akuzuarve **I.M, V.I, N.G dhe N.A** dhe ka ardhur në përfundim se duhet t’i falet besimi i plotë, provave personale siç janë deklarata e dëshmitarit M.K të dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 01.11.2021, nga e cila deklarat gjykata vërtetoi faktin se sipas marrëveshjes paraprake i pandehuri V.I, paraprakisht i ka siguruar 25 pako me armë dhe i ka vendosur në lokalin e tij në F. K., deklarim i cili përputhet plotësisht edhe me deklarin e të akuzuarit V.I i cili pranon se pakot me armë i ka vendosur në lokalin e tij në F. K., dhe më pas me kërkesë të N. A. menagjer i firmës S.L, dhe me insistimin e I.M pronar i kompanisë S.L., dëshmitari M.K i kishte marrë pakot nga depoja në F.K dhe i kishte dërguar në objektin e postës “S.L” në fshati M., fakt të cilin nuk e mohonin as të akuzuarit N.A dhe I.M, Dëshmitarit B. M., Dëshmitarit M.P të dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 21.10.2021, Nga deponimi i dëshmisë së këtyre dëshmitarëve gjykata vërtetoi faktin se ekziston lidhja objektive në mes tyre, për të ndërmarrur veprim i cili i ka kontribuar kryerjes së veprës penale, pasi që siq vërtetohet nga këta dëshmitar pasojat e veprës penale janë rezultat i përbashkët i veprimeve të të gjithë të akuzuarve, ashtu siç deklarorin edhe dëshmitarët vërtetohet fakti se të akuzuarit I.M., V.I, N.G dhe N.A kanë ndërmarr veprim dhe i kanë kontribuar kryerjes së veprës penale Importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve nga neni 372 par.2 lidhur me par.1 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së. Po ashtu të gjithë këto dëshmi të këtyre dëshmitarëve vërteton faktin se ekziston lidhja subjektive në mes të pandehurve, për faktin se të njëjtit kanë pasur dijeni për njeri tjetrin, dhe janë njohur personalisht me njeri tjetrin, dhe po ashtu vërtetohet fakti se të njëjtit janë marr vesh mbi ndarjen e punës për realizimin e pjesës së vet në procesin e kryerjes së veprës penale dhe se veprën penale e kanë konsideruar si të veten. Gjykata vlerësoi me shumë kujdes të gjitha provat e administruara në shqyrtim gjyqësor, dhe ka ardhur në përfundim se duhet t’i falet besimi i plotë, provave materiale të administruara në shqyrtimin gjyqësor siç janë, Vërtetimi mbi marrjen e sendeve, raportet policore mbi zbatimin e masave të fshehta të përgjimit, video incizimet e nxjerra nga pajisjet e marra në firmën “S.L”,

raportet mbi masat e fshehta të vëzhgimit dhe hetimit, raporti mbi ekzaminimin e armëve, fotoalbumi, Andaj gjykata këto dëshmi i konsideroi të besueshme, dhe të njëjtave ua fali besimin.

**II.** Gjkata në vështrim të nenit 361 par. 1 dhe 2 të KPP-së aktgjykimin për të akuzuarit **B.S,S.S dhe A.I** e bazoj në faktet dhe në provat e administruara në shqyrtim gjyqësor të cilat prova i vlerësoi me ndërgjegje një nga një dhe në lidhje me provat e tjera dhe në bazë të vlerësimit të tillë erdhi në përfundim se të njëjtit në bashkëkryerje kanë kryer veprën Tregti e ndaluar nga neni 305 par.2 të KPRK e lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Gjkata me rastin e vendosjes si në dispozitiv të këtij aktgjykimi u bazua në dëshminë e dëshmitares **I.M të dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 17.01.2022** si dhe deklaratën e dhënë në prokurori dhe polici, e cila ka deklaruar, se *“ka dhënë dëshmi dy here në polici dhe një herë në prokurori, herën e parë kur ka shkuar nuk kam muajt me thanë të vërtetën për arsye se fillimisht për vetë faktin që ka qenë në polic, ndërsa arsyeja e dytë personit që ja ka shitë barnat i ka thënë mos me tha të vërtetën (fjala është për A.I). Pas dy ditëve që ka dhënë deklaratë për herën e dytë në polici ka ndje obligim moral shpirtëror për ta treguar të vërtetën, i kujtohet përmbajtja e dëshmisë së dhënë polici dhe deklaratën e dhënë në prokurori dhe qëndron pranë deklaratës së dhënë në prokurori tutje e shton se barnat ja ka shitë shoku të saj A.I ku vetë ajo ka pas barnatoren e saj që quhej “B. Ph.”, pasi A e ka pas shok të familjes pasi njihen më shumë se 18 vite, dhe konsideron sikurse vëlla, dhe i cili i ka thënë se po me duhet me marr kësi barna, sado që merr unë ti blej, edhe ka filluar me porosit barna, Me tej thekson se A. ka ndodh me ardhë mi ble barnat me një person tjetër e që nuk ka qenë vetëm e që në sallë e ka identifikuar B.S.”* Nga deponimi i dëshmisë së kësaj dëshmitare gjykata vërtetoi faktin se sipas marrëveshjes paraprake të pandehurit B.S dhe S.S barnat i kanë siguruar nga i pandehuri A.I i cili e ka shfrytëzuar raportet miqësore me dëshmitaren I.M dhe barnat e kanë siguruar nga barnatorja ku pronare ka qenë dëshmitarja me qellim që të njëjtat të shiten nëpër barnatore të ndryshme në Kosovë. Nga deponimi i dëshmisë së kësaj dëshmitare gjykata vërtetoi faktin se ekziston lidhja objektive në mes tyre, për të ndërmarrur veprim i cili i ka kontribuar kryerjes së veprës penale, pasi që siç vërtetohet nga këta kjo dëshmitare pasojat e veprës penale janë rezultat i përbashkët i veprimeve të të gjithë të akuzuarve, ashtu siç deklaroi edhe dëshmitarja vërtetohet fakti se të akuzuarit B.S,S.S dhe A.I kanë ndërmarr veprim dhe i kanë kontribuar kryerjes së veprës Tregti e ndaluar nga neni 305 par.2 të KPRK e lidhur me nenin 31 të KPRK-së. Po ashtu kjo dëshmitare vërtetoi faktin se ekziston lidhja subjektive në mes të pandehurve, për faktin se të njëjtit kanë pasur dijeni për njeri tjetrin, dhe janë njohur personalisht me njeri tjetrin, **dhe po ashtu vërtetohet fakti se të njëjtit janë marr vesh mbi ndarjen e punës për realizimin e pjesës së vet në procesin e kryerjes së veprës penale dhe se veprën penale e kanë konsideruar si të veten.**

Faktin se të akuzuarit **B.S,S.S dhe A.I** në bashkëkryerje kanë kryer veprën Tregti e ndaluar nga neni 305 par.2 të KPRK e lidhur me nenin 31 të KPRK-së, vërtetohet edhe nga provat materiale të cilat janë administruar në shqyrtimin gjyqësor e të cilat janë pjesë e lëndës. siç janë **Vërtetimi mbi marrjen e sendeve**, nga kjo provë vërtetohet fakti se në depon e S.L, gjatë kontrollimit të depos “S.L” janë gjetur dhe sekuestruar produkte medicinale ilegale dhe atë, *Barna Tamiol XX 200 mg 4810 paketime, barna Camagra Shampon 3012 paketime, barna të ndryshëm 3000 paketime, dorëza medicinale 5 paketime, si dhe në garazhin e të pandehurit B.S e cila gjendet në rr. U. A. Blloku A. G. gjatë kontrollimit janë konfiskuar barna të ndryshëm ilegale të cilat pa autorizim dhe në kundërshtim me Ligjin për shëndetësi nr. 04/L-125, Ligjin për produkte dhe pajisje medicinale 04/L-190 dhe Udhëzimit Administrativ 11/2015, i kanë blerë, shitur dhe shkëmbyer barna me veprim të ndryshëm terapeutik, pa banderola, me banderola të R. Serbisë, si dhe me afat të skaduar, të cilat mallra janë të kufizuara.*

**Nga raportet mbi masat e fshehta të vëzhgimit dhe hetimit**, vërtetohet se me dt: 20.03.2019, i pandehuri B.S me veturën e tij të tipit A.A3 e targa të regjistrimit ... është ngarkuar me barna ilegale në kompaninë S.L dhe ka vazhduar rrugë dhe është parkuar në garazhin e cila gjendet në rrugën B në P., një dit më vonë konkretisht me dt: 21.03.2019, përsëri ka lëvizur me veturën e lartcekur i cili ka vazhduar rrugën deri te lagja U. në P. ku është takuar me vëllain e tij S.S, i cili ka qenë me veturën e tij të tipit Opel Corsa me targa të regjistrimit ... e të cilit ja ka dhënë një pako me barëra të ndryshëm i cili i ka fut në veturë, dhe pasi që janë ndarë janë ndaluar nga hetuesit dhe kontrollimit janë konstatuar se në veturat e tyre janë gjetur barëra të ndryshëm. Nga këto prova vërtetohet fakti se ekziston lidhja objektive në mes të

pandehurve, **B.S,S.S dhe A.I** për të ndërmarrur veprim i cili ka kontribuar kryerjes së veprës penale, Tregti e ndaluar nga neni 305 par.2 të KPRK e lidhur me nenin 31 të KPRK-së pasi që siç vërtetohet nga këto prova pasojat e veprave penale të cekura si në dispozitiv të këtij aktgjykimi janë rezultat i përbashkët i veprimeve të të gjithë të akuzuarve, dhe se ekziston lidhja subjektive në mes të pandehurve, për faktin se të njëjtit kanë pasur dijeni për njeri tjetrin, janë njohur personalisht me njeri tjetrin, **dhe po ashtu vërtetohet fakti se të njëjtit janë marr vesh mbi ndarjen e punës për realizimin e pjesës së vet në procesin e kryerjes së veprës penale dhe se veprën penale e kanë konsideruar si të veten.** Nga vendimi i inspektoratit Farmaceutik nr, 05-1511 të dt: 01.04.2019, vërtetohet fakti se i akuzuari B.S është shpallur përgjegjës pasi që tek i njëjti janë gjetur produkte medicinale ilegale, i njëjti ka transportuar dhe shpërndarë me shumicë produkte medicinale në mënyrë të paautorizuar dhe në kundërshtim me par.1 dhe par 1.2 të nenit 13 të Ligjit 04-L/190 për produkte dhe pajisje medicinale sipas të cilit qarkullimi me shumicë sipas këtij ligji kërkon licencë farmaceutike të lëshuar nga AKPPM, vlera e të cilave sipas procesverbaleve të Inspektoratit farmaceutik tejkalon shumë prej shtatëmbëdhjetë mijë euro.

Si është potencuar dhe vendosur në dispozitiv të këtij aktgjykimi, gjykata në këtë çështje penale mori aktgjykim dënues për të akuzuarit **B.S,S.S dhe A.I.** dhe të njëjtit i ka shpallur fajtor për veprën penale Tregti e ndaluar nga neni 305 par.2 të KPRK e lidhur me nenin 31 të KPRK-së, ku kjo dispozitë ligjore ka përcaktuar se **“1 . Kushdo që pa autorizim, blen apo bënë shkëmbimin e mallrave sendeve apo shërbimeve. 2. Kur kryersi I veprës penale nga paragrafi 1 I këtij neni ka organizuar rrjetin e shitjeve ose të ndërmjetësve apo ka realizuar përfitim që kalon shumë prej pesëmbëdhjetë mijë (15.000) euro”.** Ky formulim, është formulim ligjor të cilin e ka përdorur ligji tek vepra penale Tregti e ndaluar nga neni 305 par.2 të KPRK -së, e për tu konsideruar përgjegjës për këtë veprë penale, në çdo rast kryerësi i veprës penale duhet në veprimet e veta ti konsumoj elementet e kësaj veprë penale. Po ashtu për të ekzistuar forma e bashkëpunimit duhet të plotësohen elementi objektiv, **pra si bashkëkryerës është personi I cili së bashku me të tjerët ndërmerr veprimin e kryerjes së veprës penale të caktuar** si dhe elementi subjektiv **pra si bashkëkryerës është personi I cili së bashku me tjetrin në bazë të marrëveshjes mbi ndarjen e punës realizon pjesën e vet në procesin e kryerjes së veprës penale e ka dëshiruar pasojën dhe veprën penale e konsideron sit ë veten.** Siç është theksuar edhe më lartë për tu konsideruar e kryer kjo veprë penale, veprimi i kryerësit është përcaktuar në mënyrë alternative kryerësi i saj duhet që në mënyrë alternative ti ndërmerr veprimin ashtu që veprën penale e kryen ai që shet mallin, sendin apo shërbimin pa autorizim, ai që blen mallin, sendin apo shërbimin pa autorizim dhe ai që shkëmben mallin, sendin pa autorizim, d.m.th. kryerësi duhet të ndërmerr ndonjërin nga këto veprime pa pasur autorizim për një veprim të tillë nga organi kompetent. Gjukata konsideron se të akuzuarit **B.S,S.S dhe A.I.** në raport me elementet e veprës penale, kanë konsumuar në tërësi me veprimet e veta elementet inkriminuese të veprës penale, pasi që të pandehurit B.S dhe S.S medikamentet i kanë siguruar nga i akuzuari A.I dhe nga një person i nacionalitetit serb në veri të M, pa autorizim dhe në kundërshtim me Ligjin për shëndetësi nr. 04/L-125, Ligjin për produkte dhe pajisje medicinale 04/L-190 dhe Udhëzimit Administrativ 11/2015, kanë blerë dhe shitur produkte medicinale dhe atë barna me veprim të ndryshëm terapeutik, pa banderola, me banderola të R. Serbisë, si dhe me afat të skaduar, të cilat mallra sipas ligjit janë të kufizuara, nga këto veprime konsumohet elemnti i veprës penale **blerja e mallit pa autorizim,** më pastaj i pandehuri B.S me dt: 21.03.2019, i merr disa pako me medikamente në depon e postës S.L me veturën e tij të tipit Audi A3, pastaj takohet me të pandehurin S.S, në lagjen U. në P., një pako me medikamente ja jep dhe i fut në veturën e tij të tipit “Opel Korsaa” me targa ..., ku edhe janë ndarë, me qellim të shitjes së tyre nëpër barnatore të ndryshme në Prishtinë dhe vende tjera, nga këto veprime konsumohet elemnti i veprës penale **shitja e mallit në këtë raste shitja e medikamenteve farmaceutike pa autorizim,** mirëpo të njëjtit ishin duke u vëzhguar nga ana e policisë së Kosovës janë ndal dhe gjatë kontrollimit në veturat e tyre janë gjendur dhe sekuestruar pako me medikamente më pastaj gjatë kontrollimit në garazhin e banesës se të pandehurit B.S në Rrugën “U. A. ” në lagjen M.1 i gjenden dhe i sekuestrohen edhe pako tjera me medikamente, vlera e përgjithshme e të cilave përfshinë sasinë mbi 17.000 euro, sipas analizës së kësaj dispozite për ekzistimin e kësaj veprë penale duhet te ekzistoi **DASHJA,** si element qenësor, e cila përfshinë edhe dijeninë e kryerësit të cilët janë në dijeni se mallrat, sendet dhe shërbimet qarkullimi i të cilave nuk është i lejuar pa autorizim dhe është i ndaluar. Gjukata vërtetoi faktin se në mes të akuzuarve ekziston **lidhja objektive** për të ndërmarrur veprim i cili i ka kontribuar kryerjes së veprës penale, pasi që siç vërtetohet pasojat e veprës penale janë rezultat i përbashkët i veprimeve të të gjithë të akuzuarve Po ashtu vërtetohet fakti se ekziston edhe **lidhja subjektive** në mes të pandehurve, për faktin se të njëjtit kanë

pasur dijëni për njeri tjetrin, dhe janë njohur personalisht me njeri tjetrin, ***dhe po ashtu vërtetohet fakti se të njëjtit janë marr vesh mbi ndarjen e punës për realizimin e pjesës së vet në procesin e kryerjes së veprës penale dhe se veprën penale e kanë konsideruar si të veten.***

Gjykata duke analizuar dhe vlerësuar pretendimin e mbrojtësit të të akuzuarit ***B.S av. Imer Beka*** si dhe nga vet deklarimi i të akuzuarit i cili pas rikualifikimit të veprës penale të bërë në fjalën përfundimtare nga Prokurori Special e ka pranuar fajësinë, gjykata ka konstatuar se mbrojtja e dhënë përputhet plotësisht edhe me gjetjet dhe konstatimet e trupit gjykues, ky deklarim i të akuzuarit në raport me gjetjet e trupit gjykues është në harmoni të plotë me provat personale dhe materiale të cilat gjykata i ka administruar në shqyrtimin gjyqësor e të cilat gjykata i dha besim të plotë. Gjykata rikujton se i akuzuari B.S., pas rikualifikimit të veprës penale të bërë në fjalën përfundimtare nga Prokurori Special e ka pranuar fajësinë, për veprën penale Tregti e ndaluar e ndaluar nga neni 305 të KPRK-së, mirëpo një pranim të tillë trupi gjykues nuk e ka pranuar pasi që deklarimi i tillë nuk kishte mbështetje në provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor lidhur me veprën penale importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e pa autorizuar e armeve apo materieve plasëse nga neni 372 par.2 lidhur me par.1 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së, pasi që nga deklarimi i dëshmitares të proceduar në shqyrtimin gjyqësor si dhe nga provat materiale të administruara në shqyrtimin gjyqësor gjykata nuk vërtetoi faktin se i akuzuari B.S të ketë kryer në bashkëkryerje edhe veprën penale importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e pa autorizuar e armeve apo materieve plasëse nga neni 372 par.2 lidhur me par.1 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së, ashtu siç i ngarkon akuza e precizuar, pasi që në mes të akuzuarve nuk vërtetohet se ekziston ***lidhja objektive*** për të ndërmarrur veprim i cili i ka kontribuar kryerjes së veprës penale, pasi që siç vërtetohet pasojat e veprës penale nuk kanë qenë rezultat i përbashkët i veprimeve të të gjithë të akuzuarve, po ashtu nuk vërtetohet fakti se ekziston edhe ***lidhja subjektive*** në mes të pandehurve, për faktin se të njëjtit nuk kanë pasur dijëni për njeri tjetrin, dhe nuk janë njohur personalisht me njeri tjetrin, ***dhe po ashtu nuk vërtetohet fakti se të njëjtit janë marr vesh mbi ndarjen e punës për realizimin e pjesës së vet në procesin e kryerjes së veprës penale dhe se veprën penale nuk e kanë konsideruar si të veten,*** mirëpo gjykata gjeti se ka prova se të akuzuarit ***B.S.S dhe A.I.*** në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale Tregti e ndaluar nga neni 305 par.2 të KPRK e lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Gjykata duke analizuar dhe vlerësuar pretendimin e mbrojtësit të të akuzuarit ***S.S. av. Betim Shala*** si dhe nga vet deklarimi i të akuzuarit i cili pas rikualifikimit të veprës penale të bërë në fjalën përfundimtare nga Prokurori Special e ka pranuar fajësinë, gjykata ka konstatuar se mbrojtja e dhënë përputhet plotësisht edhe me gjetjet dhe konstatimet e trupit gjykues, ky deklarim i të akuzuarit në raport me gjetjet e trupit gjykues është në harmoni të plotë me provat personale dhe materiale të cilat gjykata i ka administruar në shqyrtimin gjyqësor e të cilat gjykata i dha besim të plotë. Gjykata rikujton se i akuzuari S.S, pas rikualifikimit të veprës penale të bërë në fjalën përfundimtare nga Prokurori Special e ka pranuar fajësinë, për veprën penale Tregti e ndaluar e ndaluar nga neni 305 të KPRK-së, mirëpo një pranim të tillë trupi gjykues nuk e ka pranuar pasi që deklarimi i tillë nuk kishte mbështetje në provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor lidhur me veprën penale importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e pa autorizuar e armeve apo materieve plasëse nga neni 372 par.2 lidhur me par.1 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së, pasi që nga deklarimi i dëshmitares të proceduar në shqyrtimin gjyqësor si dhe nga provat materiale të administruara në shqyrtimin gjyqësor gjykata nuk vërtetoi faktin se i akuzuari B.S të ketë kryer në bashkëkryerje edhe veprën penale importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e pa autorizuar e armeve apo materieve plasëse nga neni 372 par.2 lidhur me par.1 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së, ashtu siç i ngarkon akuza e precizuar, pasi që në mes të akuzuarve nuk vërtetohet se ekziston ***lidhja objektive*** për të ndërmarrur veprim i cili i ka kontribuar kryerjes së veprës penale, pasi që siç vërtetohet pasojat e veprës penale nuk kanë qenë rezultat i përbashkët i veprimeve të të gjithë të akuzuarve, po ashtu nuk vërtetohet fakti se ekziston edhe ***lidhja subjektive*** në mes të pandehurve, për faktin se të njëjtit nuk kanë pasur dijëni për njeri tjetrin, dhe nuk janë njohur personalisht me njeri tjetrin, ***dhe po ashtu nuk vërtetohet fakti se të njëjtit janë marr vesh mbi ndarjen e punës për realizimin e pjesës së vet në procesin e kryerjes së veprës penale dhe se veprën penale nuk e kanë konsideruar si të veten,*** mirëpo gjykata gjeti se ka prova se të akuzuarit ***B.S,S dhe A.I.*** në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale Tregti e ndaluar nga neni 305 par.2 të KPRK e lidhur me nenin 31 të KPRK-së.



Gjykata duke analizuar dhe vlerësuar pretendimin e mbrojtësit të akuzuarit **A.I av. Arbër Shala** ka konstatuar se mbrojtja e dhënë është në drejtim të shmangies nga përgjegjësia penale, kjo pasi që është në kundërshtim të plotë me provat personale dhe materiale të cilat gjykata i ka administruar në shqyrtimin gjyqësor e të cilat gjykata i dha besim të plotë, ndërsa pretendimet e mbrojtësit të akuzuarit A.I av. Arbër Shala se kinse “ *me asnjë provë te vetme nuk është vërtetuar se këto barëra i ka blerë A.I dhe me pas i'u ka shitur Be S.S. Të gjitha këto pretendime të prokurorisë janë vetëm supozime juridike, ku prokuroria ka dështuar të argumenton se cilat veprime inkriminuese i ka ndërmarrë A.I. Përkatësisht i beson deklaratës se dëshmitares I. M. se barërat Tamoil XX ia ka shitur A.I, por me asnjë provë të vetme nuk ka arritur që të vërtetohet ky dyshim, gjithashtu deklarata e I.M. vetëm që është e pa bazuar po e njëjta është bërë me qëllim të hakmarrjes ndaj A. për faktin se ata nuk kanë raport me njëri tjetrin. Po ashtu A.I. as që i janë zënë barëra të llojit Tamoil dhe prokuroria nuk ka asnjë provë apo dëshmi konkrete me të cilën vërtetohet se këto barëra i ka blerë e pastaj i ka shitur. Përkundrazi bari tamoil xx është produkt medicinal me veti analgjetic dhe është bar që blihet në barnatore, kjo vërtetohet nga provat e administruar- shkresa zyrtare e Agjencisë së Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale Nr. 01 372/2 e datës 09.02.2022 pra i njëjti është bar kundër dhimbjes që mund të blihet nga çdo person në barnatore’*. Trupi gjykues deklarimet e tilla i hodhi poshtë si të pa besueshme, për faktin se të gjitha provat personale dhe materiale të administruara në shqyrtimin gjyqësor dhe të elaboruara si më lart vërteton faktin se i akuzuari A.I, në bashkëkryerje edhe me të akuzuarit B.S dhe S.S kanë kryer veprën penale si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për faktin se dëshmia e dëshmitares I.M të dhënë në shqyrtimin gjyqësor si dhe në procedurën paraprake e cila dëshmitare në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se ‘ **A. ka ndodh me ardhur mi ble barnat me një person tjetër e që nuk ka qenë vetëm e që në sallë e ka identifikuar BSylajmanin**’ përputhet pjesërisht edhe me deklarin e të akuzuarit A.I i cili në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se **personin B.S e njuh pasi ka blerë një veturë në vitin 2012-13**, dhe deklarimi i mbrojtjes së të akuzuarit se kinse dëshmitarja ka probleme personale me të akuzuarin nuk qëndron, ky deklarim kishte për synim ikjes dhe shmangies nga përgjegjësia penale.

Gjykata vlerësoi me shumë kujdes të gjitha provat e administruara në shqyrtim gjyqësor, sa i përket të akuzuarve **B.S,S.S dhe A.I** dhe ka ardhur në përfundim se duhet t’i falet besimi i plotë, provave personale siç janë deklarata e dëshmitares I.M të dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësor **të datës 17.01.2022**, deklarimet kësaj dëshmitare të dhënë në procedurën paraprake dhe në shqyrtimin gjyqësor për këto rrethana të ngjarjes të cekura si më lartë, nuk ka në vetvete sh përputhje të mëdha për faktet vendimtare, që do ta bënin gjykatën për ta ulur besueshmërinë ndaj kësaj dëshmitareje, e njëjta ka qen objektive në deklarimet e saj, si dhe provave materiale të administruara në shqyrtimin gjyqësor siç janë, Vërtetimi mbi marrjen e sendeve, video incizimet e nxjerra nga pajisjet e marra në firmën “S.L”, raportet mbi masat e fshehta të vëzhgimit dhe hetimit, nga vendimet e inspektoratit farmaceutik, nga procesverbalet e inspektoratit farmaceutik, fotoalbumi, Andaj, gjykata këto dëshmi i konsideroi të besueshme, dhe të njëjtave ua fali besimin.

Gjykata duke pasur parasysh të gjitha provat e proceduara, faktet dhe rrethanat e vërtetuara, ne shqyrtim gjyqësor, dëshmitë e dëshmitarëve të gjitha këtyre provave kjo gjykatë u kushtoi besim të plotë, e të cilat qojnë gjykatën në kolaudim se besueshmëria në to dhe shkalla e arsyesh mërisë së deklarimeve me rrethanat konkrete të rastit, nuk lënë vend për dyshim, prandaj gjykata gjënë se në veprimet e të akuzuarve vërtetohet se të njëjtit kanë kryer veprat penale ashtu siç është vendosur në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata i pati parasysh minimumin dhe maksimumin e dënimit të paraparë për veprat penale për të cilën të akuzuarit janë shpallur fajtor, pastaj pati parasysh edhe qëllimin e dënimit dhe të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese nga neni 74 të KPRK-së, që ndikojnë në ashpërsimin ose zbutjen e dënimit

Gjykata duke u bazuar në rregullat e përgjithshme për ashpërsimin e dënimit për të akuzuarin **IM** ka gjetur, Shkallen e përgjegjësisë penale pasi që gjykata ka vërtetuar se i akuzuari ishte i përgjegjshëm dhe përgjegjës për këtë veprë penale, i aftë për t’i kuptuar sjelljet dhe veprimet e tij, peshën veprës penale dhe rrezikshmërinë shoqërore te veprës penale të kryer, pasi kryerja e kësaj veprë penale është mjaftë e shprehur ne vendin tone, shkallën e lartë të pjesëmarrjes së personit të dënuar në veprën penale, pasi që i

njëti me veprimet e tij thellësisht i ka kontribuar kryerjes së kësaj vepre penale dhe se veprën penale e kanë konsideruar si të veten.

Gjykata duke u bazuar në rregullat e përgjithshme për zbutjen e dënimit, për të akuzuarin **LM** ka gjetur; Sjelljet e mira dhe korrekte te këtij te akuzuari, ne raport me gjykatën dhe palët tjera, historiku kriminal i të akuzuarit, ku sipas shënimeve të cilat i posedon kjo gjykatë është hera e pare që bie në kundërshtim me ligjin, është hera e pare që ndaj tij zhvillohet një proces penal dhe për të cilin është shqiptuar sanksion penal, të njëjtin shkaktimi i kësaj vepre në masë të madhe e ka lënduar shpirtërisht dhe dëmtuar materialisht pasi që siç rezulton nga provat që posedon kjo gjykatë i njëjti 20 vite ka punuar jashtë vendit me biznesin e tij për shërbime postare, të njëjtin biznes e ka hapur edhe në Kosovë, dhe si pasoj e kësaj vepre penale ka mbyllur këtë biznes nga i cili ka gjeneruar të hyra të konsiderueshme.

Gjykata duke u bazuar në rregullat e përgjithshme për ashpërsimin e dënimit për të akuzuarin **V.I** ka gjetur, Shkallen e përgjegjësisë penale pasi që gjykata ka vërtetuar se i akuzuari ishte i përgjegjshëm dhe përgjegjës për këtë vepër penale, i aftë për t'i kuptuar sjelljet dhe veprimet e tij, peshën veprës penale dhe rrezikshmërinë shoqërore te veprës penale të kryer, pasi kryerja e kësaj vepre penale është mjaftë e shprehur ne vendin tone, shkallën e lartë të pjesëmarrjes së personit të dënuar në veprën penale, pasi që i njëjti me veprimet e tij thellësisht i ka kontribuar kryerjes së kësaj vepre penale dhe se veprën penale e kanë konsideruar si të veten, faktin se i njëjti nuk është hera e pare që bien ndesh me ligjin ku sipas shënimeve të cilat i posedon kjo gjykatë ndaj tij janë zhvilluar procese tjera penale dhe për të cilin janë shqiptuar sanksion penal.

Gjykata duke u bazuar në rregullat e përgjithshme për zbutjen e dënimit, për të akuzuarin **V.I** ka gjetur; Sjelljet e mira dhe korrekte te këtij te akuzuari, ne raport me gjykatën dhe palët tjera, faktin se i njëjti nga fillimi i kësaj procedure është deklaruar i fajshëm, ka shprehur keqardhje, të njëjtin shkaktimi i kësaj vepre në masë të madhe e ka lënduar shpirtërisht, mosha e të akuzuarit pasi që njëjti është moshës së re.

Gjykata duke u bazuar në rregullat e përgjithshme për ashpërsimin e dënimit për të akuzuarin **N.G** ka gjetur, Shkallen e përgjegjësisë penale pasi që gjykata ka vërtetuar se i akuzuari ishte i përgjegjshëm dhe përgjegjës për këtë vepër penale, i aftë për t'i kuptuar sjelljet dhe veprimet e tij, peshën veprës penale dhe rrezikshmërinë shoqërore te veprës penale të kryer, pasi kryerja e kësaj vepre penale është mjaftë e shprehur ne vendin tone, shkallën e lartë të pjesëmarrjes së personit të dënuar në veprën penale, pasi që i njëjti me veprimet e tij thellësisht i ka kontribuar kryerjes së kësaj vepre penale dhe se veprën penale e kanë konsideruar si të veten, faktin se i njëjti nuk është hera e pare që bien ndesh me ligjin ku sipas shënimeve të cilat i posedon kjo gjykatë ndaj tij janë zhvilluar procese tjera penale dhe për të cilin janë shqiptuar sanksion penal, konkretisht i njëjti është recidivist i veprës penale importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e pa autorizuar e armeve apo materieve plasëse nga neni 372 të KPRK-s, pasi që ka aktgjykim të plotfuqishëm.

Gjykata duke u bazuar në rregullat e përgjithshme për zbutjen e dënimit, për të akuzuarin **N.G** ka gjetur; Sjelljet e mira dhe korrekte te këtij te akuzuari, ne raport me gjykatën dhe palët tjera, faktin se i njëjti nga fillimi i kësaj procedure është deklaruar i fajshëm, ka shprehur keqardhje, të njëjtin shkaktimi i kësaj vepre në masë të madhe e ka lënduar shpirtërisht, mosha e të akuzuarit pasi që njëjti është i moshës së re.

Gjykata duke u bazuar në rregullat e përgjithshme për ashpërsimin e dënimit për të akuzuarin **N.A** ka gjetur, Shkallen e përgjegjësisë penale pasi që gjykata ka vërtetuar se i akuzuari ishte i përgjegjshëm dhe përgjegjës për këtë vepër penale, i aftë për t'i kuptuar sjelljet dhe veprimet e tij, peshën veprës penale dhe rrezikshmërinë shoqërore te veprës penale të kryer, pasi kryerja e kësaj vepre penale është mjaftë e shprehur ne vendin tone, shkallën e lartë të pjesëmarrjes së personit të dënuar në veprën penale, pasi që i njëjti me veprimet e tij thellësisht i ka kontribuar kryerjes së kësaj vepre penale dhe se veprën penale e kanë konsideruar si të veten.

Gjykata duke u bazuar në rregullat e përgjithshme për zbutjen e dënimit, për të akuzuarin **N.A** ka gjetur; Sjelljet e mira dhe korrekte te këtij te akuzuari, ne raport me gjykatën dhe palët tjera, historiku kriminal i të akuzuarit, ku sipas shënimeve të cilat i posedon kjo gjykatë është hera e pare që bie në kundërshtim me ligjin, është hera e pare që ndaj tij zhvillohet një proces penal dhe për të cilin është shqiptuar sanksion

penal, të njëjtin shkaktimi i kësaj vepre në masë të madhe e ka lënduar shpirtërisht, mosha e të akuzuarit pasi që njëjti është i moshës së re.

Gjykata duke u bazuar në rregullat e përgjithshme për ashpërsimin e dënimit për të akuzuarin **B.S** ka gjetur, Shkallen e përgjegjësisë penale pasi që gjykata ka vërtetuar se i akuzuari ishte i përgjegjshëm dhe përgjegjës për këtë vepër penale, i aftë për t'i kuptuar sjelljet dhe veprimet e tij, peshën veprës penale dhe rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale të kryer, shkallën e lartë të pjesëmarrjes së personit të dënuar në veprën penale, pasi që i njëjti me veprimet e tij thellësisht i ka kontribuar kryerjes së kësaj vepre penale dhe se veprën penale e kanë konsideruar si të veten, faktin se i njëjti nuk është hera e pare që bien ndesh me ligjin ku sipas shënimeve të cilat i posedon kjo gjykatë ndaj tij janë zhvilluar procese tjera penale dhe për të cilin janë shqiptuar sanksion penal, konkretisht i njëjti është dënuar me vendim të formës së prerë për veprën penale kontrabandimi i mallrave pasi që ka aktgjykim të plotfuqishëm.

Gjykata duke u bazuar në rregullat e përgjithshme për zbutjen e dënimit, për të akuzuarin **B.S** ka gjetur; Sjelljet e mira dhe korrekte të këtij të akuzuari, në raport me gjykatën dhe palët tjera, faktin se i njëjti nga fillimi i kësaj procedure është deklaruar i fajshëm, ka shprehur keqardhje, të njëjtin shkaktimi i kësaj vepre në masë të madhe e ka lënduar shpirtërisht, mosha e të akuzuarit pasi që njëjti është i moshës së re.

Gjykata duke u bazuar në rregullat e përgjithshme për ashpërsimin e dënimit për të akuzuarin **S.S** ka gjetur, Shkallen e përgjegjësisë penale pasi që gjykata ka vërtetuar se i akuzuari ishte i përgjegjshëm dhe përgjegjës për këtë vepër penale, i aftë për t'i kuptuar sjelljet dhe veprimet e tij, peshën veprës penale dhe rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale të kryer, shkallën e lartë të pjesëmarrjes së personit të dënuar në veprën penale, pasi që i njëjti me veprimet e tij thellësisht i ka kontribuar kryerjes së kësaj vepre penale dhe se veprën penale e kanë konsideruar si të veten, faktin se i njëjti nuk është hera e pare që bien ndesh me ligjin ku sipas shënimeve të cilat i posedon kjo gjykatë ndaj tij janë zhvilluar procese tjera penale dhe për të cilin janë shqiptuar sanksion penal.

Gjykata duke u bazuar në rregullat e përgjithshme për zbutjen e dënimit, për të akuzuarin **B.S** ka gjetur; Sjelljet e mira dhe korrekte të këtij të akuzuari, në raport me gjykatën dhe palët tjera, faktin se i njëjti nga fillimi i kësaj procedure është deklaruar i fajshëm, ka shprehur keqardhje, të njëjtin shkaktimi i kësaj vepre në masë të madhe e ka lënduar shpirtërisht, mosha e të akuzuarit pasi që njëjti është i moshës së re.

Gjykata duke u bazuar në rregullat e përgjithshme për ashpërsimin e dënimit për të akuzuarin **A.I** ka gjetur, Shkallen e përgjegjësisë penale pasi që gjykata ka vërtetuar se i akuzuari ishte i përgjegjshëm dhe përgjegjës për këtë vepër penale, i aftë për t'i kuptuar sjelljet dhe veprimet e tij, peshën veprës penale dhe rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale të kryer, shkallën e lartë të pjesëmarrjes së personit të dënuar në veprën penale, pasi që i njëjti me veprimet e tij thellësisht i ka kontribuar kryerjes së kësaj vepre penale dhe se veprën penale e kanë konsideruar si të veten, faktin se i njëjti nuk është hera e pare që bien ndesh me ligjin ku sipas shënimeve të cilat i posedon kjo gjykatë ndaj tij janë zhvilluar procese tjera penale dhe për të cilin janë shqiptuar sanksion penal.

Gjykata duke u bazuar në rregullat e përgjithshme për zbutjen e dënimit, për të akuzuarin **A.I** ka gjetur; Sjelljet e mira dhe korrekte të këtij të akuzuari, në raport me gjykatën dhe palët tjera, faktin se i njëjti nga fillimi i kësaj procedure është deklaruar i fajshëm, ka shprehur keqardhje, të njëjtin shkaktimi i kësaj vepre në masë të madhe e ka lënduar shpirtërisht, mosha e të akuzuarit pasi që i njëjti është i moshës së re.

Andaj, gjykata duke u bazuar në rrethanat e cekura si më lartë të akuzuarve iu shqiptojë dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindje se ky dënim është adekuat me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarve dhe se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit që të parandalojë kryerësit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave të tilla penale, të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimin mbi konfiskimin gjykata e mori konform nenit 305 par. 3 të KPRK-së medikamentet e listuar si në listën e Inspektoratit Farmaceutik të konfiskohen, si dhe në bazë të nenit 372 par. 4 të KPRK-së 29 pistoleta Zoraki me mbishkrimin "Glock Austria" dhe 69 pistoleta Zoraki me mbishkrimin "Sig Sauer" gjithsej 99 pistoleta, si dhe 723 fishek, të konfiskohen.

Në bazë të nenit 284 par.1 të KPPRK, sendet e sekuestruara Vetura Opel Corsa ngjyrë hiri me targa ... Vetura A.A3 ngjyrë e zezë me targa ... në pronësi të akuzuarve B dhe S.S. si dhe 12.300 euro, në pronësi të akuzuarit I. M. si dhe 5.000 euro në pronësi të B.S ju kthehen pasi që nuk ka bazë për konfiskim. Gjukata një refuzim te tille e beri pasi që vlerësoi se parat dhe veturat nuk janë rezultat i veprës penale, pra nuk janë përfitim nga vepra penale, Ne këtë drejtim gjykata vlerëson se prokuroria fillimisht do duhej që gjate shqyrtimit gjyqësor te vërtetonte se këto para dhe këto vetura rrjedhin nga kryerja e veprës penale, gjë që ne shqyrtim gjyqësor nuk u vërtetua se te njëjtat kane burim kryerjen e veprës penale, veturat e propozuara për konfiskim janë vetura të zakonshme të cilat janë përdorur për nevojat personale nuk kanë qen të modifikuara për transportin dhe fshehjen apo maskimin e mallrave, dhe për këtë arsye gjykata e refuzoje një propozim te tillë dhe urdhëroje që pasi aktgjykimi te merr formën e prerë te njëjtat t'iu kthehen te akuzuarve sipas vërtetimeve për konfiskimin e te njëjtave.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësorë, u mor konform nenit 450 par 1 dhe 2 nën par 2.1 dhe 2.6 si dhe nenit 454, të KPPK.

Nga sa u tha më lart, e në bazë të nenit 363, 364, 365 të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**  
**- Departamenti Special-**  
**PS.nr.22/2020, me datën 08.06.2022**

**Kryetari i trupit gjykues**  
Lutfi SHALA

**UDHËZIM JURIDIK:** kundër këtij aktgjykimi është e lejuar e drejta në ankesë në afatin prej **15 ditësh**, nga dita e marrjes së aktgjykimit. Ankesa i drejtohet Gjukatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate në kopje të mjaftueshme.